REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 719 Prot.                                                    Tiranë, më 30.01.2025

# ANALIZA E PUNËS
# VITI 2024
# INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, i cili është krijuar dhe funksionon në mbështetje të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", si dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". Në strukturën organizative ISHTI ka si pjesë përbërëse të tij 11 (njëmbëdhjetë) drejtori, përkatësisht:

1. *Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit (DAVRM)*
2. *Drejtoria e Laboratorit Qendror (DLQ)*
3. *Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM)*
4. *Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP)*
5. *Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN)*
6. *Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)*
7. *Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)*
8. *Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional (DIPKN)*
9. *Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike (DÇJPP)*
10. *Drejtoria e Buxhetit dhe Financës (DBF)*
11. *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (DBNJSHM)*

Për hartimin e Analizës Vjetore të Punës mbi veprimtarinë e ISHTI-t për vitin 2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është bazuar në Analizën e Punës së përgatitur nga secila drejtori, mbi veprimtarinë e tyre të punës për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024, sipas sektorëve dhe detyrave të tyre funksionale. Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar aktiviteti i secilës drejtori për vitin 2024.

## I. DREJTORIA E ANALIZËS, VLERËSIMIT TË RISKUT DHE MONITORIMIT (DAVRM)

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit ka si qëllim kryesor të punës së saj: sigurimin, bashkërendimin, mbikëqyrjen, orientimin dhe aplikimin e duhur të procedurave, metodologjive dhe standardeve të inspektimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objektivat kryesorë të punës së Drejtorisë së Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit (DAVRM) për vitin 2024, konsistuan në:

A. **Vlerësimin dhe menaxhimin e niveleve të riskut** duke klasifikuar në risk sektori dhe risk subjekti sipas shkallëve:
- risk i ulët,
- risk i mesëm,
- risk i lartë.

Me qëllim klasifikimin dhe vlerësimin e riskut të sektorit dhe riskut të subjektit, është realizuar analizë e thelluar e të gjitha inspektimeve të kryera nga drejtoritë inspektuese.

B. **Analizë specifike mbi punën e realizuar nga drejtoritë inspektuese** për periudhën janar-dhjetor 2024, përkatësisht:
- DINGN 925 inspektime;
- DIPNP 3217 inspektime;
- DIPIEMN 3515 inspektime;
- DSGIK 6 inspektime.

Analiza e verifikimit të procedurave të kryerjes së inspektimeve kryhet me qëllim rritjen e sigurisë dhe cilësisë, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe menaxhimit të riskut.

C. **Verifikim i subjekteve** të mbyllura në QKB, me qëllim përditësimin e listës së planit të inspektimit të drejtorive inspektuese. Sektori i Monitorimit dhe Metodikave të Kontrollit; analizon dhe verifikon me kujdes subjektet me status:
- *"i mbyllur";*
- *"nuk ushtron aktivitet";*
- *"nuk gjendet në adresën e deklaruar në QKB";*
- *"pajisja nuk është në punë".*

D. **Identifikimi i problematikave në inspektimet e realizuara** për secilën drejtori bazuar në të dhënat e gjeneruara nga sistemi e-Inspektimi dhe hartimi i raporteve javore/mujore.
- Inspektimet e kryera me autorizim nga çdo inspektor, shkeljet e konstatuara, rekomandimet e lëna dhe masat administrative të vendosura sipas rasteve;
- Vlerësimi dhe respektimi i kërkesave ligjore mbi procesin e inspektimit;
- Dokumentimi i praktikave në respektimin e kërkesave ligjore;
- Raportimi i parregullsive të inspektimit me qëllim përmirësimin e procesit të inspektimit.

- **Detyrat kryesore të DAVRM**

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit për periudhën janar- dhjetor 2024, është fokusuar në këto detyra parësore:

- Vlerësimin dhe menaxhimin e niveleve të riskut;
- Analiza e riskut mbi drejtoritë inspektuese;
- Klasifikim dhe listim të subjekteve me profil risku të lartë;
- Kontrolli mbi respektimin e planit të inspektimit të drejtorive inspektuese;
- Monitorimi i procesit të inspektimit në sistemin e-Inspektimi;
- Raportimi i çdo problematike të hasur gjatë monitorimit të inspektimeve.

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit me ristrukturimin e organikës së institucionit përbëhet nga: Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut, Sektori i Monitorimit dhe Metodikave të Kontrollit, ku secili prej tyre ka të përcaktuara qartë detyrat e tij funksionale dhe përgjegjësitë, duke bashkëpunuar në varësi të kërkesave të caktuara në funksion të Drejtorisë. Në analizën e realizuar për periudhën janar- dhjetor 2024, është specifikuar puna e secilit sektor.

1. **Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut**

Vlerësimi i riskut ka si qëllim të sigurojë që risqet të identifikohen dhe të trajtohen në kohën e duhur në këtë institucion. Nëpërmjet identifikimit të fushave të riskut, vlerësimit të riskut dhe eliminimit/reduktimit të riskut në minimumin e mundshëm, ky sektor, synon që të arrihen objektivat dhe të krijohet një kulturë vendimmarrje me risk të përllogaritur në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial. Përmbushja e qëllimit të menaxhimit të riskut në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial realizohet nëpërmjet:

a. Ngritjes dhe funksionimit të Sektorit të Analizës dhe Vlerësimit të Riskut, me qëllim kategorizimin dhe menaxhimin e nivelit të riskut;
b. Analizimin dhe raportimin e vazhdueshëm të problematikave të hasura gjatë procesit të inspektimit me qëllim përmirësimin e procesit;
c. Monitorimit të qëndrueshmërisë së riskut;
d. Marrjes së masave për pakësimin/ eliminimin e riskut në nivel të pranueshëm.

DAVRM, pas hartimit të manualit "Udhëzim për Menaxhimin e Riskut" është angazhuar në vijim, për rishikimin dhe përmirësimin e metodologjisë së menaxhimit të riskut dhe po punohet për konfigurimin e riskut nga roli ligjor sipas udhëzimeve të Inspektoratit Qendror (IQ) në plotësim të modul-it "Vlerësimi i Risk-ut" në sistemin online "e-Inspektimi". Prioriteti i analizës në këtë periudhë ka qenë identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut, si edhe analizimi i indikatorëve për reduktimin e riskut në minimumin e mundshëm për inspektim.

Të gjitha subjektet që inspektohen nga ISHTI, do të kalojnë në një filtër kontrolli sipas profilit të riskut nga Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut (SAVR) në funksion të veprimtarisë që kryejnë. Sektori realizon vlerësimin e të dhënave të inspektimit dhe i analizon indikatorët me

qëllim evidentimin e nivelit të riskut, trajtimin e tij nëpërmjet një sistemi metodik të strukturuar, për përmbushjen me korrektësi dhe me cilësi të inspektimeve.

SAVR, në vijim të punës ka bërë analizën e plotë të mënyrës së funksionimit të drejtorive, të cilat kryejnë inspektime në terren dhe që zotërojnë në vetvete risk, konkretisht, Drejtorisë së Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN), Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP), si dhe të Drejtorisë së Inspektimi të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN) me objekt:

- Analizë të vendimeve me shkelje **(gjoba) për vitin 2024,** për evidentimin e indikatorëve më të rëndësishëm të konstatuar gjatë shkeljeve, me qëllim marrjen e masave për fokusin e kontrollit në vijim.
- Analizë e detajuar e të gjitha inspektimeve të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2024 për secilën drejtori inspektuese me qëllim klasifikimin e riskut të sektorit dhe riskut të subjektit.

### 1.1 Analiza specifike e klasifikimit të riskut mbi Drejtoritë Inspektuese

Analiza e veprimtarisë së DAVRM për **vitin 2024**, është bazuar në një sistem monitorimi online dhe kontrolli ditor. Raportet e përgatitura dhe analizat e kryera për çdo drejtori inspektuese shërbejnë në përmirësimin e procesit të punës dhe në përmbushjen e objektivave të përcaktuara për institucionin.

➢ **Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)**

Nga analiza e realizuar për periudhën janar-dhjetor 2024 për DINGN rezulton se: nga **925 inspektime në total, 29 inspektime** ose **3 %** kanë rezultuar me risk të lartë sektori, në bazë të monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesën e dokumentacionit shoqërues në sistemin e-inspektime. Hedhja në sistem e dokumentacionit është detyrim ligjor nga ana e inspektorëve. Në **75 inspektime ose 7%** janë identifikuar me risk të mesëm sektori, ku rezulton se është ngarkuar në sistem një pjesë e dokumentacionit të deklaruar në listëverifikim.

Në **262 inspektime ose 28 %** janë vlerësuar me risk të ulët sektori, sepse pjesa më e madhe e dokumentacionit është ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në **92 inspektime** ose **9 %** rezulton që janë klasifikuar njëkohësisht me risk sektori dhe risk subjekti në rastet kur subjektit i është lënë detyrë plotësimi i dokumentacionit dhe kushteve teknike. Në **11 inspektime** janë vlerësuar me risk të lartë subjekti, ku për arsye të moszbatimit të kërkesave ligjore, subjektet kanë marrë masë administrative.

| KLASIFIKIM RISKU DINGN | | | |
|---|---|---|---|
| | **Risk Sektori** | **Risk Sektori/Subjekti** | **Risk Subjekti** |
| **I Ulët** | 262 | 0 | 0 |
| **I Mesëm** | 75 | 0 | 0 |
| **I Lartë** | 29 | 92 | 11 |

*Tabela nr.1 Klasifikimi i riskut, DINGN janar-dhjetor 2024*




*Grafiku nr.2 Klasifikimi i riskut DINGN*

- **<u>Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP)</u>**

Nga analiza e kryer për periudhën janar- dhjetor 2024 për DIPNP rezulton se: nga **3217 inspektime në total, 9 inspektime** ose **0.2 %** janë vlerësuar me risk të lartë sektori, ku në bazë të monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesën e dokumentacionit shoqërues në sistemin e-inspektime, detyrim ligjor ky nga ana e inspektorëve. Në **6 inspektime** ose **0.1%** janë identifikuar me risk të mesëm sektori, ku rezulton se është ngarkuar një pjesë e dokumentacionit të deklaruar në listë verifikim. Në **25 inspektime** ose **0.7 %** janë vlerësuar me risk të ulët sektori, sepse pjesa më e madhe e dokumentacionit është ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në **5 inspektime** rezulton që janë klasifikuar njëkohësisht me risk sektori dhe risk subjekti në rastet kur subjektit i është lënë detyrë plotësimi i të gjithë dokumentacionit dhe nuk e kanë riinspektuar si subjekt. Në **2 inspektime** janë vlerësuar me risk të lartë subjekti, ku për arsye të moszbatimit të kërkesave ligjore, kanë marrë masë administrative.

| KLASIFIKIM RISKU DIPNP | | | |
|---|---|---|---|
| | **Risk Sektori** | **Risk Sektori/ Subjekti** | **Risk Subjekti** |
| **I Ulët** | 25 | 0 | 0 |
| **I Mesëm** | 6 | 0 | 0 |
| **I Lartë** | 9 | 5 | 2 |

*Tabela nr.3 Klasifikimi i riskut, DIPNP janar-dhjetor 2024*




*Grafiku nr.4 Klasifikimi i riskut DIPNP*

➢ **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN)**

Nga analiza e realizuar për periudhën janar- dhjetor 2024 për DIPIEMN rezulton se: nga **3515 inspektime** të realizuara, **39 inspektime ose 1 %** janë vlerësuar me risk të lartë sektori, ku në bazë të monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesën e dokumentacionit shoqërues në sistemin e-Inspektime, si detyrim ligjor nga ana e inspektorëve. **29 inspektime** janë identifikuar me risk të mesëm sektori, ku rezulton se është ngarkuar një pjesë e dokumentacionit të deklaruar në listë verifikim, pjesa tjetër mungon pavarësisht se në listë verifikim është pohuar që subjekti disponon të gjithë dokumentacionin.

Në **125 inspektime** ose **3%** janë vlerësuar me risk të ulët sektori, sepse pjesa më e madhe e dokumentacionit është ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në **512 inspektime** ose **14%** rezulton që janë klasifikuar njëkohësisht me risk të lartë sektori dhe subjekti rastet kur subjektit i është lënë detyrë plotësimi i të gjithë dokumentacionit dhe nuk është e riinspektuar si subjekt në vazhdimësi. Në **39 inspektime ose 1 % e tyre** janë vlerësuar me risk të lartë subjekti, subjektet që për arsye të moszbatimit të kërkesave ligjore kanë marrë masë administrative ose subjekti nuk disponon dokumentacion. **3 inspektime** rezulton të jenë vlerësuar me risk të ulët subjekti.

| KLASIFIKIM RISKU (DIPIEMN) | | | |
|---|---|---|---|
| | Risk Sektori | Risk Sektori/Subjekti | Risk Subjekti |
| **I ulët** | 125 | 0 | 3 |
| **I mesëm** | 29 | 0 | 0 |
| **I lartë** | 39 | 512 | 39 |

*Tabela nr.5 Klasifikimi i riskut DIPIEMN 2024*




*Grafiku Nr.6 Klasifikimi i Riskut DIPIEMN*

## 1.2 Analiza e inspektimeve me gjobë

Bazuar në informacionin e analizuar nga Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut, është hartuar raporti përmbledhës duke identifikuar disa nga masat administrative që janë marrë ndaj subjekteve të inspektuara për periudhën janar- dhjetor 2024.

- **Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)**

Sikurse është paraqitur edhe në tabelë, për DINGN nga 925 inspektime të realizuara në total, rezultojnë 18 masa administrative me gjobë për vitin 2024.

| Drejtoria e Inspektimit të Gazit, Naftës dhe Nënprodukteve (DINGN) | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Inspektime Viti 2024 | | | | | | | | | | | | | |
| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | Totali |
| Nr. | 94 | 78 | 90 | 81 | 60 | 87 | 74 | 66 | 88 | 81 | 76 | 50 | 925 |
| Masa Administrative Viti 2024 | | | | | | | | | | | | | |
| Nr. | 3 | - | 5 | 3 | 2 | 2 | - | 2 | - | 1 | - | - | 18 |

*Tabela Nr 7. Masat administrative të marra nga DINGN, për periudhën janar- dhjetor 2024*

- **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP)**

Sikurse është paraqitur edhe në tabelë, për DIPNP, nga 3217 inspektime të realizuara në total, rezultojnë 2 masa administrative me gjobë për vitin 2024.

| Drejtoria e Inspektimit te Paisjeve Nën Presion (DIPNP) | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Inspektime Viti 2024 | | | | | | | | | | | | | |
| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | Totali |
| Nr. | 270 | 307 | 313 | 311 | 320 | 310 | 271 | 181 | 233 | 245 | 218 | 235 | 3216 |
| Masa Administrative Viti 2024 | | | | | | | | | | | | | |
| Nr. | - | - | - | 1 | - | - | 1 | - | - | - | - | - | 2 |

*Tabela Nr.8. Masat administrative të marra nga DIPNP, për periudhën Janar-Dhjetor 2024*

- **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN)**

Sikurse është paraqitur edhe në tabelë, për DIPIEMN, nga 3515 çështje të realizuara në total, rezultojnë 39 masa administrative me gjobë për vitin 2024.

| Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve,Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN) | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Inspektime Viti 2024 | | | | | | | | | | | | |
| JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | Totali |
| 247 | 242 | 250 | 300 | 290 | 262 | 326 | 261 | 318 | 362 | 301 | 346 | 3515 |
| Masa Administrative Viti 2024 | | | | | | | | | | | | |
| 4 | 3 | 3 | 4 | 3 | 2 | 2 | 5 | 2 | 3 | 4 | 4 | 39 |

*Tabela Nr.9 Masat administrative DIPIEMN, për periudhen Janar-Dhjetor 2024*

- **Drejtoria e Inspektimit të Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)**

Për DSGIK, rezulton se nga 6 inspektime të realizuara në total, nuk është marrë **asnjë masë administrative** për periudhën vitin 2024.

### 2. Sektori i Monitorimit dhe Metodikave të Kontrollit.

Sektori i Monitorimit dhe Metodikave të Kontrollit për periudhën janar - dhjetor 2024, ka kryer monitorimin e çështjeve të inspektuara *"on-line"* nga inspektorët e Drejtorisë së Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion, Drejtorisë së Inspektimeve të Instalimeve, Pajisjeve Elektrike dhe Makinerive Ngritës, si dhe Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare me objekt:

- Identifikimin e problematikave në çështjet e inspektuara për secilën drejtori bazuar në të dhënat e gjeneruara nga sistemi e-Inspektimi.
- Monitorimin në kohë reale të hedhjes së çështjeve në sistemin e-Inspektimi, për secilën drejtori inspektuese.
- Këshillimin dhe rekomandimin mbi respektimin e procedurave të inspektimit.

Qëllimi i Sektorit të Monitorimit është kryerja e monitorimit si një tërësi procesesh të kontrollit të aktivitetit të ISHTI-t, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efeçientë me kalimin e kohës.

#### 2.1 Inspektimet e planifikuara dhe të realizuara.

Sektori i Monitorimit dhe Metodikave të Kontrollit (SMMK) ka realizuar analizën vjetore janar-dhjetor 2024 të inspektimeve të hartuara nga drejtoritë përkatëse.

Paraqitja e tabelave të mëposhtme tregon raportin e planifikimit për secilën drejtori dhe inspektimet e realizuara jashtë dhe brenda planit. Gjithashtu është dhënë edhe numri i çështjeve që janë anulluar për secilën drejtori. Është kryer një analizë e hollësishme nga monitorimi i sistemit e-Inspektimi për identifikimin e subjekteve, të cilat janë të mbyllura, nuk ushtrojnë aktivitet, nuk janë objekt inspektimi, nuk ndodhen në adresën e deklaruar ose pajisja është jashtë funksioni.

- **Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)**

Bazuar në të dhënat e tabelës së mëposhtme, DINGN gjatë vitit 2024 ka planifikuar **861 inspektime në total** dhe ka realizuar **158** ose **18 %** të inspektimeve inspektime jashtë planit. Në total janë kryer **925** inspektime dhe **12** çështje janë anulluar.

| Muaji | Planifikimi | Inspektime të Realizuara | Jashtë planit | Anulluara |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 84 | 94 | 11 | 0 |
| Shkurt | 79 | 78 | 2 | 0 |
| Mars | 81 | 90 | 17 | 5 |
| Prill | 70 | 81 | 23 | 0 |
| Maj | 51 | 60 | 11 | 0 |
| Qershor | 83 | 87 | 8 | 1 |
| Korrik | 66 | 74 | 20 | 4 |
| Gusht | 49 | 66 | 21 | 0 |
| Shtator | 89 | 88 | 9 | 0 |
| Tetor | 82 | 81 | 21 | 1 |
| Nëntor | 79 | 76 | 7 | 0 |
| Dhjetor | 48 | 50 | 8 | 1 |
| Totali | 861 | 925 | 158 | 12 |

*Tabela nr10. Inspektimet e planifikuara nga DINGN për periudhën Janar- Dhjetor 2024*

- **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP)**

Bazuar në të dhënat e sistemit të paraqitura në këtë tabelë rezulton se, DIPNP në total ka planifikuar **3002 çështje** dhe **jashtë planit janë realizuar 270 inspektime ose 8.9 %** të inspektimeve. Në total janë realizuar **3217 inspektime** dhe **62 çështje** rezultojnë të anulluara.

| Muaji | Planifikimi | Inspektime Realizuara | Jashtë planit | Anulluara |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 263 | 270 | 10 | 7 |
| Shkurt | 302 | 307 | 3 | 0 |
| Mars | 277 | 313 | 34 | 12 |
| Prill | 261 | 312 | 61 | 0 |
| Maj | 301 | 320 | 20 | 2 |
| Qershor | 293 | 310 | 14 | 1 |
| Korrik | 263 | 271 | 22 | 5 |
| Gusht | 149 | 181 | 30 | 14 |
| Shtator | 232 | 233 | 16 | 0 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Tetor | 230 | 247 | 31 | 13 |
| Nëntor | 212 | 218 | 8 | 0 |
| Dhjetor | 219 | 235 | 21 | 8 |
| TOTAL | 3002 | 3217 | 270 | 62 |

*Tabela nr.11 Inspektimet e planifikuara nga DIPNP për periudhën Janar- Dhjetor 2024*

➢ **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN)**

Bazuar në të dhënat e sistemit të paraqitura në këtë tabelë rezulton se, DIPIEMN ka planifikuar në total **1876 inspektime**, ku **548 ose 29 %** e tyre **janë inspektime jashtë planit**. Në total janë kryer **3515** inspektime dhe **265** çështje janë të anulluara.

| Muaji | Planifikimi | Inspektime të Realizuara | Jashtë planit | Anulluara |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 138 | 247 | 43 | 0 |
| Shkurt | 174 | 252 | 13 | 0 |
| Mars | 163 | 250 | 38 | 34 |
| Prill | 181 | 300 | 43 | 3 |
| Maj | 155 | 290 | 69 | 13 |
| Qershor | 211 | 262 | 32 | 7 |
| Korrik | 188 | 326 | 72 | 31 |
| Gusht | 142 | 261 | 39 | 25 |
| Shtator | 200 | 318 | 32 | 6 |
| Tetor | 178 | 362 | 67 | 32 |
| Nëntor | 167 | 301 | 62 | 35 |
| Dhjetor | 181 | 346 | 38 | 79 |
| TOTAL | 1876 | 3515 | 548 | 265 |

*Tabela nr.12 Inspektimet e planifikuara nga DIPIEMN për periudhën Janar-Dhjetor 2024*

## 2.2 Identifikimi i Subjekteve të Mbyllura.

Gjatë vitit kalendarik 2024 janë verifikuar të gjitha inspektimet e realizuara për të identifikuar subjekte, të cilat janë të mbyllura dhe nuk duhet të jenë objekt inspektimi, me qëllim lehtësimin e procesit të planifikimit.

| Drejtoria Inspektuese | Subjekte të mbyllura | Nr. |
|---|---|---|
| DINGN | Subjekte të mbyllura | 43 |
| DIPNP | Subjekte të mbyllura/nuk disponon pnp/gln, i ka jashtë përdorimi pnp/gln, ka ndaluar aktivitetin, nuk është objekt inspektimi, remont i plotë | 366 |

| | | |
|---|---|---|
| DIPIEMN | Subjekte të mbyllura, nuk është objekt inspektimi ose nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar | 233 |

*Tabela nr.13 Inspektimet për subjekte të mbyllura periudhën Janar-Dhjetor 2024*

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, nga monitorimi në sistem i inspektimeve në total kemi **642 subjekte,** të cilat janë të mbyllura, nuk janë objekte inspektimi, nuk disponojnë pnp/ gln, kanë të ndaluar aktivitetin, ose nuk ushtrojnë aktivitet në adresën e deklaruar. Nga këto inspektime për DINGN janë 43 subjekte në total, për DIPNP 366 subjekte dhe për DIPIEMN 233 subjekte. Drejtoritë inspektuese janë vënë në dijeni për këto subjekte me qëllim planifikimin sa më të saktë të procesit të inspektimit.

### 2.3 Çështjet e Anulluara

Gjatë vitit kalendarik 2024 në total, në të tre drejtoritë inspektuese janë anulluar **339 çështje**. Shumica e këtyre çështjeve janë anulluar me arsyetimin:

- Bazuar në sistemin e- Inspektimi çështja është anulluar për shkak të problematikës së sistemit.
- Bazuar në procesverbalin, çështja anullohet për shkak të tejkalimit të afatit një mujor nga data e hapjes së çështjes.
- Bazuar në procesverbalin, çështja është anulluar për shkak të mungesës së automjetit.
- Bazuar në sistemin e-Inspektimi subjekti është inspektuar nga një grup tjetër i punës.
- Bazuar në procesverbalin është anulluar për shkak të ngarkesës në punë.
- Bazuar në procesverbalin për shkak të problematikës së sistemit çështjet e lëna riinspektim janë krijuar gabimisht dy herë në sistem.
- Bazuar në procesverbalin me kërkesë të subjektit për shtyrje afati është anulluar çështja.
- Bazuar në sistemin e-Inspektimi çështja është anulluar nga pamundësia për t'i mbyllur në kohë për shkak të temperaturave të larta.

➢ **<u>Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)</u>**

Për periudhën janar- dhjetor 2024 për DINGN nga **915 çështje** në total janë anulluar **12 çështje** ose **1.3 % e inspektimeve**. Shumica e këtyre çështjeve janë anulluar në bazë të arsyetimeve të lartpërmendura.

➢ **<u>Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP)</u>**

Për periudhën janar- dhjetor 2024, për DIPNP nga **3217** çështje në total janë anulluar **62 çështje** ose **1.8% e inspektimeve**. Shumica e këtyre çështjeve janë anulluar në bazë të arsyetimeve të lartpërmendura.

➢ **<u>Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN)</u>**

Për periudhën janar- dhjetor 2024, për DIPIEMN nga 3515 çështje në total janë anulluar **265 çështje** ose **10.4% e inspektimeve**. Shumica e këtyre çështjeve janë anulluar në bazë të arsyetimeve të lartpërmendura.

- **Drejtoria e Inspektimit të Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)**

Për periudhën janar- dhjetor 2024, për DSGIK nga 7 çështje në total, 1 çështje është anulluar.

### 2.4 Monitorimi i procesit të inspektimit.

Një nga objektivat e punës për Drejtorinë ka qenë monitorimi i inspektimeve dhe identifikimi i problematikave gjatë inspektimeve me qëllim përmirësimin dhe funksionimin sipas ligjit të procesit të inspektimit.

- **Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre DINGN**

Referuar sistemit e-Inspektimi për periudhën Janar- Dhjetor 2024 për DINGN janë planifikuar që të realizohen **861 çështje për inspektim** dhe totali i realizuar për vitin 2024 është **925 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara 158 inspektime janë jashtë planit, ndërkohë që 12 çështje në sistem rezultojnë të anulluara.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total **925** inspektime të realizuara nga DINGN, ku rezulton se në 43 inspektime ose 4 % prej tyre nuk kanë të ngarkuar dokumentacionin shoqërues.

Në 388 inspektime ose 42 % e tyre kanë kryer një proces të rregullt procedural duke ngarkuar në sistem të gjithë dokumentacionin e kërkuar, ku në grafikun ilustrues ka edhe përqindjen më të lartë të problematikave. Në 312 inspektime rezulton se ka pjesën më të madhe të dokumentacionit ose 34 %. Në 85 inspektime ose 9 % e tyre janë ngarkuar vetëm pjesërisht dokumentacione. Në 9 raste subjektit i lihet detyrë plotësimi i dokumentacionit. Në 18 inspektime ose 2% subjekti ka marrë masë administrative. Në 4 inspektime, subjekti është inspektuar më parë nga ISHTI. Në 16 raste ose 2 % është bërë inspektim special. Në 7 raste inspektimi të kryer me kërkesë të subjektit iu morën mostra për rianalizim. Në 43 inspektime ose 5% rezulton që subjektet janë të mbyllura.

| INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR DOKUMENTACION DINGN 2024 | |
|---|---|
| **Dokumentacioni shoqërues** | **Nr. Inspektimeve** |
| Nuk ka dokumentacion shoqërues / I lihet detyrë të bëjë sistemimin e rezervuarit gln | **43** |
| Ka dokumentacion shoqërues / I lihet detyrë të bëjë sistemimin e rezervuarit gln | **388** |
| Ka pjesën më të madhe të dokumentacionit / I lihet detyrë të bëjë sistemimin e rezervuarit gln | **312** |
| Ka dokumentacion pjesërisht / I lihet detyrë të bëjë sistemimin e rezervuarit gln | **85** |

| | |
|---|---|
| Subjektit i lihet detyrë plotësimi i dokumentacionit | 9 |
| Subjekti ka marrë masë administrative | 18 |
| Subjekti është inspektuar më parë nga ISHTI | 4 |
| Inspektim special | 16 |
| Inspektimi kryhet me kërkesë të subjektit /Subjektit iu morën mostra për rianalizim | 7 |
| Subjekti është i mbyllur/Subjekti nuk ushtron aktivitet në këtë adresë/ Subjekti është në rikonstruksion etj | 43 |

*Tabela nr.14 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DINGN*




*Grafiku nr.15 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DINGN*

➢ **Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion DIPNP** .

Referuar sistemit e-Inspektimi, për periudhën Janar- Dhjetor 2024, për DIPNP janë planifikuar **3002 inspektime** dhe janë realizuar në total **3217 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara janë **270 inspektime** jashtë planit, ndërkohë që janë **62 çështje** në sistem që rezultojnë të anulluara.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total **3217** inspektime të realizuara nga DIPNP, ku rezulton se vetëm **9** prej tyre apo **0.2%** nuk kanë dokumentacion shoqërues në sistem, **2369** inspektime ose **72.2 %** kanë dokumentacion shoqërues/ka pjesën më të madhe të dokumentacionit.

Në 6 inspektime ose **0.1%** ka dokumentacion pjesërisht. Në **366** inspektime ose **11.1%** janë subjekte të mbyllura/ nuk disponon pnp/ gln, i ka jashtë përdorimi pnp/ gln/ ka ndaluar aktivitetin, janë në remont të plotë apo nuk janë objekt inspektimi. Në **281** inspektime ose **8.5 %** subjekti disponon bombola gln të lëvizshme <25 kg/ kaldajë <95°celcius/ bombola të gazrave teknik/ bombola oksigjeni/ çisterna automobilistike/ kompresor ajri. Në **118** inspektime ose **3.5 %** subjektit i është lënë detyrë/ shtyrje e afatit të inspektimit.

Në **66** inspektime ose **2%** subjektet kanë ndryshuar adresë/ pronësi/ NIPT/ janë në proces rikonstruksioni/ proces vënie pune të pajisjes apo nuk ka informacion për përfaqësuesin. Në **2** inspektime subjekti nuk disponon dokumentacion dhe për këtë arsye ka marrë masë administrative. Nga **3279** inspektime në total, **62** inspektime ose **1.8%** janë çështje të anulluara.

| INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR DOKUMENTACION DIPNP 2024 | |
|---|---|
| **Dokumentacioni shoqërues** | **Nr.Inspektimeve** |
| Ka dokumentacion shoqërues/ Ka pjesën më të madhe të dokumentacionit | **2369** |
| Nuk ka dokumentacion shoqërues | **9** |
| Ka dokumentacion pjesërisht | **6** |
| Çështje të anulluara | **62** |
| Subjekte të mbyllura/ Nuk disponon pnp/ gln, i ka jashtë përdorimi pnp/gln, Ka ndaluar aktivitetin, janë në remont të plotë apo nuk janë objekt inspektimi | **366** |
| Subjekti disponon bombola gln të lëvizshme <25 kg/ kaldajë/ bombola të gazrave teknik, bombola oksigjeni/ çisterna automobilistike/ kompresor ajri | **281** |
| Subjektit i është lënë detyrë/Shtyrje e afatit të inspektimit | **118** |
| Subjekte që kanë ndryshuar adresë/ pronësi/ NIPT/ janë në proces rikonstruksioni/ proces venie pune të pajisjes apo nuk ka informacion për përfaqësuesin | **66** |
| Subjekti ka marrë masë administrative | **2** |

*Tabela nr.16 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPNP*




*Grafiku nr.17 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPNP*

- **Drejtorina e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN)**

Referuar sistemit e-Inspektimi, për periudhën janar- dhjetor 2024, për DIPIEMN rezultojnë në total **3780 inspektime,** nga këto janë realizuar **3515 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara **548 inspektime janë** jashtë planit, të planifikuara rezultojnë **1876**, ndërkohë **265 çështje** në sistem rezultojnë të anulluara.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total **3515 inspektime** të realizuara nga DIPIEMN, ku rezulton se në **1659** inspektime ose **47%** subjektit i është lënë detyrë plotësimi i dokumentacionit, ku edhe në grafikun ilustrues ka përqindjen më të lartë. Në **1324 inspektime** ose **38%** e inspektimeve kanë të ngarkuar dokumentacion shoqërues/ ka pjesën me të madhe të dokumentacionit. Në **135 inspektime** ose **4% subjekti** ka kërkuar shtyrje afati të inspektimit. Në **35 inspektime** ose **1%** ka dokumentacion pjesërisht.

Në **41 inspektime** ose **1%** e tyre nuk ka dokumentacion shoqërues. Në **39 inspektime** ose **1%** subjekti ka marrë masë administrative. Në **233 inspektime** ose **7%** janë subjekte të mbyllura, nuk është objekt inspektimi ose nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar/ proces rikonstruksioni ose zhvendosjeje. Në **25 inspektime** ose **1%** e inspektimeve, inspektimi nuk është realizuar/

inspektuar gabimisht. Në **10 inspektime** subjekti ushtron aktivitet në adresë tjetër, po në **10 inspektime** subjekti është në proces inspektimi. Në **4 inspektime** nuk ka listë verifikim.

| INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR DOKUMENTACION DIPIEMN 2024 | |
|---|---|
| **Dokumentacioni shoqërues** | **Nr. Inspektimeve** |
| Ka dokumentacion shoqërues/ Ka pjesën më të madhe të dokumentacionit | **1324** |
| Subjektit i është lënë detyrë plotësimi i dokumentacionit | **1659** |
| Ka dokumentacion pjesërisht/ I lihet detyrë të raportojë pranë ISHTI | **35** |
| Nuk ka dokumentacion shoqërues/ Subjektit i lihet detyrë plotësimi i një pjese të dokumentacionit. | **41** |
| Subjekti ka kërkuar shtyrje afati inspektimi | **135** |
| Subjekti ka marrë masë administrative | **39** |
| Subjekti është i mbyllur | **233** |
| Subjekti operon në të njëjtën adresë me një subjekt tjetër/Subjekti ushtron aktivitet në një adresë tjetër. | **10** |
| Subjekti është në proçes inspektimi/inspektuar më parë nga inspektorë të ISHTI | **10** |
| Inspektimi nuk është realizuar/Inspektuar gabimisht | **25** |
| Inspektimi nuk ka listë verifikimi | **4** |

*Tabela nr.18 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPIEMN*




*Grafiku nr.19 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPIEMN*

## ➢ Drejtoria e Inspektimit të Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)

Referuar sistemit e-Inspektimi, për periudhën Janar- Dhjetor 2024, për DSGIK janë planifikuar 7 **inspektime** dhe janë realizuar në total **6 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara, **1 inspektim** është jashtë planit, ndërkohë që **1 çështje** në sistem që rezulton e anulluar. Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total **6** inspektime të realizuara nga DSGIK, ku rezulton se vetëm **5** prej tyre janë subjekte të mbyllura, **1** inspektim ka dokumentacion shoqërues. Në **6** inspektime nuk është marrë masë administrative.

## II. DREJTORIA E LABORATORIT QENDROR (DLQ)

Drejtoria e Laboratorit Qendror si hallkë përbërëse kryesore e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial ushtron veprimtarinë e saj duke përmbushur me profesionalizëm, saktësi dhe kohë detyrën kryesore të saj, kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, si dhe analizave të detergjentëve të ndryshëm në Laboratorin e Tekstilit.
Analizat kryhen në përputhje me kërkesat e standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare që mbulojnë fushën e shërbimit për testimin e kampioneve të marra në dogana. tregun e brendshëm dhe të tretë. Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar Analizën e Punës së kryer për vitin 2024, të ndarë sipas sektorëve.

### 1. Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve është i angazhuar që çdo veprimtari të jetë në përputhje me kërkesat e standardit S SH EN ISO 17025 : 2017, i cili bën të mundur rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së tërësisë së analizave që kryhen nga ky laborator.
Gjatë vitit 2024 në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve u testuan gjithsej **7267** kampione, nga të cilat **3346** kampione të marra në dogana dhe **3891** kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: **832** kampione janë sondazhe, **3042** kampione janë të plota dhe **47** kampione janë palë e tretë nga të cilat **17** kanë hyrë nga kodifikimi dhe **30** prej tyre nga zyra e protokolli. Nga analizimi, **11** kampionë, përkatësisht 9 gazoil, 1 benzinë dhe 1white spirit, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2024.

*Krahasimisht gjatë vitit 2023 u testuan gjithsej **6507** kampione nga të cilat **2599** kampione të marra në dogana dhe **3854** kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: **783** kampione janë sondazhe, **3071** kampione janë të plota, **54** kampione janë palë e tretë ku **39** kampione kanë ardhur të sekretuara nga zyra e protokollit dhe **15** kampione të sekretuara nga zyra e kodifikimit. Nga analizimi 3 kampionë, përkatesisht 2 gazoil dhe 1 white spirit, kanë rezultuar me shmangie nga standarti gjatë vitit 2023.*

Në mënyrë të detajuar në tabelën nr.1 paraqiten të pasqyruara kampionet e analizuara për vitin 2024 të ndara në kampione të marra në dogana, tregu i brendshëm (të plota, sondazhe) dhe palë të treta të hyra nga zyra e kodifikimit.

| Nr. | Emri i kampionit | Doganë | Tregu i brendshëm | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kampione | Të plota | Sondazh | Të tretë | TOTAL |
| 1 | Benzinë | 634 | 954 | 345 | 1 | **1934** |
| 2 | Gazoil | 1277 | 1069 | 477 | 1 | **2824** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Vajgur avioni | 15 | 8 | 0 | - | 23 |
| 4 | Lëndë djegëse | 12 | 3 | 0 | 1 | 16 |
| 5 | GLN | 131 | 748 | 2 | - | 881 |
| 6 | Vaj lubrifikant | 911 | 202 | - | - | 1113 |
| 7 | Bitum | 290 | 16 | - | - | 306 |
| 8 | Antifrizë | - | - | - | - | 0 |
| 9 | Naftë bruto | 26 | 18 | 1 | 14 | 59 |
| 10 | Mazut | 27 | 11 | 6 | - | 44 |
| 11 | Solar | - | - | - | - | 0 |
| 12 | Graso | 7 | 7 | - | - | 14 |
| 13 | Benzin avionesh | - | 3 | - | - | 3 |
| 14 | Biodiesel | 1 | - | - | - | 1 |
| 15 | Produkte të tjera | 1 | - | 1 | - | 2 |
| 16 | Hollues | 8 | - | - | - | 8 |
| 17 | Gjysëm produkt | 5 | 3 | - | - | 8 |
| 18 | White spirit | 1 | - | - | - | 1 |
| | **TOTAL** | **3346** | **3042** | **832** | **17** | **7237** |

Në tabelën nr.2. paraqiten kampionet me tregues jashtë standarti gjatë vitit 2024.

| NR. | DATA | KAMPIONI | TREGUESI ME SHMANGIE NGA STANDARDI |
|---|---|---|---|
| 1. | 25.01.2024 | Gazoil | Përmbajtja e squfurit |
| 2. | 07.03.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |
| 3. | 15.04.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |
| 4. | 15.04.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |
| 5. | 30.04.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |
| 6. | 30.04.2024 | Benzinë | RON, MON, Pika finale e distilimit |
| 7. | 24.05.2024 | Gazoil | Përmbajtja e squfurit |
| 8. | 03.06.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |
| 9. | 25.07.2024 | White spirit | Temperatura e mbarimit të vlimit |
| 10 | 13.08.2024 | Gazoil | Sasi e lartë uji |
| 11. | 23.09.2024 | Gazoil | Pika e flakërimit |

*Në mënyrë të detajuar në tabelën nr. 3 paraqiten për vitin 2023 të ndara këto në kampione të marra në dogana, tregu i brendshëm (të plota, sondazhe) dhe palë të treta te hyra nga zyra e kodifikimit.*

| Nr. | Emri i kampionit | Doganë | Subjekt | | | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kampione | Të plota | Sondazh | Të tretë | |
| 1. | Benzinë | 468 | 972 | 247 | 2 | **1689** |
| 2. | Gazoil | 829 | 1087 | 511 | 7 | **2434** |
| 3. | Vajgur avioni | 11 | 7 | - | - | **18** |
| 4. | Lëndë djegëse | 7 | - | 1 | - | **8** |
| 5. | GLN | 166 | 729 | 4 | - | **899** |
| 6. | Vaj lubrifikant | 913 | 204 | 2 | 4 | **1123** |
| 7. | Bitum | 131 | 19 | - | 1 | **151** |
| 8. | Antifrizë | - | - | 2 | - | **2** |
| 9. | Naftë bruto | 27 | 26 | 11 | - | **64** |
| 10. | Mazut | 27 | 13 | 1 | 1 | **42** |
| 11. | Solar | - | - | - | - | - |
| 12. | Graso | 4 | 6 | - | - | **10** |
| 13. | Benzin avionesh | - | 2 | - | - | **2** |
| 14. | Biodiesel | 1 | - | 1 | - | **2** |
| 15. | Antifriz | - | - | - | - | - |
| 16. | Hollues | 11 | - | - | - | **11** |
| 17. | Gjysëm produkt | 3 | 6 | - | - | **9** |
| 18. | Lamix | 1 | - | - | - | **1** |
| 19. | White spirit | - | - | 3 | - | **3** |
| | **TOTAL** | **2599** | **3071** | **783** | **15** | **6468** |

*Krahasimisht gjatë vitit 2023 kanë rezultuar 3 kampione me tregues jashtë standardit të paraqitura në tabelën nr.4.*

| *Nr* | ***Emri i kampionit*** | ***Numri i kampioneve jashtë standardit*** |
|---|---|---|
| *1.* | *Gazoil* | *2* |
| *2.* | *White Spirit* | *1* |

Grafik krahasues nr.1 dhe nr.2 - Kampionet e analizuar në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve gjate vitit 2023 dhe 2024







Krahas përmbushjes së detyrës të kryerjes së testimeve, stafi i laboratorit ka përmbushur edhe detyra të tjera që përshkruhen si më poshtë:

- Implementimi dhe zbatimi në mënyrë të vazhdueshme i të gjitha kërkesave të ISO 17025-2017, për të përmbushur të gjitha detyrat e një laboratori të akredituar.
- Përfundimi me sukses i vizitës vlerësuese të Laboratorit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nga ku **nuk pati asnjë moskomformitet**.
- Përfundimi me sukses i proçesit të mirëmbajtjes dhe kalibrimit të jashtëm të aparaturave.

- Përshtatja e procesit të analizave sipas Standardeve të reja nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.
- Pjesmarrja në test krahasimi ndërkombëtar me Laborator të Akredituar Grek dhe vlerësimi maksimal për rezultatet nga analizimi i kryer i mostrës.
- Pjesëmarrja e punonjëseve në trajnim, i cili ndikon në ngritjen profesionale të stafit dhe njohjen e përshtatjen me metodat e reja bashkëkohore.
- Përfundimi pa sukses i proçesit të blerjes së aparatit të ri për analizmin e treguesve tek benzina.
- Aplikimi për proçedurën e riakreditimit nga DPA, të Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

➢ **Objektivat për vitin 2025:**

a. Në proçes riakreditimi i Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve;
b. Vendosja e sistemit të kondicionimit për të ruajtur mostrat në kushte optimale dhe ventilimit antizjarr në ambjentet e magazinimit të mostrave për largimin e avujve të krijuar nga qëndrimi i mostrave në këto ambjente. Në këto kushte bëjmë të mundur evitimin e probabilitetit të zjarrit të mundshëm nga avujt e këtyre karburanteve.
ç. Për limitimin e rrezikut të eksplodimit dhe kontaminimit të personelit është e domosdoshme vendosja e detektorëve për tejkalimin e përqëndrimit të nivelit të gazit dhe të avujve hidrokarbure të dëmshëm për shëndetin e personelit dhe eleminimin e ndonjë zjarri të mundshëm, detektorë zjarri dhe sistem fikje zjarri të menjëhershëm, detektorë për rrjedhje gazesh si helium, oksigjen dhe gaz i lëngshëm etj. Mirëmbajtje të sistemit të ventilim - kondicionimit dhe rishikimi për shtesa dhe përshtatje e ventilimit në përputhje me kërkesat e kushteve të analizimit.
d. Objektiv në vazhdimësi mbetet <u>blerja e aparateve të reja për shtimin e mëtejshëm të treguesve të analizuar</u>, njohja dhe shfrytëzimi i literaturës së re si dhe metodikave bashkëkohore.
e. Shërbimi i inspektimit të mirëmbajtjes, riparimit dhe kalibrimit pasi është një procedurë e pashmangshme dhe e domosdoshme për Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve dhe kriter i domosdoshëm për mbajten e titullit "Laborator i Akredituar"
f. Pjesëmarrja e vazhdueshme në trajnime në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, gjë e cila ndikon në ngritjen profesionale të stafit dhe njohjen e përshtatjen me metodat e reja bashkëkohore.

**2. <u>Laboratori i Tekstileve</u>**

Sektori i Laboratorit të Tekstileve ka si qëllim kryesor të punës së tij vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e të gjitha analizave laboratorike, si dhe vendosjen e kritereve për vlerësimin e efektivitetit të indikatorëve me të cilat menaxhohen risqet, në mënyrë që analizat të kryhen në çdo kohë të kërkuar, me cilësi, saktësi dhe në afatin e duhur. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 në Laboratorin e Tekstileve janë realizuar objektivat si më poshtë:

a. Një nga prioritetet e Laboratorit të Tekstileve gjatë kësaj periudhe, ka qenë realizimi i Akreditimit, futja e metodikave të reja, si dhe trajnimi i personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe pajisja e laboratorit me aparatura të reja bashkëkohore, me qëllim rritjen e numrit të përcaktimeve/zërave në të ardhmen.

b. Laboratori i Tekstileve gjatë kësaj periudhe është përpjekur të përmirësojë përformancën e tij, duke implementuar standarde të reja në fushën e tekstilit, detergjentëve dhe letrës. Laboratori gjatë kësaj periudhe është pajisur me disa aparatura të reja si:
   i. Peshore teknike 0 deri 3200gr,
   ii. Peshore analitike 220gr, 0.1mg,
   iii. Titrator automatik me dy module,
   iv. Aparat për matjen e opacitetit të letrës,
   v. Aparat për përcaktimin e trashësisë së letrës dhe tekstilit, dendësisë dhe vëllimit specifik.

c. Në rastet kur për ndonjë metodikë standardi mund të mos gjendet zbatim konkret, është bërë përpjekje të përdoren metoda alternative të botuara dhe pranuara në literaturën shkencore ose të aplikuara nga laboratorë kimikë të fushës së prodhimit përkatës. ***Kjo e fundit rekomandohet dhe nga standarti ISO 17025-2005 mbi "Akreditimin e Laboratorëve".*** Në këto kushte, është punuar paralelisht si mbi përgatitjen e dokumentacionit, ashtu edhe mbi implementimin e tyre.

d. Gjatë kësaj periudhe, pranë laboratorit janë realizuar kryesisht analiza detergjentësh të ndryshëm si: solucione për larje dyshemeje, sapun likuid, larës rrobash, pastrues yndyre, sapun rrobash, zbardhues, etj.

Më poshtë paraqitet një analizë e detajuar dhe konkrete mbi punën e kryer në përgatitjen e dokumentacionit për akreditimin e Laboratorit te Teksileve

**A. Qëllimi i Akreditimit të Laboratorit të Tekstileve**

- Akreditimi i Laboratorit Tekstileve, sipas standardit ISO/IEC 17025, për të treguar kompentencën teknike në testimin e detergjentëve, tekstileve, letrës, gomë plastikës, bojës timbruese, etj.
- Rritja e besueshmërisë në treg për rezultatet e testimit të produkteve të detergjentëve, tekstileve, letrës, gomë plastikës, bojës timbruese etj, duke garantuar cilësi dhe pajtueshmëri me standardet kombëtare e ndërkombëtare.

**B. Puna e kryer për përgatitjen e dokumentacionit**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeinspektorit të ISHTI-t Nr.87, datë 03.07.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurës dhe hartimin e dokumentave të nevojshëm për Akreditimin e Laboratorit të Tekstileve në Drejtorinë e Laboratorit Qendror" janë përgatitur dhe hartuar:

a. **Manuali i Cilësisë,** që përfshin politikat e menaxhimit të cilësisë specifike për testimet e detergjentëve, tekstileve, letrës, gomë plastikës, bojës timbruese, duke përfshirë të gjitha kërkesat e standardit ISO/IEC 17025.
b. **Procedurat menaxhuese**
c. **Rregullore e brendshme e Laboratorit të Tekstileve**
d. Procedura Standarde të Operimit (SOPs), u hartuan 16 SOPs të fokusuara në:
   i. Për përcaktimin e densitetit në detergjent të lëngët me piknometër në temperaturë 20 °C.
   ii. Për përcaktimin e densitetit në pluhura larës përmes matjes së nje vëllimi të caktuar në detergjent.

iii. Për përcaktimin e përqëndrimit të Joneve Hidrogjen [H+], pH ne detergjent
iv. Për përcaktimin e përmbajtjes së Oksigjenit aktiv në detergjent
v. Për përcaktimin e lagështisë në detergjent
vi. Për përcaktimin e aftesisë shkumuese në detergjent
vii. Për përcaktimin e lëndës active në detergjent
viii. Për përcaktimin e klorit aktiv në detergjent
ix. Për përcaktimin e përmbajtjes së lagështisë të letrës offset.
x. Për përcaktimin e trashësisë së letrës, kartonit
xi. Për përcaktimin e të opacitetit të letrës
xii. Për përcaktimin e plumbit dhe kadmiumit në qelq qeramikë
xiii. Procedura teknike e kontrollit të peshores analitike
xiv. Procedura teknike e kontrollit të enëve volumetrike
xv. Për përcaktimin e metaleve të rënda në Plastike dhe Tekstil me spektrometri XRF
xvi. Për përcaktimin e Trashësisë së Tekstileve

e. **Dokumentimi i Pajisjeve dhe Kalibrimeve,** janë dokumentuar të gjitha pajisjet, kalibrimet e nevojshme dhe mirëmbajtja e tyre, si spektrofotometrat, pH-metrat, aparaturat për testet e tekstileve dhe enët volumetrike.

C. **Rezultatet e Arritura**

a. Përditësimi i Metodave të Testimit: Disa nga metodat e testimit të detergjentëve ishin të vjetëruara dhe nuk përputheshin me standardet ndërkombëtare të përditësuara, duke kërkuar rishikime dhe përditësime të detajuara. U realizua blerja dhe implementimi i tyre.
b. Kryerja e një krahasimi ndërlaboratorik në fushën e detergjentëve me laboratorin e Kompanisë 'DEKA"SH.A.
c. Kryerja e një krahasimi ndërlaboratorik me Smither –Paper në fushën e Letrës në Nëntor 202.
d. Bashkëpunim me Agenzia Delle Dogane e Dei Monopoli për kryerjen e një test krahasimi ndërlaboratorik në fushën e tekstileve, që do të realizohet në Mars 2025.
e. Plotësimi i dosjes me dokumentacionin e akreditimit.
f. Dërgimi në muajin Dhjetor 2024 kontrata për bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA), për çeljen e proçedurës për Akreditimin e Laboratorit të Tekstileve.
g. Rritje e cilësia e testimeve.
h. Gjithashtu, në laborator janë analizuar për vitin 2024, gjithsej 73 analiza për palët e treta kryesisht në fushën e detergjentëve larës.

Në krahasim me vitin 2023, sikundër edhe do të gjeni të ilustruar më poshtë, kemi të njëjtin numër testimesh të kryera 73 (4 testime për bojë timbruese dhe 69 testime për detergjent larës). Theksojmë se numri i analizave të kryera nga varet nga kërkesat e palëve të treta.

*Më poshtë tabela krahasimore: 2023-2024*

| MUAJI | Numri i testimeve **Për vitin 2024** | Numri i testimeve **Për vitin 2023** |
|---|---|---|
| **Janar** | **0** | **4 bojë timbruese** |

| | | |
|---|---|---|
| Shkurt | 37 | 11 |
| Mars | 6 | 0 |
| Prill | 3 | 11 |
| Maj | 0 | 9 |
| Qershor | 5 | 0 |
| Korrik | 0 | 28 |
| Gusht | 0 | 0 |
| Shtator | 13 | 0 |
| Tetor | 9 | 6 |
| Nentor | 0 | 0 |
| Dhjetor | 0 | 4 |
| Total teste | 73 | 73 |




Implementimi i metodikave të reja është i lidhur ngushtë me pajisjen e laboratorit me aparatura të reja, pa të cilat nuk mund të zbatohen metodikat bashkëkohore sipas standarteve europiane. Gjatë kësaj periudhe, duke konsultuar Standardin e Akreditimit ISO 17025:2017, me kërkesat e tregut si dhe literaturën bashkohore u hartuan:

- Lista e plotë me pajisjet që duhet të kalibrohen çdo vit në Laboratorin e Tekstileve gjatë 2025;
- Lista për blerje CRM për 2025;
- Kërkesa për uniforma personeli për vitin 2025;
- Kërkesa për blerje materiale për mirëmbajtjen e mjedisit për vitin 2025;
- Kërkesa për kimikate dhe enë laboratorike për 2025;
- Kërkesa për blerje aparaturash të reja për vitin 2025:

| Nr | Instrumente/aparatura për Laboratorin Tekstil-Detergjentë |
|---|---|
| 1 | Mikroton rotullues gjysëm automatik |
| 2 | Metër shirit profesional |

| | |
|---|---|
| 3 | Furrë mufel |
| 4 | Absorber Atomik |
| 5 | Aparat PH metër |
| 6 | Frigorifer ftohës për laborator |

**D. Rekomandime për përmirësim.**

a. **Implementimi i Aparaturave të Reja**: Sugjerohet investimi në pajisje më të avancuara për testimet e tekstileve, detergjentëve, letrës, bojës timbruese, gomë plastikës për të reduktuar kohën dhe për të rritur saktësinë.

b. **Monitorim i Vazhdueshëm i Performancës**: Krijimi i një procesi të monitorimit të vazhdueshëm për t'u siguruar që pajtueshmëria me standardet mbahet në nivele të larta dhe për të adresuar çdo ndryshim në standarte ose kërkesa rregullatore.

**E. Konkluzione**

Procesi i përgatitjes së dokumentacionit për akreditimin e laboratorit ishte suksesshëm. Akreditimi pritet të përmirësojë pozicionin konkurues të Laboratorit të Tekstileve në treg dhe të sigurojë që rezultatet e testimeve të jenë të besueshme dhe të vlefshme për klientët.

**F. Objektiva**

a. **Akreditimi i Laboratorit të Tekstileve, sipas Standartit ISO 17025**, i cili fakton kompetencën dhe besueshmërinë profesionale dhe teknike të këtij laboratori, si një domosdoshmëri imediate në vlerësim të situatës dhe kërkesave të tregut;

b. **Saktësim të emërtimit të laboratorit**, bazuar në gamën e analizave që përfshin. Emërtimi që propozohet është: **"Laboratori i Industrisë së Lehtë Jo-Ushqimore"**. Kjo për faktin se, Laboratori me emërtimin "i Tekstileve" sipas strukturës se re nuk kryen vetëm analiza të matricës tekstil. Ky laborator në zanafillën e tij është projektuar të kryejë (dhe ka kryer) ndër vite analizat e matricave si më poshtë vijon:

- Analiza të lëkurë-këpucës;
- Qelq-Qeramikë;
- Gomë-plastikë;
- Analizë letre;
- Bojra dhe vernikë të ndryshëm;
- Tekstile të ndryshëm;
- Detergjentë ...etj.

c. **Shtimi në strukturë** të dy pozicioneve: një specialist me titullin ***"Menaxher cilësie"*** dhe një tjetri me titullin:*"Kodifikues"*.

d. **Rregullimi i bazës ligjore**, me qëllim rritjen e efikasitetit laboratorik të të gjitha matricave të lartëpërmendura, në mënyrë që analizat e kryera t'u ofrohen jo vetëm palëve të treta, por edhe zhdoganimeve cilësore të produkteve të gatshme të importit, sikundër edhe të çertifikojë produktet që prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

## III. DREJTORIA E TRAJTIMIT TË AKSIDENTEVE DHE MBIKËQYRJES (DTAM)

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM), ka nisur aktivitetin e saj operativ në muajin Maj të vitit 2024. Ky raport përmbledh arritjet dhe veprimtaritë e realizuara gjatë vitit 2024 në përputhje me detyrat funksionale të drejtorisë.

**Misioni**

Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes ka si mision kryesor të punës së saj bashkërendimin dhe kontrollin e respektimit të rregullave, kritereve dhe kushteve teknike të sigurisë së jetës së njerëzve, mjedisit dhe vlerave materiale në rast aksidenti dhe raste të veçanta, si dhe sigurimin e realizimit të proceseve të punës dhe inspektuese, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi.

DTAM është organizuar në përputhje me strukturën e përcaktuar në kuadër të funksioneve të ISHTI-së dhe përfshin dy sektorë kryesorë:

1. **Sektori i Trajtimit të Aksidenteve**, ky sektor ka si detyrë kryesore trajtimin teknik të aksidenteve të ndodhura në fushat e veprimit të drejtorive inspektuese. Ai siguron analiza të detajuara dhe nxjerr përfundime mbi shkaqet teknike dhe masat e nevojshme për parandalimin e ngjarjeve të ngjashme

2. **Sektori i Mbikëqyrjes**, ky sektor mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e masave të sigurisë nga subjektet me risk të lartë, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin teknik dhe duke vlerësuar efektivitetin e masave parandaluese.

- **Detyrat kryesore të Drejtorisë/Objektivat**

1. Trajton të gjitha rastet e aksidenteve sipas legjislacionit të posaçëm për çdo drejtori inspektuese.
2. Krijon dhe implementon praktikat për trajtimin e aksidenteve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Dokumenton aksidentin e ndodhur, nga pikëpamja profesionale, referuar legjislacionit sektorial në fuqi, me qëllim përmirësimin e programeve të menaxhimit të sigurisë së instalimeve elektrike, pajisjeve nën presion, instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse për sektorin e hidrokarbureve dhe gazit natyror.
4. Harton dhe përgatit dokumentacionin përmbledhës mbi ngjarjen për rrethanat, shkaqet dhe pasojat e aksidentit.
5. Krijon bazën e të dhënave për aksidentet e trajtuara nga kjo drejtori në format elektronik dhe fizik.
6. Zbaton dhe garanton paanshmërinë, transparencën, objektivitetin e strukturës mbikëqyrëse të ISHTI-t për parandalimin e aksidenteve.
7. Mbikëqyr të gjitha subjektet inspektuese me risk të lartë bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Analizës dhe Vlerësimit të Riskut, që inspektohen nga ISHTI sipas programeve të miratuara.

1. **Sektori i Trajtimit të Aksidenteve**

Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (S.T.A.), është përgjegjës për trajtimin e aksidenteve që ndodhin në fushat e mbuluara nga drejtoritë inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial. Ky sektor garanton analizën dhe vlerësimin profesional të çdo rasti, duke ndjekur standardet teknike dhe ligjore në fuqi, me fokus në identifikimin e shkaqeve dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen. Gjatë periudhës maj-dhjetor 2024, **Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (S.T.A.)** ka regjistruar gjithsej **39 aksidente**, të cilat kanë pasur pasoja të rënda për jetën dhe pronën. Shpërndarja e aksidenteve sipas natyrës dhe pasojave është si vijon:

- **15 aksidente** kanë përfunduar tragjikisht me humbje jete të qytetarëve dhe punonjësve.
- **4 aksidente** kanë shkaktuar dëmtime fizike të konsiderueshme te qytetarët dhe punonjësit.
- **20 aksidente** kanë rezultuar në dëme të mëdha materiale, duke prekur pronën private.






A. **Krahasimi i Aksidenteve sipas Tremujorëve të Vitit 2024**

Gjatë vitit 2024, shpërndarja e aksidenteve të regjistruara është analizuar në bazë të dy periudhave kryesore:

1. Periudha Maj-Gusht 2024: Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar gjithsej 20 aksidente, duke përbërë një përqindje më të lartë të ngjarjeve krahasuar me tremujorët pasues. Kjo periudhë karakterizohet nga një intensitet më i madh i aktiviteteve.

2. Periudha Shtator-Dhjetor 2024: Në këtë periudhë janë regjistruar gjithsej 19 aksidente, një numër pak më i ulët krahasuar me periudhën paraprake. Reduktimi i lehtë i aksidenteve mund të lidhet me përmirësimin e masave parandaluese dhe monitorimit, si dhe me uljen e intensitetit të aktiviteteve në fund të vitit.




B. **Analiza e Aksidenteve për Periudhën Maj-Dhjetor 2024**

Gjatë periudhës maj-dhjetor 2024, Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (S.T.A.) ka trajtuar gjithsej 39 aksidente, të cilat janë klasifikuar sipas fushave të veprimit të drejtorive inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) si vijon:

I. **Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN):** Janë trajtuar 28 aksidente, të cilat përbëjnë shumicën e rasteve të regjistruara gjatë kësaj periudhe. Kjo fushë përfshin aksidente të ndodhura në instalime elektrike, makineri ngritëse dhe pajisje të tjera industriale, që përbëjnë një nivel të lartë rrezikshmërie.

II. **Drejtoria Inspektuese e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN):** Janë regjistruar 3 aksidente, të cilat lidhen me rrjedhje, shpërthime ose incidente të tjera që përfshijnë naftën dhe nënproduktet e saj.

III. **Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve nën Presion (DIPNP):** Janë trajtuar 8 aksidente, të cilat përfshijnë ngjarje në lidhje me pajisjet që operojnë nën presion.

## GRAFIKU 1. - NATYRA E AKSIDENTEVE TË TRAJTUARA NGA S.T.A PËR PERIUDHËN MAJ-SHTATOR 2024




- Klasifikimi i Aksidenteve në fushën e veprimit të DIPIEMN

Gjatë periudhës maj-dhjetor 2024, aksidentet e trajtuara në fushën e veprimit të **(DIPIEMN)** janë klasifikuar si vijon, bazuar në pasojat e evidentuara:

1. **Aksidente me pasojë humbjen e jetës së njerëzve: 12 aksidente** janë raportuar me humbje të jetëve njerëzore, duke përbërë një shqetësim të madh për sigurinë teknike dhe zbatimin e standardeve në instalime elektrike dhe makineri ngritëse.
2. **Aksidente me pasojë dëmtimin e pronës private: 14 aksidente** kanë rezultuar në dëme të konsiderueshme materiale, që përfshijnë prishjen ose dëmtimin e pajisjeve dhe instalimeve.
3. **Aksidente me pasojë plagosjen e njerëzve: 2 aksidente** kanë shkaktuar plagosje ose lëndime fizike të qytetarëve apo punonjësve.

## GRAFIKU 2. - NATYRA E AKSIDENTEVE TE ELEKTRIKE



## Klasifikimi i Aksidenteve në fushën e veprimit të DINGN

Gjatë periudhës maj-dhjetor 2024, aksidentet e trajtuara në fushën e veprimit të **(DINGN)** janë klasifikuar si më poshtë, bazuar në pasojat e evidentuara:

1. **Aksident me pasojë humbjen e jetës: 1 aksident** ka rezultuar në humbjen tragjike të jetës së një personi, duke theksuar rrezikun e lartë që shoqëron operacionet në këtë sektor.
2. **Aksident me pasojë dëmtimin e pronës private: 1 aksident** ka sjellë dëmtime materiale në pronën private, përfshirë dëmtimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të ndërlidhura me naftën dhe gazin.
3. **Aksident me pasojë dëmtime fizike te njerëzit: 1 aksident** ka shkaktuar plagosje ose lëndime fizike, duke përfshirë individë të ekspozuar ndaj rreziqeve në proceset e punës në këtë fushë.




## Klasifikimi i Aksidenteve në Fushën e Veprimit të DIPNP

Gjatë periudhës maj-dhjetor 2024, aksidentet e trajtuara në fushën e veprimit të **(DIPNP)** janë klasifikuar si më poshtë, bazuar në pasojat e evidentuara:

1. **Aksidente me pasojë humbjen e jetës: 2 aksidente** kanë përfunduar me humbje tragjike të jetës, duke nënvizuar rrezikshmërinë e lartë të operimit të pajisjeve që funksionojnë nën presion.
2. **Aksidente me pasojë plagosjen e njerëzve: 2 aksidente** kanë shkaktuar plagosje apo lëndime fizike, duke përfshirë personat e ekspozuar ndaj këtyre pajisjeve gjatë operimit ose mirëmbajtjes së tyre.
3. **Aksidente me pasojë dëmtimin e pronës private: 4 aksidente** kanë rezultuar në dëmtime të konsiderueshme materiale, duke përfshirë shkatërrimin e pajisjeve, strukturave apo objekteve të tjera në afërsi të pajisjeve nën presion.

## GRAFIKU 4. - NATYRA E AKSIDENTEVE DIPNP




- **Analiza e Shpërndarjes së Aksidenteve sipas Fushës së Veprimit**

Sikurse reflektohet nga grafiku i mëposhtëm, **numri më i lartë i aksidenteve** është regjistruar në fushën e veprimit të **(DIPIEMN)**. Kjo Drejtori përfaqëson pjesën më të madhe të rasteve të trajtuara, duke nënvizuar rrezikun e lartë që lidhet me operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe instalimeve elektrike, si dhe makinerive ngritëse. Gjithashtu, **numri më i madh i aksidenteve me pasojë humbjen e jetës** është raportuar në këtë fushë veprimi. Ky fakt tregon nevojën për një mbikëqyrje të shtuar dhe implementimin e masave më të forta parandaluese, për të minimizuar rreziqet që mund të rezultojnë fatale për jetën e njerëzve.



### Objektivat e realizuara nga Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA) gjatë Vitit 2024

**1. Përdorimi i Plotë i Bazës së të Dhënave**

Gjatë vitit 2024, **Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA)** ka përmbushur me sukses objektivin për ndërtimin dhe operacionalizimin e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për trajtimin dhe menaxhimin e aksidenteve. Ky sistem është krijuar për të siguruar një proces efikas dhe të strukturuar për regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit të lidhur me aksidentet.

- **Regjistrimi dhe klasifikimi i aksidenteve:**
  Çdo aksident i trajtuar nga STA, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, është regjistruar dhe klasifikuar në bazë të kategorive të paracaktuara. Kategoritë përfshijnë pasojat, fushën e veprimit dhe masat teknike të marra, duke garantuar një dokumentacion të detajuar dhe të qartë.
- **Ruajtja sistematike e dokumentacionit:**
  Dokumentet zyrtare të lidhura me çdo rast, si raportet teknike, komunikimet zyrtare (me email dhe shkresa), si dhe informacionet plotësuese, janë ruajtur në mënyrë sistematike dhe të organizuar në bazën e të dhënave. Çdo rast është shoqëruar me një **dosje përfundimtare**, duke garantuar një arkivë të standardizuar dhe të aksesueshme për përdorim të mëtejshëm.
- **Përdorimi strategjik i bazës së të dhënave:**
  Kjo bazë e të dhënave ka shërbyer si një instrument thelbësor për përmirësimin e trajtimit të aksidenteve, duke:
  - Mundësuar analizimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit.
  - Garantuar gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e saktë të historikut të aksidenteve.
  - Rritur efikasitetin operativ dhe vendimmarrjen bazuar në të dhëna të sakta dhe të mirëstrukturuara.



**2. Krijimi dhe Përdorimi i Manualit të Trajtimit të Aksidenteve**

Me anë të **Urdhrit Nr. 101, datë 19.12.2024, "Për Miratimin e Manualit të Trajtimit të Aksidenteve," Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA)** ka vënë në përdorim një dokument të standardizuar dhe gjithëpërfshirës për trajtimin profesional të aksidenteve. Manuali përmban **134** faqe, duke përfshirë udhëzime të detajuara dhe kushte teknike specifike për trajtimin e aksidenteve me natyra dhe dinamika të ndryshme. Ky dokument është krijuar për të mbuluar tërësisht fushat e veprimit të drejtorive inspektuese të **ISHTI**, përfshirë drejtoritë inspektuese.

**Përmbajtja dhe Qëllimi i Manualit:** Manuali është konceptuar për të shërbyer si një udhëzues praktik dhe teknik për inspektorët e angazhuar në terren, duke siguruar:

- **Procedura të qarta dhe të standardizuara** për trajtimin e aksidenteve, duke përfshirë hapat e nevojshëm për analizimin dhe raportimin e tyre.
- **Formate dhe modele të standardizuara**, të cilat ndihmojnë në strukturimin e dokumenteve dhe raporteve zyrtare të lidhura me aksidentet.
- **Udhëzime të detajuara për çdo fushë veprimi**, duke përfshirë trajtimin e aksidenteve në pajisje elektrike, pajisje nën presion, sisteme të gazifikimit dhe nënprodukte të gazit.

Manuali është projektuar për të garantuar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe teknike, duke ndihmuar në zbatimin e proceseve të unifikuara dhe në menaxhimin efikas të incidenteve. Përdorimi i manualit përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së sigurisë teknike dhe përmirësimit të proceseve të inspektimit, duke sjellë përfitime të dukshme:

- **Efikasitet më i lartë** në trajtimin e aksidenteve përmes qartësisë dhe strukturimit të procedurave.
- **Reduktimi i gabimeve operacionale** si rrjedhojë e udhëzimeve të standardizuara dhe praktikave më të mira.
- **Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë**, duke mundësuar dokumentimin e saktë dhe të gjurmueshëm të çdo hapi të procesit.

Kjo nismë përforcon rolin e **Sektorit të Trajtimit të Aksidenteve** si një strukturë e fokusuar në sigurinë teknike dhe përputhshmërinë me standardet më të larta profesionale. Implementimi i manualit siguron një bazë solide për përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të trajtimit të aksidenteve.



## Objektivat e Sektorit të Trajtimit të Aksidenteve (STA) për Vitin 2025

Një nër objektivat kryesorë të **Sektorit të Trajtimit të Aksidenteve (STA)** për vitin 2025 është nisja e një bashkëpunimi strategjik dhe të strukturuar me **Drejtorinë e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional**. Ky bashkëpunim ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rreziqet teknike dhe shkaqet kryesore të aksidenteve, bazuar në analizën e detajuar të të dhënave të përftuara nga baza e të dhënave e STA.

### Qëllimet Kryesore të Fushatës

1. **Sensibilizimi i Publikut:**
   - Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi rreziqet që lidhen me pajisjet dhe instalimet teknike.

- Edukimi i qytetarëve dhe subjekteve private mbi praktikat më të mira për parandalimin e aksidenteve, duke theksuar masat që duhet të ndërmerren për sigurinë teknike.
- Përhapja e informacionit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, si media tradicionale, rrjetet sociale dhe seminare të dedikuara.

2. **Parandalimi i Aksidenteve:**
   - Informimi i vazhdueshëm i publikut dhe subjekteve do të kontribuojë në reduktimin e numrit së aksidenteve, duke përhapur njohuri mbi identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve teknike.
   - Ofrimi i udhëzimeve të qarta dhe të thjeshta mbi masat parandaluese, të cilat mund të implementohen nga individë dhe subjekte të ndryshme.

3. **Përmirësimi i Imazhit Institucional:**
   - Promovimi i punës së ISHTI-t si një institucion që jo vetëm monitoron dhe inspekton, por gjithashtu kontribuon aktivisht në edukimin e qytetarëve dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë.
   - Krijimi i një perceptimi publik pozitiv për ISHTI-n si një entitet që angazhohet në mënyrë të përgjegjshme për parandalimin e aksidenteve dhe përmirësimin e sigurisë teknike.

❖ **Hapat e Parashikuar për Implementim**

1. **Zhvillimi i materialeve të komunikimit publik**, duke përfshirë broshura informuese, postime edukative në rrjetet sociale dhe artikuj informativë mbi rreziqet teknike dhe praktikat e sigurta.
2. **Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese**, si seminare, trajnime, dhe prezantime publike me fokus sigurinë teknike.
3. **Bashkëpunimi me mediat lokale dhe kombëtare**, për të siguruar një shpërndarje të gjerë të mesazheve sensibilizuese dhe informuese.






**Përfundim**

Objektivat për vitin 2025 reflektojnë angazhimin e STA për të kaluar nga një rol thjesht monitorues në një qasje proaktive, duke e vendosur parandalimin e aksidenteve dhe edukimin publik në qendër të veprimtarive të saj. Ky bashkëpunim me **Drejtorinë e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional** synon të krijojë një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm, duke rritur sigurinë teknike dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe subjekteve.

## 2. Sektori i Mbikëqyrjes – Misioni dhe Detyrat Funksionale

**Sektori i Mbikëqyrjes** është përgjegjës për garantimin e realizimit efektiv, të paanshëm dhe transparent të proceseve inspektuese dhe të punës. Misioni dhe detyrat funksionale të sektorit janë përshkruar më poshtë:

A. **Misioni Kryesor:** Menaxhimi, sigurimi, bashkërendimi dhe kontrolli i realizimit të proceseve të punës dhe inspektimit, duke u bazuar në përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi.

B. **Detyrat Kryesore**

1. Mbikëqyrja në terren e drejtorive inspektuese: Përzgjedhja rastësore e subjekteve për inspektim, bazuar në planet mujore të inspektimit të dërguara nga drejtoritë inspektuese në DTAM.
2. Vlerësimi i drejtorive inspektuese: Vlerësimi i veprimtarisë së stafit inspektues dhe trajtimi i informacionit të kthyer nga subjekte juridike, ekonomike, private, publike ose individë të tjerë.
3. Mbikëqyrje bazuar në analizat e riskut: Mbikëqyrja e proceseve inspektuese në terren, bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit për parregullsitë e identifikuara përmes monitorimit online sipas programeve të miratuara.
4. Bashkëpunimi institucional: Bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë inspektuese dhe ruajtja e parimit të paanshmërisë dhe konfidencialitetit, për të garantuar realizimin e procesit të punës sipas standardeve më të larta profesionale.
5. Rekomandime për masa administrative: Mbi bazën e informacionit të marrë nga subjektet, sektori i propozon Kryeinspektorit marrjen e masave administrative dhe urgjente, për të siguruar zgjidhje të paanshme dhe objektive, në përputhje me kompetencat profesionale dhe ligjore.
6. Mbikëqyrja e ISHTI-t në terren: Sigurimi i funksionimit të inspektimeve në përputhje me qëllimin e tyre, duke ofruar garanci të arsyeshme për korrektësinë e procesit inspektues.
7. Monitorimi i zbatimit të kodit etik: Sigurimi i zbatimit të kodit etik gjatë procesit të inspektimit, duke promovuar integritet, profesionalizëm dhe korrektësi në çdo aspekt të komunikimit dhe zbatimit të detyrave.
8. Mbikëqyrja në kohë reale (gjatë procesit të inspektimit): Verifikimi i transparencës së procesit të inspektimit përmes monitorimit në kohë reale, duke garantuar një proces të paanshëm dhe të drejtë.
9. Mbikëqyrja pas procesit të inspektimit: Ndërveprimi me subjektin e inspektuar për të verifikuar nëse procesi i inspektimit ka qenë i rregullt dhe në përputhje me ligjin dhe standardet teknike.
10. 

| Nr | Muaji | Mbikeqyrje te planifikuara | Mbikeqyrje te realizuara |
|---|---|---|---|
| 1 | MAJ | 2 | 2 |
| 2 | QERSHOR | 10 | 1 |
| 3 | KORRIK | 10 | 7 |
| 4 | GUSHT | 5 | 4 |
| 5 | SHTATOR | 10 | 10 |
| 6 | TETOR | 12 | 8 |
| 7 | NENTOR | 6 | 5 |
| 8 | DHJETOR | 6 | 3 |
| 9 | SHUMA | 61 | 40 |




Ky raport përmbledh punën dhe veprimtarinë e drejtorive inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), duke u fokusuar te treguesit kryesorë të performancës së Sektorit të Mbikëqyrjes, bazuar në:

- Programe Mujore të hartuara nga çdo drejtori inspektuese.
- Përzgjedhja rastësore e subjekteve për inspektim, në përputhje me programin mujor të mbikëqyrjes të përgatitur nga Sektori i Mbikëqyrjes.
- Materialet analizuese dhe raportet e përgatitura nga drejtoritë inspektuese.

### Rezultatet e Sektorit të Mbikëqyrjes

Në bazë të rezultateve të punës për periudhën e raportuar, aktiviteti i **Sektorit të Mbikëqyrjes** ka qenë **pozitiv**, duke u mbështetur në këta tregues kryesorë:

1. Rezultatet nga Formulari i Mbikëqyrjes: Treguesit e përfshirë në Formularin e Mbikëqyrjes demonstrojnë efikasitetin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara për çdo drejtori inspektuese.
2. Formulari i Përshtypjeve: Përshtypjet dhe reagimet nga subjektet dhe palët e inspektuara reflektojnë një nivel të lartë transparence dhe profesionalizmi gjatë procesit të mbikëqyrjes.
3. Relacionet dhe Raportet Teknike: Dokumentet e përgatitura pas çdo mbikëqyrjeje tregojnë qartësi dhe përmbajtje të detajuar për treguesit e matshëm të performancës dhe masat e ndërmarra.

### Përmirësimet dhe Planet e Sektorit të Mbikëqyrjes

- **Hartimi i Manualit të Udhëzimit për Mbikëqyrje në Terren:** Sektori i Mbikëqyrjes po punon për hartimin e një **Manual Udhëzimi**, që do të shërbejë si një instrument praktik

për punonjësit, duke siguruar qartësi në procedura dhe lehtësim lidhur me sfidat e hasura gjatë mbikëqyrjes në terren. Ky manual synon:

- Standardizimin e proceseve të mbikëqyrjes.
- Rritjen e efikasitetit operacional.
- Parandalimin e pengesave dhe vështirësive gjatë mbikëqyrjeve.

### ➢ Objektivat Kryesore të Drejtorisë së Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM) për Vitin 2025

Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM) ka përcaktuar objektiva të qarta për vitin 2025, duke synuar rritjen e sigurisë teknike, transparencës dhe efikasitetit në trajtimin dhe parandalimin e aksidenteve. Objektivat kryesore janë si vijon:

1. Nisja e një bashkëpunimi strategjik dhe të ngushtë me Drejtorinë e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional me qëllim informimin e publikut mbi rreziqet dhe shkaqet kryesore të aksidenteve, duke u bazuar në analizën e të dhënave të përftuara nga baza e të dhënave e (STA), si dhe edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe subjekteve për rëndësinë e masave parandaluese, me qëllim reduktimin e rrezikut të aksidenteve.
   Rezultatet e pritura:
   - Rritja e ndërgjegjësimit publik: Qytetarët dhe subjektet do të kenë akses në informacion të detajuar mbi praktikat e sigurta teknike dhe rreziqet e mundshme.
   - Parandalimi i aksidenteve: Njohuritë mbi masat parandaluese dhe praktikat më të mira teknike do të ndihmojnë në uljen e ndjeshme të rrezikshmërisë.
2. Përmirësimi i cilësisë së inspektimeve të realizuara nga inspektorët e drejtorive inspektuese
   Strategjia për përmirësim:
   - Kryerja e analizave mbi raportimet e Formularit të Mbikëqyrjes dhe Formularit të Përshtypjeve të hartuara nga Sektori i Mbikëqyrjes.
   - Identifikimi i problematikave në proceset inspektuese dhe implementimi i masave korrigjuese për të përmbushur standardet teknike dhe ligjore.
3. Rritja e efikasitetit: Përmirësimi i proceseve të inspektimit përmes qasjeve më efektive dhe përdorimit të mjeteve të avancuara teknike.
4. Përmbushja e standardeve: Sigurimi i një inspektimi të plotë dhe profesional, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në ligj dhe rregullore.

Këto objektiva theksojnë angazhimin e DTAM për të rritur sigurinë teknike dhe për të kontribuar në mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve. Përmes një qasjeje të integruar dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe përmirësimit të proceseve inspektuese, DTAM synon të vendosë standarde të larta për efikasitetin dhe transparencën në trajtimin dhe parandalimin e aksidenteve.

## IV. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE NËN PRESION (DIPNP)

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion është pjesë përbërëse e strukturës organizative të ISHTI-t, krijuar në zbatim të VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".

- **Misioni** i saj është shprehur në gërmën "c", pika 1, Kreu II, të VKM Nr. 410/2015, ku përcaktohet se: *"ISHTI është struktura përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknollogjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesorë sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion".*
- **Detyrat** e DIPNP janë përcaktuar në Nenin 16 *"Detyrat e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për pajiset/instalimet nën presion"*, të Ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 *"Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion"*, ku citohet se: *është organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë në fushën e projektimit, prodhimit, montimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion dhe ka për detyrë:*
  1. *Zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë, që pajisjet/instalimet nën presion, t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar;*
  2. *Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimtari me pajisje/instalime nën presion, ku vlerëson nëse;*
     a. *ushtrimi i aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion, kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji;*
     b. *miratimi për zhvillimin e aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion është marrë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;*
     c. *është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion;*
     d. *instalimi dhe testimi i pajisjeve/instalimeve nën presion është bërë në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike ne fuqi;*
     e. *pajisja/instalimi nën presion është mirëmbajtur rregullisht gjatë funksionimit të saj dhe nëse ajo është e kontrolluar dhe testuar në përputhje me rregullat teknike në fuqi;*
     f. *personat që përdorin pajisjet/instalimet nën presion dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari;*
  3. *Mban evidenca të historikut të inspektimeve teknike, avarive të ndodhura, regjistrit të pajisjeve/instalimeve nën presion të përdorura nga subjektet përkatëse.*
- **Fushat kryesore të inspektimit:**
  1. Instalimet nën presion, si dhe pajisjet që përdorin operatorët ekonomikë, të cilët janë licensuar për importimin, magazinimin dhe tregtimin me shumicë të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN).
  2. Instalimet në operatorët ekonomik që merren me mbushje, depozitim dhe tregim bombolash me pakicë.

3. Instalimet nën presion në Autogaze që shërbejnë për furnizimin e automjeteve.
4. Instalimet nën presion që përdoren për qëllime rezidenciale, social – kulturore, industriale, etj.

- **Kuadri ligjor mbi të cilin zhvillon aktivitetin inspektues DIPNP**

Për realizimin e detyrave të saj D.I.P.N.P. mbështetet në kuadrin ligjor si më poshtë:

1. Ligji Nr.10433 datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.
2. V.K.M. Nr. 410 datë 13.05.2015 *"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"*.
3. Ligji Nr. 32 datë 24.03.2016 *"Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe instalimeve Nën Presion"*.
4. Ligji Nr.10480 datë 17.11.2011 *"Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve Jo Ushqimore"* i ndryshuar.
5. Ligji Nr.10489 datë 15.12.2011 *"Për Tregtimin dhe Mbikqyerjen e Tregut të Produkteve JoUshqimore"* i ndryshuar.
6. V.K.M. Nr. 212 datë 16.03.2016 *"Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me GLN"*.
7. V.K.M. Nr. 1062 datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik *"Për paisjet dhe bashkësitë nën presion"* dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara.
8. V.K.M. Nr. 1065 datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik *"Enët e thjeshta nën presion"* dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara.
9. Vendimi Nr. 430, datë 26.6.2019 Për miratimin e rregullit teknik *"Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion"*
10. Rregulloren e Brendshme, miratuar me Urdhër Nr. 900, datë 21.12.2010 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
11. Rregulloreve teknike në fuqi si dhe udhëzimeve të brendshme të I.SH.T.I-t.
12. Urdhrat dhe Programet e Inspektimit të Kryeinspektorit për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për prodhimin, vlerësimin e konformitetit, instalimin, përdorimin dhe inspektimin teknik të pajisjeve/instalimeve nën presion.

- **Organizimi i D.I.P.N.P.**

Aktiviteti inspektues i pajisjeve/instalimeve nën presion kryhet sipas organizimit mbi bazën e strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 62 datë 19.04.2024 dhe përbëhet nga 22 inspektorë, të organizuar në 3 Sektor:

1. *Sektori Tiranë – Durrës – Elbasan – Korçë - 1 Përgjegjës dhe 8 inspektorë*
2. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër - 1 Përgjegjës dhe 7 inspektorë*
3. *Sektori Fier – Berat – Vlorë – Gjirokastër- 1 Përgjegjës dhe 7 inspektorë*

## QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i inspektimit të operatorëve ekonomikë, të cilët për nevoja të aktivitetit kanë instaluar duke vënë në përdorim paisje/instalime nën presion është njohja e gjendjes teknike në lidhje me sigurinë e këtyre paisjeve dhe garantimi i sigurisë, nëpërmjet plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga përcaktimet e Nenit 8 *"Përgjegjësitë e Operatorit Ekonomik dhe punëmarrësit për shfrytëzimin e*

*pajisjeve/instalimeve nën presion*", të Ligjit Nr. 32 datë 24.03.2016, nga këta operatorët ekonomikë.
Duke marrë në konsideratë jo vetëm llojin e fluidit që mbajnë apo transportojnë, por edhe qëllimin, ndërtimin, strukturën, aksesorët e sigurisë dhe sidomos regjimin e punës në presion vazhdimisht e të larta, pajisjet/instalimet nën presion janë të një risku të lartë, ç'ka e bën të detyrueshëm inspektimin teknik periodik të përvitshëm nga Organet e Miratuara.

**A. Aktiviteti i kryer**

a. **Aktiviteti i katërmujorit të parë** i DIPNP përfshin inspektimet e operatorëve ekonomikë, sipas planit të miratuar nga Kryeinspektori, nga Inspektorati Qendror, si dhe në pajisjet/instalimet nën presion që ata shfrytëzojnë.

- Për periudhën Janar 2024 në DIPNP ka planifikuar për të kryer 263 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 349 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
    - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 140 subjekte dhe 193 pajisje nën presion*
    - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 84 subjekte dhe 124 pajisje nën presion*
    - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 33 subjekte dhe 45 pajisje nën presion*

- Për periudhën Shkurt 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 302 inspektime në operatorë ekonomik dhe 444 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
    - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 162 subjekte dhe 243 pajisje nën presion*
    - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 95 subjekte dhe 157 pajisje nën presion*
    - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 48 subjekte dhe 69 pajisje nën presion*

- Për periudhën Mars 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 277 inspektime në operatorë ekonomik dhe 349 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
    - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 143 subjekte dhe 171 paisje nën presion*
    - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 106 subjekte dhe 180 paisje nën presion*
    - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 52 subjekte dhe 57 paisje nën presion*

- Për periudhën Prill 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 261 inspektime në operatorë ekonomik dhe 512 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
    - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 197 subjekte dhe 338 paisje nën presion*
    - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 78 subjekte dhe 184 paisje nën presion*
    - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 47 subjekte dhe 101 paisje nën presion*

Përsa më sipër për periudhën Janar-Prill janë planifikuar për t'u inspektuar 1117 Operatorë ekonomikë dhe janë realizuar 1190 inspektime në operatorë ekonomikë, janë planifikuar 1654 inspektime në PNP dhe janë realizuar 1862 inspektime në PNP.

Janë inspektuar jashtë programit 32 subjekte si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 14 subjekte*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 17 subjekte*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 1 subjekte*

Janë riinspektuar 50 subjekte si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 18 subjekte*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 32 subjekte*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 0 subjekte*

Gjatë Periudhës Janar-Prill janë mbajtur në total 901 Akte Inspektimi dhe 1 Akt Konstatimi.

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 370 Akte Inspektimi dhe 1 Akt Konstatime*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 354 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 177 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime*

Janë inspektuar në total për periudhën Janar-Prill:130 Shkolla, 34 Kopshte, 16 Çerdhe dhe 15 aty për aty si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 15 Shkolla, 4 Kopshte, 3 Çerdhe dhe 9 aty për aty.*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 89 Shkolla, 24 Kopshte, 10 Çerdhe dhe 0 aty për aty.*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 26 Shkolla, 6 Kopshte, 3 Çerdhe, 6 Të tjera (Konvikte, Qendra kulturore etj) dhe 0 aty për aty, etj.*

Janë regjistruar në total 138 Pajisje të reja pranë Drejtorisë së D.I.P.N.P-së si më poshtë.

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 103 Pajisje të reja*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 28 Pajisje të reja*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 7 Pajisje të reja*

Si dhe janë hequr e ndaluar 148 Pajisjet si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 23 subjekte*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 76 subjekte*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 49 subjekte*

b. **Aktiviteti i katërmujorit të dytë** i DIPNP përfshin inspektimet e operatorëve ekonomik sipas planit të miratuar nga Kryeinspektori, nga Inspektorati Qendror si dhe në pajisjet/instalimet nën presion që ata shfrytëzojnë.
   - Për periudhën Maj 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 298 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 533 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:

*i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë 163 subjekte dhe 283 pajisje nën presion*
*ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 98 subjekte dhe 189 pajisje nën presion*
*iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 45 subjekte dhe 68 pajisje nën presion*

- Për periudhën Qershor 2024 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 298 inspektime në operatorë ekonomik dhe 476 inspektime në pajisje/instalime nën presion. të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  *i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 151 subjekte dhe 277 pajisje nën presion*
  *ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 115 subjekte dhe 180 pajisje nën presion*
  *iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 46 subjekte dhe 56 pajisje nën presion*

- Për periudhën Korrik 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 246 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 456 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  *i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë 112 subjekte dhe 258 paisje nën presion*
  *ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 98 subjekte dhe 164 paisje nën presion*
  *iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 55 subjekte dhe 76 paisje nën presion*

- Për periudhën Gusht 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 149 inspektime në operatorë ekonomik dhe 262 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  *i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 50 subjekte dhe 92 paisje nën presion*
  *ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 88 subjekte dhe 126 paisje nën presion*
  *iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 44 subjekte dhe 75 paisje nën presion*

Përsa më sipër për periudhën Maj-Gusht 2024 janë planifikuar për t'u inspektuar 991 operatorë ekonomik dhe janë realizuar 1065 inspektime në operatorë ekonomik janë planifikuar 1727 inspektime në PNP dhe janë realizuar 1844 inspektime në PNP.

Janë inspektuar Jashtë Programit 37 subjekte si më poshtë:

*i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 5 subjekte*
*ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 27 subjekte*
*iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 5 subjekte*

Janë riinspektuar 9 subjekte si më poshtë:

*i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 1 subjekt*
*ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 7 subjekte*
*iii. Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 1 subjekt*

Gjatë Periudhës Maj-Gusht janë mbajtur në total 844 Akte Inspektimi dhe 1 Akt Konstatimi.

*i. Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 281 Akte Inspektimi dhe 1 Akt Konstatime*
*ii. Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 373 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime*

iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 190 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime.*

Janë inspektuar në total për periudhën Maj-Gusht: 7 Shkolla, 7 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 4 aty për aty si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 3 Shkolla, 1 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 4 aty për aty.*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 1 Shkollë, 6 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 0 aty për aty.*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 3 Shkolla, 0 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 2 të tjera (Konvikte, Qendra Kulturore etj) dhe 0 aty për aty,etj.*

Janë regjistruar në total 134 Pajisje të reja pranë Drejtorisë së D.I.P.N.P-së si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 56 Pajisje të reja*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 59 Pajisje të reja*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 19 Pajisje të reja*

Si dhe janë hequr, ndaluar dhe ç'regjistruar 220 Pajisjet si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 32 Pajisje*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 131 Pajisje*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 57 Pajisje*

Po për këtë periudhë janë zbatuar Urdhrat:

1. Urdhri Nr.2734 Prot, datë 06.04.2023 dhe Autorizimi Nr.2734/1 Prot, datë 06.04.2023 *"Për Subjektet që Ushtrojnë Aktivitet në Fushën e Gazrave Teknik, të ndara sipas Kategorive Industrial dhe Mjeksor në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë".*
2. Urdhri Nr. 1793 Prot, datë 05.02.2024 dhe Autorizimi Nr. 1793/1 Prot, datë 05.02.2024 *"Për Identifikimin të Strukturave Akomoduese Turistike dhe Njohje me Kërkesat Ligjore në Përmirësim të Sigurisë Teknike"*, ku është kërkuar:
   a. Të informohen subjektet mbi detyrimet dhe kërkesat ligjore për zbatim. Të njihen konkretisht me bazën ligjore në fuqi dhe çdo informacion ose këshillim të nevojshëm.
   b. Identifikimi i Subjektit të shërbejë dhe si objekt inspektimi në vijim.
   c. Në rast të konstatimit të shkeljeve në flagrancë, nga inspektori të proçedohet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", "Neni 27", "pika 2", gërma a" citojmë: *pika 2: "Inspektimi mund të fillojë pa autorizimin, sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm kur: a) "konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkese ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit".*

c. Aktiviteti i katërmujorit të tretë i DIPNP përfshin inspektimet e operatorëve ekonomikë sipas planit të miratuar nga Kryeinspektori, nga Inspektorati Qendror si dhe në pajisjet/instalimet nën presion që ata shfrytëzojnë.

- Për periudhën Shtator 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 232 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 363 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë 144 subjekte dhe 181 paisje nën presion*
  - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 75 subjekte dhe 148 paisje nën presion*
  - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 30 subjekte dhe 60 paisje nën presion*

- Për periudhën Tetor 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 230 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 397 inspektime në paisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 128 subjekte dhe 158 paisje nën presion*
  - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 65 subjekte dhe 161 paisje nën presion*
  - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 42 subjekte dhe 89 paisje nën presion*

- Për periudhën Nëntor 2024 DIPNP ka planifikuar për të kryer 212 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 370 inspektime në paisje/instalime nën presion të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë 137 subjekte dhe 162 paisje nën presion*
  - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 62 subjekte dhe 156 paisje nën presion*
  - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 31 subjekte dhe 67 paisje nën presion*

- Për periudhën Dhjetor 2024 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 219 inspektime në operatorë ekonomik dhe 380 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
  - i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 125 subjekte dhe 193 paisje nën presion*
  - ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 59 subjekte dhe 156 paisje nën presion*
  - iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 54 subjekte dhe 88 paisje nën presion*

Përsa më sipër për periudhën Shtator-Dhjetor janë planifikuar për t'u inspektuar 893 operatorë ekonomik dhe janë realizuar 952 inspektime në operatorë ekonomik janë planifikuar 1510 inspektime në PNP dhe janë realizuar 1619 inspektime ne PNP.

Janë inspektuar Jashtë Programit 40 subjekte si më poshtë:

- i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 12 subjekte*
- ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 13 subjekte*
- iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 15 subjekte*

Është Riinspektuar 1 Subjekt si më poshtë:

- i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 1 subjekt*
- ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 0 subjekte*

iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër:* *0 subjekte*

Gjatë Periudhës Shtator-Dhjetor janë mbajtur në total 883 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime.

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 458 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 259 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 166 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime.*

Janë inspektuar në total për periudhën Shtator-Dhjetor: 59 Shkolla, 11 Kopshte, 6 Çerdhe, 10 Konvikte, Qendra Kulturore etj, dhe 24 aty për aty si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 17 Shkolla, 6 Kopshte, 4 Çerdhe dhe 11 aty për aty.*
ii. *Sektori Fier– Berat – Vlorë – Gjirokastër: 10 Shkolla, 1 Kopësht, 0 Çerdhe dhe 0 aty për aty.*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 32 Shkolla, 4 Kopshte, 2 Çerdhe, 10 Të tjera (Konvikte, Qendra Kulturore etj) dhe 0 aty për aty.*

Janë regjistruar në total 99 Pajisje të reja pranë Drejtorisë së D.I.P.N.P-së si më poshtë.

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 61 Pajisje të reja*
ii. *Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 32 Pajisje të reja*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 6 Pajisje të reja*

Si dhe janë hequr, ndaluar dhe ç'regjistruar 184 Pajisjet si më poshtë:

i. *Sektori Tiranë– Durrës – Elbasan – Korçë: 31 Pajisje*
ii. *- Sektori Fier– Berat –Vlorë – Gjirokastër: 124 Pajisje*
iii. *Sektori Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër: 29 Pajisje*

Përsa më sipër për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë Inspektuar 3207 Subjekte, 5325 Pajisje nën presion, 60 Riinspektime, 2628 Akt Inspektime, 2 Akt Konstatime, 196 Shkolla, 52 Kopshte, 22 Çerdhe, 43 Aty për aty, dhe 10 Konvikte, Qendra Kulturore etj, 371 PNP të reja, 110 Inspektime jashtë planit, 542 Pajisje të hequra, të ndaluara dhe Çregjistruara. Për periudhën Janar-Dhjetor janë administruar dhe zgjidhur 9 Ankesa. Janë trajtuar 4 raste Aksidentesh/Incidentesh për periudhën janar-prill 2024, pasi në këtë periudhë është krijuar Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes pranë ISHTI-t, e cila ka vijuar me trajtimin e tyre.
Në zbatim të Autorizimeve mujore sipas ndarjes në zona e sektorë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë mbajtur 2 Vendime Përfundimtare të Inspektimit me shkelje për operatorët ekonomik që shfrytëzojnë paisje/instalime nën presion të cilët nuk kanë plotësuar detyrimet ligjore mbi dokumentacionin teknik e ligjor sipas përcaktimeve të ligjit *Nr.32/2016 dhe Ligjit 10 433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" datë 16.06.2011* duke i penalizuar ata:

- **PRILL 2024**

Ndaj Subjektit "Forschner Albania shpk,", me NIPT K86616206E, me adresë: Rruga Kryesore Tiranë Ndroq, Vaqarr 100 metra nga kthesa Arbanës janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore,

të Ligjit Nr. 32/2016 datë 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion", Nenit 7 pika 1, ku para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës. Subjekti nuk ka bërë kërkesë për regjistrim pajisje nën presion. Kjo klasifikohet si kundërvajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrative kryesor.
Për këto arsye ndaj Subjektit "Forschner Albania shpk", në zbatim të *Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 15.04.2024 Nr. ISHTI-DQ-2024-002096-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

- **KORRIK 2024**

Ndaj subjektit "Aleksandër Lazëri PF", me NIPT L11918503B, me adresë: Drac, Objekt me nr.pasurie 147/10/ND1, Zk.1522, Durrës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr.10433 dt 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni.54 "Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve/instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Të drejtën e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjes e ka çdo inspektor i inspektoratit kompetent". Kjo klasifikohet si kundërvajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.
Për këto arsye ndaj Subjektit "Aleksandër Lazëri PF", në zbatim të *Ligjit Nr. 10 433datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 24.07.2024 Nr. ISHTI-DQ-2024-004820-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Në mënyrë më të detajuar i gjithë aktiviteti i DIPNP sipas Sektorëve për periudhën Janar-Dhjetor 2024, paraqitet në Tabelën si më poshtë:

| *Sektoret* | *Inspektime ne subjekte* | | *Inspektime te p.n.p.* | | *Ri-Inspektime sipas Planit* | *Akte te mbajtur* | | *Subjekte te Reja* | | | | | *P.n.p. te reja* | *Inspektime Jashte Planit* | *Ri-Inspektime Jashte planit* | *Pajisje te ndaluara ose Cregjistruara* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Plan* | *Realizim* | *Plan* | *Realizim* | | *Akt Inspektimi* | *Akt Konstatimi* | *Shkolla* | *Kopshte* | *Çerdhe* | *Të Tjera (Konvikte, Qendra Kulturore etj)* | *Aty per aty* | | | | |
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* | *7* | *8* | *9* | *10* | *11* | *12* | *13* | *14* | *15* | *16* | *17* |
| *SEKTORI TIRANE* | 1612 | 1657 | 2368 | 2549 | 58 | 1233 | 9 | 35 | 11 | 7 | 0 | 24 | 220 | 32 | 20 | 86 |
| *SEKTORI FIER* - | 890 | 1023 | 1720 | 1925 | 0 | 828 | 0 | 100 | 31 | 10 | 0 | 0 | 119 | 57 | 39 | 1330 |
| *SEKTORI LEZHE* - | 514 | 527 | 803 | 851 | 0 | 507 | 0 | 61 | 10 | 5 | 18 | 0 | 32 | 21 | 1 | 135 |
| *Janar-Dhjetor* | *3016* | *3207* | *4891* | *5325* | *58* | *2568* | *9* | *196* | *52* | *22* | *18* | *24* | *371* | *110* | *60* | *1551* |

## V. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAISJEVE, INSTALIMEVE ELEKTRIKE DHE MAKINERITË NGRITËSE (DIPIEMN)

Gjatë këtij viti D.I.P.I.E.M.N ka punuar për të realizuar detyrat sipas programeve të punës për periudhën Janar – Dhjetor, referuar detyrimeve të ngarkuara sipas ligjit. Në vijim struktura e kësaj analize i referohet bazës ligjore D.I.P.I.E.M.N si më poshtë;

- **Ligji Nr.8734 dt.01.02.2001** *"Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike"* (*i ndryshuar*).
- **Ligji Nr.10433 dt.16.06.2011** *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*.
- **Ligji nr. 10480, dt.17.11.2011** *"Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve Joushqimore"*, (*i ndryshuar*).
- **Ligji nr.10489 dt 15.12.2011** *"Për Tregëtimin dhe Mbikqyrjen e Produkteve jo Ushqimore"* (*i ndryshuar*).
- **VKM Nr.245, dt. 30.03.2016** *"Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impjantet dhe instalimet elektrike" dhe përcaktimin e listes se standarteve te harmonizuara,*
- **VKM Nr.482, dt.17.06.2020** *"Për miratimin e rregullës teknike për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 KV"*
- **VKM Nr.483, dt.17.06.2020** *"Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 KV"*.
- *Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet Pajisjet dhe Instalimet Elektrike.*
- **VKM Nr.1066, dt.23.12.2015** *Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyese"* dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara.
- **VKM Nr.1060, dt. 23.12.2015** Për *miratimin e rregullit teknik "Për makineritë"dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara "*.

### I. Trajtimi i rasteve të aksidenteve.

Me miratimin e strukturës dhe organikës së re të I.SH.T.I me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 62 datë 19.04.2024, trajtimi i aksidenteve është realizuar nga Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikqyrjes për të cilat D.I.P.I.E.M.N nuk ka qenë më e autorizuar.

### II. Inspektimet ( Kontrollet teknike )

Pjesë e rëndësishme e punës së D.I.P.I.E.M.N është kryerja e inspektimeve (kontrolleve teknike si përkufizim i Ligjit Nr. 8734 dt.01.02.2001 *"Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike"* nga inspektorë apo grupe inspektorësh, sipas rëndësisë së pjesës së rrjetit që kontrollohet, nivelit të tensionit, rrezikshmërisë, afateve të inspektimeve etj. Kjo detyrë zë volumin kryesor të punës së inspektorëve dhe parashikohet në programet mujore të punës.

Inspektimet realizohen vetëm online. Gjatë inspektimeve plotësohet dokumentacioni, listëverifikimi i inspektimit, proces-verbali i inspektimit, vendimi përfundimtar i inspektimit. Qëllim kryesor është rritja e nivelit të sigurisë elektrike të instalimeve dhe pajisjeve duke lënë detyra me afate konkrete për mënjanimin në kohë të rreziqeve deri në ndalim të plotë të pajisjes instalimit kur rreziku është akut dhe ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

Vlerësimi i kryerjes me seriozitet të këtij procesi është vendimtar, përsa i takon shkallës së sigurisë, mënjanimit në kohë të rreziqeve, që në fund të fundit jep dhe rezultanten e të gjithë punës në tërësi të çdo inspektori dhe të gjithë D.I.P.I.E.M.N.-së. E rëndësishme gjatë vitit 2024 është të theksojmë:

a. ***Inspektimi i strukturave akomoduese turistike*** në vijim të programit të punës Nr.1182 Prot. I.SH.T.I datë 24.01.2024, si plan masash për kontrollin në përmirësim të kërkesave sigurisë teknike në mbështetje të mëtejshme të strategjisë kombëtare të turizmit, në mbështetje të së cilit doli Urdhri Nr. 1793 Prot., datë 05.02.2024 "*Për identifikim të strukturave akomoduese turistike dhe njohje me kërkesat ligjore në përmirësim të sigurisë teknike*", proces i përbashkët nga dy drejtoritë e I.SH.T.I, D.I.P.I.E.M.N dhe D.I.P.N.P.
b. ***Inspektimi i institucioneve arsimore publike dhe jo publike.***
c. ***Rritja e transparencës së inspektimit duke e shoqëruar atë me foto në kohë reale.***

U planifikuan dhe kontrolluan 650 struktura akomoduese turistike nga Ksamili në Velipojë në periudhën Shkurt - Qershor 2024 për të cilat japim treguesit në tabelën si më poshtë;

<u>*Në vijim tabela përmbledhëse e treguesve të realizimit të programit të punës në zonat bregdetare.*</u>

| Treguesit e realizimit | D.I.P.I.E.M.N | D.I.P.N.P |
|---|---|---|
| Subjekte gjithsej të inspektuara. | 650 | |
| Subjekte të përbashkëta inspektimi të dy drejtorive, elektrike dhe enët nën presion. | 500 | |
| Subjekte që nuk disponojnë enë nën presion. | 150 | - |
| Subjekte të inspektuar për herë të parë. | 519 | 355 |
| Subjekte të rinspektuar. | 131 | 145 |
| Subjekte të inspektuar dhe që kanë realizuar detyrat. | 415 | 320 |
| Subjekte në proces inspektimi. | 235 | 180 |

- *Qëllimi i programit*

1. Identifikimi i strukturave akomoduese turistike dhe njohja e tyre me kërkesat ligjore në përmirësim të sigurisë teknike.
2. Garantimi i një turizmi të sigurt përsa i takon sigurisë teknike (elektrike dhe pajisjeve nën presion).
3. Parandalimi i çdo mangësie konstatuar që përpara fillimit të sezonit turistik.
4. Ulja e kostos dhe kohës së inspektimit nëpërmjet kryerjes së inspektimeve të përbashkëta, rritje të efiçensës dhe produktivitetit të inspektimit.
5. Krijimi i një databaze referuese për inspektimet e programuara në vijim.

- *Konstatime nga realizimi i programit*

1. Përgjithësisht subjektet nuk janë të informuar dhe në dijeni të kuadrit ligjor si detyrim për zbatim nga ana e tyre.
2. Mangësi të theksuara përsa i takon dokumentacionit teknik që duhet të disponohet nga ana e subjektit përfshirë në dosjen teknike.
3. Çertifikimi dhe inspektimi i rregullt periodik nga organet e miratuara (OMVK) për të garantuar nivelin e duhur të sigurisë teknike.
4. Instalime elektrike, qarqet fundore të të cilave nuk janë të mbrojtura me dispozitiv diferencial.

- *Risi të këtij programi*

1. Identifikimi dhe ecja paralel me inspektimet e autorizuar solli rritje të efektivitetit të inspektimit nëpërmjet sensibilizimit dhe ulje të kostove të inspektimit.
2. Mundësia e identifikimit dhe këshillimit të subjektit që përpara fillimit të sezonit turistik për eliminimin e problematikave të konstatuara.
3. Kryerja e këtij procesi në kushtet kur subjektet e kanë të pezulluar N.I.P.T për arsye të karakterit sezonal të aktivitetit, lehtëson inspektimin dhe nuk krijon konfuzion tek subjekti në periudhen kur ushtron aktivitetin.
4. Rrit efektivitetin e inspektimit duke evidentuar problematikat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ul rrezikun potencial.

- *Arritje në zbatim të programit*

1. U identifikuan 500 subjekte të përbashkëta inspektimi që kanë në përdorim enë nën presion dhe janë konsumatore të energjisë elektrike për të cilat në vijim inspektimi do të jetë i përbashkët nga të dyja drejtoritë D.I.P.I.E.M.N dhe D.I.P.N.P.
2. 150 subjekte janë konsumatore të energjisë elektrike dhe nuk disponojnë pajisje nën presion dhe do të jenë objekt inspektimi vetëm nga D.I.P.I.E.M.N.
3. U identifikua një numër i konsiderueshëm subjektesh të cilat inspektohen për herë të parë nga I.SH.T.I.
4. Krijoi impakt dhe ndërgjegjësim tek të gjithë subjektet e kontakuar për zbatimin e detyrimeve ligjore.

- *Inspektimi i institucioneve arsimore publike në Bashkinë Korçë, Maliq, Elbasan.*

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore me qëllim të mirëmbajtjes dhe garantimit të sigurisë teknike në institucionet arsimore në varësi së tyre, u organizua takim në Bashkinë Korçë, Maliq dhe Elbasan.

Objektivi fillimisht ishte identifikimi dhe evidentimi i të gjitha problematikave që ekzistojnë në këto objekte në bashkëpunim me I.SH.T.I duke filluar nga data15.07.2024. U kërkua të na vihej në dispozicion lista e institucioneve arsimore të varësisë dhe u hartua një program i përbashkët pune midis dy institucioneve me përfaqësues të bashkisë të cilët shoqëruan inspektorët gjatë procesit të inspektimit në varësi të volumit të programit.

1. ***Në Bashkinë Korçë:*** U kontrolluan, 14 kopshte dhe çerdhe, 12 shkolla të mesme dhe 9 vjeçare, Gjithsej 26 ( rreth 40 % e numurit të përgjithshëm). Është në proces dhe akoma nuk ka filluar çertifikimi për efekt të parashikimit të shpenzimeve në projekt buxhetin e vitit 2025. Duke vlerësuar dhe marrë në konsideratë arsyet objektive të cilat janë parashtruar në lidhje me hartimin e projekt – buxhetit të vitit 2025. duke filluar nga muaji Janar 2025 do të kërkohet realizimi i detyrave të lëna deri sjelljen në konformitet të instalimit elektrik në institucionet arsimore të kësaj Bashkie.
2. ***Në Bashkinë Maliq***: U kontrolluan, 5 kopshte dhe çerdhe, 7 shkolla të mesme dhe 9 vjeçare, Gjithsej 12 ( rreth 30 % e numrit të përgjithshëm). Shkolla e Mesme e Bashkuar "Dhimitraq Gjata" dhe kopshti "Rreze Drite" janë çertifikuar dhe vlerësuar me çertifikatën përkatëse lëshuar nga OMVK për impiantin elektrik të përshtatshëm për të operuar. Tetë shkolla dhe kopshte të inspektuara, janë vlerësuar me raport inspektimi lëshuar nga OMVK për impiantin elektrik pasi rezultojnë me probleme përsa i takon sigurisë elektrike. I është kërkuar Bashkisë Maliq të merren masa menjëherë për sjelljen në konformitet të instalimit elektrik dhe të raportohet për realizimin e tyre.
3. ***Në Bashkinë Elbasan***: U kontrolluan 4 kopshte dhe çerdhe, 7 shkolla të arsimit 9 vjeçar, për të cilat janë lënë detyra me afate për realizimin e tyre dhe ky proces në vijim do të jetë në objektiv të mëtejshëm të I.SH.T.I nga Janari 2025.

Një informacion përmbledhës dhe krahasues për inspektimet e kryera gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 jepet si më poshtë:

Për vitin ***2024 janë realizuar 2239 inspektime (160 jashtë programit).***

Për vitin ***2023 janë realizuar 2197 inspektime.***

Kemi një rritje të numrit të inspektimeve ***me 42 ose 2 % më shumë.***

Problematika kryesore të konstatuara nga inspektimet janë: mangësi të theksuara përsa i takon dokumentacionit teknik që duhet të disponohet nga ana e subjektit përfshirë, projekti elektrik, i cili në disa raste përfshihet si pjesë e objektit ku ushtron aktivitetin subjekti, por nuk disponohet si dokument më vete në një kohë kur çdo instalim elektrik duhet të ketë projektin elektrik përkatës dhe çdo montim ose rikonstruksion në instalimet elektrike bëhet me projekt. Deklarata e konformitetit (instaluesit), e cila jep përgjegjësinë e instalimit elektrik. Protokolli i tokëzimit sipas rastit ose karakterit të instalimit (në rastet kur subjekti është në ambiente të përbashkëta i ndarë etj).

Kontrollet periodike dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik nga ana e subjektit, minimalisht kontrolli i dispozitivit diferencial nëpërmjet butonit "Test" nga ana e përdoruesit një herë në tre muaj (detyrim i rregullit teknik VKM Nr. 245 datë 30.03.2016). Rregjistrimi i pajisjeve, instalimit pranë I.SH.T.I-it si detyrim i subjektit. Moskryerja nga ana e subjektit e inspektimit të rregullt periodik nga organet e miratuara (OMVK) për të garantuar nivelin e sigurisë teknike elektrike. Konstatohet se ka instalime elektrike, qarqet fundore të të cilave nuk janë të mbrojtura me dispozitiv diferencial. Mungon sinjalistika dhe emërtimet me destinacionet e linjave elektrike në panelet elektrike.

E rëndësishme dhe me vlerë është të theksojmë se çertifikimi dhe inspektimi i rregullt periodik nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit (OMVK) nxjerr në pah gjithë problematikën që ekziston, riparimi i së cilave çon në garantimin dhe nivelin e duhur të sigurisë teknike elektrike. Kjo bën që instalimi elektrik të jetë në përputhshmëri me kërkesat e sigurisë gjatë gjithë periudhës së tij të përdorimit.

Duhet pranuar se, niveli i marrjes së vendimit për gjobë nga inspektorët, ngelet për t'u trajtuar në kushtet e një numri jashtëzakonisht të madh subjektesh që janë objekt inspektimi. Nëse do t'i referohemi Ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" do të ishte dënim kryesor "*Paralajmërimi*" i subjekteve të inspektuara, por nëse i referohemi Ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*".(Ligji sektorial për funksionimin e D.I.P.I.E.M.N.) në nenin 14 të tij jepen kompetencat e inspektorit përfshirë edhe gjobitjen e subjektit të inspektuar, në rastin kur shkeljet janë të atij niveli që kapërcen kriterin e proporcionalitetit. Nga ana jonë një kujdes dhe prioritet shumë më i madh i jepet cilësisë së punës inspektuese dhe rritjes së monitorimit lidhur me inspektimet proaktive të bëra.

Një informacion përmbledhës dhe krahasues për masat administrative të vendosura gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2024 jepet në tabelën e mëposhtme.

| Viti | Gjobat e vendosura në rastet e inspektimeve | |
|---|---|---|
| | Gjoba | Vlera Lekë |
| 2023 | **33** | **2.920.000** |
| 2024 | **38** | **3.100.000** |

Gjatë këtij viti janë vendosur 38 masa administrative me gjobë, ***33 për mos realizim detyrash*, *5 për refuzim të inspektimit*** nga subjektet.

## III. Rregjistrimi i pajisjeve, instalimeve elektrike dhe makinerive ngritëse.

Një proces i rëndësishëm është rregjistrimi i paisjeve, instalimeve elektrike dhe makinerive ngritëse me qëllim nënshtrimin kontrollit të detyrueshëm periodik. Gjatë vitit 2024 kemi patur *1492 aplikime rregjistrimi online nga 753 që kanë qenë në vitin 2023 (739 më shumë)*. Krijimi dhe mbajtja e këtij rregjistri. të përditësuar është me rëndësi pasi lidhet me detyrimet që lindin ndaj operatorëve ekonomikë dhe personave përgjegjës, për të garantuar nivelin e sigurisë teknike gjatë

gjithë fazave që përpara vënies në shfrytëzim/ përdorim dhe gjatë shfrytëzimit/ përdorimit. Identifikimi, krijimi dhe përditësimi periodik i të dhënave (dokumentacionit teknik) i garanton strukturës përgjegjëse në çdo kohë informacionin e nevojshëm për secilën pajisje/ produkt/ instalim kur nëpërmjet rregjistrit sinjalizohet se një subjekt i caktuar është në tejkalim të afateve apo shkelje të detyrimeve.

Në vetvete procesi i rregjistrimit është një proçedurë komplekse, realizimi i së cilës çon në rritjen e sigurisë publike. Ai tashmë kryhet online nëpërmjet portalit E-albania. Rregjistrimi në thelb përbëhet nga dy elementë të rëndesishem të cilët janë si më poshtë:

1. Personi përgjegjës që ka detyrimin të kryejë rregjistrimin, i cili është i përcaktuar në Ligjin nr.10489 dt 15.12.2011 ( i ndryshuar ) *"Për Tregëtimin dhe Mbikqyrjen e Produkteve jo Ushqimore"* neni "1" pika "24" i cili identifikohet nga ana e I.SH.T.I si subjekt dhe proçedohet me praktikën për rregjistrim (***procesi administrativ***).
2. Specifikimet teknike, dokumentacioni teknik (etj), të cilat shoqërojnë praktikën për rregjistrimin dhe janë objekt i inspektimit periodik ose vlerësimit të konformitetit. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave teknike, kryhet nga personel i kualifikuar, i specializuar, i cili ose është pjesë e subjektit ose në të kundërt duhet të jetë një person i kualifikuar dhe i licensuar, i cili do të specifikojë të gjitha karakteristikat teknike sipas fushave përkatëse. Bashkëngjitur, rregullat teknike kërkojnë si detyrim për rregjistrim dhe një sërë dokumentash teknike për t'u paraqitur sic është projekti, çertifikata e rregjistrimit fillestar etj. (***procesi teknik***).

Krijimi dhe mbajtja e këtij rregjistri, është detyrë e I.SH.T.I-it. Ky rregjistër plotësohet mbi bazën e kërkesës që bëjnë subjektet që kanë detyrimin për të bërë rregjistrimin. Mosrregjistrimi nga ana e subjektit përbën shkelje të dënueshme me masë administrative nga ligji dhe çon në shmangien e detyrimeve ligjore të sigurisë elektrike.

**IV. Kualifikimi dhe trajnimi profesional i inspektorëve.**

Njohja e rregulloreve, kushteve teknike të projektimit dhe atyre të zbatimit, ligjeve e vendimeve që kanë të bëjnë me sigurinë, janë kërkesa minimale të domosdoshme për punën e një inspektori, por nuk janë të mjaftueshme. Inspektori duhet të jetë në lartësinë e një eksperti ligjor dhe teknik të fushës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike. Për këtë është e nevojshme që të njohë të azhornohet me të gjitha teknologjitë e reja në fushën elektrike, pra t'i njohë, t'i kuptojë e t'i interpretojë ato.

Për këtë kërkohet një punë individuale por edhe trajnime të organizuara e të programuara. Qëllimi i parë është unifikimi i interpretimit të fenomeneve dhe i qëndrimeve ndaj rregullave e normave teknike në fuqi dhe mandej, nevoja e përafrimit të tyre me normat dhe rregullat bashkohore europiane. Kjo nëpërmjet tërheqjes së mendimit të kualifikuar nga nivelet më të larta të kualifikuara si nga institutet, shoqatat dhe kapacitetet e tjera shkencore etj. Për mendimin tonë duhet që ky institucion të përfaqësojë kualitetin më të lartë në fushën e sigurisë ku të drejtohen natyrshëm të gjithë specialistët që kanë interes në këtë fushë. Një detyrë e rëndësishme që del në këtë drejtim është puna për kërkimin, gjetjen, njohjen, përkthimin, përafrimin e legjislacionit mbi sigurinë nga rreziku elektrik, me atë të BE-së.

## V. Objektivat në vazhdim.

- Shtrirja e bashkëpunimit me institucionet vendore me qëllim të mirëmbajtjes dhe garantimit të sigurisë teknike në institucionet arsimore të varësisë në të gjitha Bashkitë.
- Ulja e numrit të inspektimeve, duke evidentuar dhe klasifikuar subjektet nëpërmjet historikut të inspektimeve.
- Trajnimi i inspektorëve lidhur me unifikimin e interpretimit të fenomeneve dhe qëndrimeve ndaj rregullave e normave teknike në fuqi dhe mandej, nevoja e përafrimit të tyre me normat dhe rregullat bashkohore europiane.
- Vazhdim i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për rregjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike përfshirë strukturat akomoduese të evidentuara.
- Përmirësimi i formateve të inspektimit dhe harmonizimi me kërkesat e Inspektoratit Qëndror.

## VI. DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE (DINGN)

**BAZA LIGJORE**

- *Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999* "Për përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre", të ndryshuar;
- *Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011* "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë;
- *Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993* "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)".
- *VKM nr. 410, datë 13.05.2015* "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial",
- *VKM nr. 147, datë 21.3.2007* "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel";
- *VKM nr. 429, datë 26.06.2019* "Për cilësinë e lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim teknik civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)";
- *VKM nr.970, datë 02.12.2015* "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017)
- *VKM nr.491, datë 19.7.2017* "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre ".
- *Urdhër i Ministrit nr. 315, datë 24.08.2017* "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj";
- *Urdhër i Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015* "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", i ndryshuar;
- *Urdhër i Kryeministrit Nr. 62, datë 19.4.2024* "Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Inspektoratit Shtetëror teknik dhe Industrial".
- *Urdhër Nr. 184 datë 5.7.2005* "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të Tyre.

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN) është strukturë përbërëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe ka si mision kryesor të punës, kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e saj në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre për:

- Kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridik.
- Kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në Licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë dhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit.

- Kontrollin e respektimit të standardeve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj për t'u siguruar konsumatorëve produkte cilësore sipas standardeve në fuqi.

Referuar Urdhrit të Kryeministrit Nr 62, datë 19.04.2024 *"Për Miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"*, me riorganizimin e strukturës, Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre përbëhet nga 32 punonjës dhe kryen veprimtarinë inspektuese në gjithë territorin e vendit tonë e ndarë në tre sektorë:

1. *Sektori i rajonit qendror Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë (12 punonjës).*
2. *Sektori i rajonit jugor Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër (10 punonjës).*
3. *Sektori i rajonit verior Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër (9 punonjës).*

Në raport paraqitet veprimtaria e kryer për periudhën **Janar - Dhjetor 2024** në zbatim të programit vjetor të miratuar në bazë të metodologjisë së inspektimit periodik dhe vlerësimit të rriskut.

**Raporti përmban:**

- Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre,
- Inspektime për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet/licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impianet dhe pajisjet e përdorura në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat për mbrojen kundra zjarrit.
- Inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse.
- Programet e inspektimeve vjetore dhe mujore të miratuara
- Propozime për përmirësime të kuadrit ligjor
- Problematikat.

## I. Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve të tyre.

Kontrolli cilësor i Naftës dhe nënpodukteve të tyre bëhet në zbatim të Urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), i ndryshuar, "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, proçedurat dhe tarifat përkatëse" nëpërmjet marrjes së mostrave sipas VKM nr.147, datë 21.03.2007, "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel"; VKM nr. 429, datë 26.6.2019, "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)" dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatëse në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve në Laboratorin e Akredituar.

### 1. Inspektime në shoqëritë aksionere të Licencuara (sha)

Janë inspektuar subjektet e tregtimit me shumicë për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarifë për çdo 4- mujor.

Në territorin e vendit tonë për vitin 2024 kanë ushtruar veprimtari të tregtimit me shumicë në fushën hidrokarbure 142 shoqëri të tregtimit me shumicë.

| Numri i subjekteve SH.A sipas kategorive të produkteve dhe sipas sektorëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Sektori | Lloji A | Lloji B kateg. I/A | Lloji A kateg. IV/A | Lloji C | Shuma |
| Sektori i rajonit qendror | 33 | 22 | 50 | 2 | 107 |
| Sektori i rajonit jugor | 6 | 9 | 8 | 0 | 23 |
| Sektori i rajonit verior | 1 | 6 | 5 | 0 | 12 |
| Shuma | 40 | 37 | 63 | 2 | 142 |

**Tabela 1. (a)** Numri i shoqërive të tregtimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të tyre të shpërndara sipas llojit të kategorisë, për vitin 2024.

Për vitin 2024 kanë ndërprerë aktivitetin e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve shoqëritë:
- "Standart Oil" sha pajisur me Licencë Lloji A, Kategoria III/A, me vendndodhje të depozitave në Porto Romano, Durrës.
- "FIA" sha pajisur me Licencë Lloji A, Kategoria IV/A me vendndodhje të magazinës së vajrave lubrifikante Ura e Peshkatarit, Petrelë, Tiranë.
- "Ansoil" sha pajisur me Licencë Lloji A, Kategoria IV/A, me vendndodhje të magazinës së vajrave lubrifikante Libonik, Korçë.
- "Pirro Oil" sha pajisur me Licencë Lloji A, Kategoria IV/A, me vendndodhje të magazinës së vajrave Rruga Korçë – Dishnicë, Korçë.
- "Toyota" sha pajisur me Licencë Lloji A, Kategoria IV/A, me vendndodhje të magazinës së vajrave lubrifikante Autostrada Tiranë – Durrës, km. 18, Tiranë.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është ushtruar kontroll në depozitat e shoqërive të tregtimit me shumicë dhe janë marrë gjithsej 549 mostra për kontrollin e respektimit të standardeve të naftës dhe nënprodukteve të tyre të ndara sipas kategorive të produkteve të tregtimit.

| Produkti / Sektori | Gazoil | Benzine | Bitum | L. Djegëse Mazut | GLN | Naftë Bruto | Vaj Lubrifikani | Jet A-1 | Gjysem produkt | Nr. i mostrave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 85 | 38 | 8 | 5 | 74 | | 170 | 13 | 7 | 400 |
| 2 | 12 | | 7 | 6 | 33 | 18 | 25 | | 3 | 104 |
| 3 | 9 | 6 | | | 18 | | 12 | | | 45 |
| **Shuma** | 106 | 44 | 15 | 11 | 125 | 18 | 207 | 13 | 10 | 549 |

**Tabela 1. (b)** Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë aksionare për vitin 2024.




**Grafiku 1: Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë aksionare për vitin 2024.**

| Viti 2024 | Të ardhura (lekë) |
|---|---|
| Planifikuar | 32 000 000 |
| arkëtuar | 34 248 000 |

Tabela 2. Të ardhura nga tarifat e marrjes së mostrave në subjektet e tregtimit me shumicë për vitin 2024.

## 2. Inspektime në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar(shpk)

Janë inspektuar subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarifë për vitin 2024.

Në tabelën 3 kemi paraqitur mostërmarrjen me tarifë në shpk dhe vlerën e faturuar për vitin 2024 të ndarë sipas sektorëve të DINGN.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë inspektuar subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarifë, sipas sektorëve të DINGN.

| Sektori | Gazoil | Benzinë | GLN | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| **Sektori i rajonit qendror** | **497** | **467** | **380** | **1344** |
| **Sektori i rajonit jugor** | **278** | **263** | **108** | **649** |
| **Sektori i rajonit verior** | **204** | **189** | **104** | **497** |
| **Shuma** | **979** | **919** | **592** | **2490** |

**Tabela 3.** Numri i mostrave të marra me tarifë në stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve për vitin 2024.




**Grafiku 2:** Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë e tregtimit me pakicë për vitin 2024

Për vitin 2024 kanë mbyllur veprimtarinë e tregtimit me pakicë të karburanteve. 31 stacione shitje karburanti, nga të cilat 17 stacione në sektorin qendror, 11 stacione në sektorin jugor dhe 3 stacione në sektorin verior.

| Viti 2024 | Të ardhura (lekë) |
|---|---|
| **Planifikuar** | **85 000 000** |
| **Arkëtuar** | **85 754 000** |

**Tabela 4.** Të ardhura nga tarifat e marrjes së mostrave në subjektet e tregtimit me pakicë për vitin 2024

## 3. Kontrolli cilësor Para-zhdoganimit

Kontrolli cilësor parazhdoganimit kryhet në zbatim *të Urdhrit të Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse"*, i ndryshuar dhe *Udhëzimit nr.3492, datë. 30.04.2015 për "Koordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë"*. Mostrat janë marrë për sasitë e importit me mjet transportues anijet në terminalet e vendit tonë, Porto Romano dhe PIA Vlorë, si dhe me Autoçisterna në pikat doganore tokësore.

Gjatë këtij viti në terminalin e Shëngjinit nuk janë zhdoganuar Naftë dhe nënproduktet e tyre.

Për rafineritë e naftës "R B H Beline" sha dhe "Al Global Oil" sha kontrolli cilësor është kryer në zbatim të Urdhrit të përbashkët ish METE dhe MF, nr. 4288 dhe 4267 datë 30.4.2010.

Në tabelat e mëposhtme jepet numri i mostrave sipas pikave doganore dhe sasitë produkteve të ndara sipas kategorive të mostruara për kontroll cilësor.

| Viti | Dogana | N. Bruto | G.L.N | G.L.N MIX | Benzine | Gazoil | Gazoil + Biodieze | JETA | Benzol, Toluol, Ksilol, White Spirit | Solar | Mazut | Bitum | Marinë VLSFO Fuel Oil | Vaj Lubrif | Te tjera | Nr. Total i mostrave PROGRESIVI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Numri mostrave | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2023 | Tokësore (Importe) | 0 | 1 | 0 | 442 | 729 | 61 | 0 | 0 | 0 | 26 | 122 | 0 | 916 | 5 | 2241 |
| | Detare (Importe) | 0 | 120 | 26 | 19 | 39 | 0 | 11 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 279 |
| | Prodhimi Vendas (Eksporte) | 26 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 21 | 0 | 0 | 19 | 66 |
| | **Totali** | **26** | **121** | **26** | **461** | **768** | **61** | **11** | **0** | **0** | **26** | **143** | **0** | **916** | **25** | **2586** |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2024 | Tokësore (Importe) | 0 | 0 | 0 | 617 | 1241 | 55 | 0 | 1 | 0 | 26 | 268 | 1 | 911 | 9 | 3063 |
| | Detare (Importe) | 0 | 110 | 21 | 17 | 36 | 1 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 214 |
| | Prodhimi Vendas (Eksporte) | 26 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 22 | 0 | 0 | 12 | 69 |
| | Totali | 26 | 110 | 21 | 634 | 1277 | 56 | 15 | 1 | 0 | 27 | 290 | 1 | 911 | 21 | 3346 |

**Tabela 5.** Numri i mostrave të marra me tarifë për kontroll cilësor para-zhdoganim gjatë vitin 2023 dhe 2024




**Grafiku 3:** Numri i mostrave të marra për kontroll cilësor para-zhdoganim për vitin 2023 dhe 2024.

| Nr. | Lloj i produktit | Viti 2023 | | | | Viti 2024 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Sasia e importuar (ton) | Sasia e prodhuar ne vend (Eksport) | Shuma e sasive të zhdoganuara | Nr. i mostrave | Sasia e importuar (ton) | Sasia e prodhuar ne vend | Shuma e sasive të zhdoganuara | Nr. i mostrave |
| 1 | N. Bruto | - | 522787 | 522787 | 26 | - | 475734 | 475734 | 24 |
| 2 | G.L.N | 310125 | | 310125 | 123 | 303366 | - | 303366 | 110 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | - | | | | | | |
| 3 | G.L.N MIX Zonë e Lirë | 25837 | - | 25837 | 26 | 24059 | - | 24059 | 21 |
| 4 | Benzinë Automjeti | 74494 | - | 74494 | 461 | 137845 | - | 137845 | 634 |
| 5 | Gazoil | 987549 | - | 987549 | 768 | 1146977 | - | 1156977 | 1277 |
| 6 | Gazoil - Biodiezel | 166609 | - | 163609 | 61 | 145967 | - | 145967 | 56 |
| 7 | JET-A | 71455 | - | 71455 | 11 | 83949 | - | 83949 | 15 |
| 8 | Benzol, Toluol, Ksilol, Ehite Spirit (Hollues) | 0 | 0 | 0 | 0 | 22.688 | - | 22.688 | 1 |
| 9 | Solar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | - | 0 | 0 |
| 10 | Mazut | 665 | - | 666 | 26 | 9663 | - | 9663 | 27 |
| 11 | Marinë VLSFO Fuel Oil | - | - | - | - | 2077 | - | 2077 | 1 |
| 12 | Bitum | 3125 | 46115 | 49240 | 143 | 33631 | 26920 | 60551 | 290 |
| 13 | Vaj lubrifikant | 12453 | - | 12453 | 916 | 10803 | - | 10803 | 911 |
| 14 | Të tjera | 4436 | 25366 | 29801 | 25 | 8354 | 29216 | 36571 | 21 |
| 15 | Shuma | 1 646 195 | 621 791 | 2 267 986 | 2586 | 1906714 | 531870 | 2347585 | 3346 |

**Tabela 6**. Numri i mostrave dhe sasia e importuar (ton) për kontroll cilësor para-zhdoganim për vitet 2023 dhe 2024

**Për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit 2,267, 986 ton naftë dhe nënprodukte të saj.**
**Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 janë mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit 2,347,585 ton naftë dhe nënprodukte të saj.**




**Grafiku 4:** Sasia e produkteve për kontroll cilësor para-zhdoganim për vitet 2023 dhe 2024.

Gjatë këtij vitit janë tregtuar brenda vendit 145 967 mijë ton (Gazoil + biodiezel), i cili është gazoil i përzier me esterin e metilit të acidit yndyror me koncetrim 0,6 - 3.2 %. Nuk është prodhuar bio-etanol. Për vitin 2024 ka rritje të produkteve të mostruara para zhdoganimit në sasinë 79599 ton.

| **Viti** | **Sasia në ton e mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit** |
|---|---|
| 2023 | 2 267 986 |
| 2024 | 2 347 585 |

**Tabela 7.** Sasia në ton e mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit për vitet 2023 dhe 2024

| **Viti 2024** | **Të ardhura (lekë)** |
|---|---|
| Planifikuar | 47 000 000 |
| arkëtuar | 69 413 000 |

**Tabela 8.** Të ardhura nga tarifat e marrjes së mostrave para zhdoganimit për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 kanë ushtuar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto "Al Global Oil" sha UPN, Fier dhe "RBH Beline" sha në Elbasan, ndërsa rafineria e Përpunimit të naftës Ballsh dhe rafineria e naftës AM-OIL me adresë ish Uzina e Plastmasit, Lushnje nuk kanë ushtruar aktivitet të përpunimit naftës bruto.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 janë parashikuar 162,000,000 të ardhura nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, me pakicë dhe parazhdoganimit.
Për këtë periudhë janë faturuar 189,415,000 lekë nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, me pakicë dhe parazhdoganimit.

4. **Inspektimi i subjekteve të tregtimit me shumicë dhe pakicë për kontroll cilësor (Sondazhe)**
Janë inspektuar subjektet të tregtimit me shumicë dhe stacionet e karburanteve të shitjes me pakicë për kontroll cilësor (sondazh) për produktet e tregtimit në depozitat dhe stacionet e shitjes së karburanteve.

| Sektori / Produkti | 1 | 2 | 3 | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| **Gazoil** | 227 | 164 | 80 | **471** |
| **Benzinë** | 201 | 86 | 60 | **347** |
| **GLN** | 1 | | | **1** |
| **Naftë bruto** | | 1 | | **1** |
| **Mazut** | 2 | 1 | | **3** |
| **Shuma** | **431** | **252** | **140** | **823** |

**Tabela 9.** Numri i mostrave për kontroll cilësor (sondazhe) në subjektet e tregtimit me shumicë (sha) dhe në subjektet e tregtimit me pakicë (shpk), stacione të shitjes së karburanteve për vitin 2024.




**Grafiku 5:** Mostrat për kontroll cilësor (sondazhe) në subjektet sha & shpk. 2024

## 5. Inspektimi i subjekteve që janë pjesë e tregut si Konsumator të Mëdhenj

Janë inspektuar subjektet Konsumatorë të Mëdhenj nga të cilët janë marrë mostra për kontroll cilësor për produktet që përdorin dhe për dokumentacionin e furnizimit. Gjithësej janë analizuar 10 mostra për kontroll cilësor për vitin 2024.

| Produkti | Numri mostrave |
|---|---|
| Gazoil | 4 |
| GLN | 1 |
| Mazut | 4 |
| **Shuma** | **9** |

**Tabela 10.** Numri i mostrave për kontroll cilësor të Konsumatorëve të Mëdhenj, për vitin 2024

## 6. Kontrolli cilësor për palë të treta.

Janë ushtruar kontrolle dhe janë marrë mostra për kontroll cilësor sipas kërkesave nga palët e treta.

| Produkti | Numri i mostrave |
|---|---|
| Gazoil | 1 |
| Benzinë | 1 |
| Mazut | 1 |
| Naftë Bruto | 14 |
| **Shuma** | **17** |

**Tabela 11.** Numri i mostrave për kontroll cilësor për palë të tretë për vitin 2024

**Në total për vitin 2024 janë marrë gjithsej 7237 mostra për kontroll cilësor.**

**Për vitin 2023 janë marrë gjithsej 6454 mostra për kontroll cilësor.**

7. **Kontrolle të ushtruara në Rafineritë e naftës dhe në Impiantet e Përpunimit të nënprodukteve të naftës, sipas VKM nr.19, datë 14.01.2015 dhe VKM nr.755, datë 12.11.2014**

Kontrollet cilësore janë kryer në bashkëpunim me përfaqësuesit e doganave në zbatim të Udhëzimit nr.3492, dt. 30.04.2015 për "Koordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", i ndryshuar;
Gjatë vitit 2024, krahas importit kanë ushtruar veprimtari Rafineria e përpunimit të naftës UPN, Fier dhe Rafineria e përpunimit naftës në Elbasan.
Zbatimi i standardeve cilësore të karburanteve S SH EN 228 : 2012 +A1 :2017 për benzinën, SH EN 590:2022 për gazoilin dhe SSH EN 589 :2009 për gazin e lëngët është në përputhje me teknologjinë e avancuar të motorëve, por edhe me objektivat e BE për emetimin e gazrave nga mjetet lëvizëse.
Metodat e marrjes së mostrave që zbatohen janë në perputhje me standardin S SH EN ISO 3170:2005 dhe S SH EN ISO 3171:2002 ndërsa kryerja e analizave është realizuar në laboratorin e këtij institucioni i cili funksionon sipas S SH ISO/IEC 17025 2017.

**II. Vërtetime Teknike. Raportime nga OMVK**

Në zbatim të *VKM nr. 491 datë. 19.07.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nenprodukteve të tyre"* dhe të *Urdhërit të Ministrit nr.315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj".*
Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 sipas raportimeve rezulton se janë lëshuar gjithsej 1120 Vërtetime Teknike, nga të cilat 142 në subjektet sha dhe 978 në subjektet shpk:

1. OMVK Nr. OMI 011 SWISS APPROVAL ALBANIA shpk ka lëshuar 354 Vërtetime Teknike, nga të cilat 284 në subjektet Shpk dhe 70 në subjektet Sha.
2. OMVK Nr. OMI 013 NOA CONTROL shpk ka lëshuar 466 Vërtetime Teknike, nga të cilat 454 në subjektet Shpk dhe 12 në subjektet Sha.
3. OMVK Nr. OMI 009-R2 ERGI PINK shpk ka lëshuar 103 Vërtetime Teknike, nga të cilat 79 në subjektet Shpk dhe 24 në subjektet Sha.
4. OMVK Nr. OMI 024 ALCERT shpk ka lëshuar 39 Vërtetime Teknike, nga të cilat 27 në subjektet Shpk dhe 12 në subjektet Sha.
5. OMVK NR. (OMI 007) Ecit shpk ka lëshuar gjithsej 5 Vërtetime teknike nga të cilat 3 në subjektet Shpk dhe 2 për subjektet Sha.
6. OMVK NR. (OMI 002) M.F.M shpk ka lëshuar gjithsej 27 Vërtetime teknike nga të cilat 14 në subjektet Shpk dhe 13 për subjektet Sha.

7. OMVK NR. (OMI 014) AI - Inspektim shpk ka lëshuar gjithsej 119 Vërtetime teknike, nga të cilat 111 në subjektet Shpk dhe 8 për subjektet Sha.
8. OMVK NR. (OMI Cert Al Solution) shpk ka lëshuar gjithsej 7 Vërtetime Teknike, nga të cilat 6 për subjektet shpk dhe 1 për subjektet sha.

## III. Inspektimet e kryera për periudhën Janar – Dhjetor 2024

Janë ushtruar inspektimet në subjektet e tregtimit me shumicë (sha) dhe subjektet e tregëtimit me pakicë (shpk), në zbatim të *Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqiperisë"* dhe në zbatim të detyrave të ngarkuara sipas Ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar për:

- Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve të tyre,
- Inspektime për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat mbrojtëse kundra zjarrit,
- Inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse.

Të dhënat e mëposhtme janë marrë në bashkëpunim me Sektorin e Asistencës Teknike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

| Numri i inspektimeve të programuara dhe jashtë programit **Janar-Dhjetor 2024** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muaji | Sekt. Tiranë-Durrës-Elbasan-Korcë | Sekt. Fier-Berat-Vlorë-Gjirokastër | Sekt. Lezhë-Shkodër-Kukës-Dibër | total |
| Janar | 47 | 26 | 21 | **94** |
| Shkurt | 47 | 16 | 15 | **78** |
| Mars | 42 | 31 | 17 | **90** |
| Prill | 45 | 19 | 17 | **81** |
| Maj | 32 | 11 | 17 | **60** |
| Qershor | 46 | 20 | 19 | **85** |
| Korrik | 35 | 24 | 15 | **74** |
| Gusht | 40 | 15 | 11 | **66** |
| Shtator | 51 | 24 | 13 | **88** |
| Tetor | 45 | 19 | 17 | **81** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nëntor | *43* | *20* | *12* | 75 |
| Dhjetor | *17* | *21* | *12* | 50 |
| *Total* | 490 | 246 | 186 | 922 |

**Tabela 12.** Numri total i subjekteve të inspektuara online për periudhën Janar – Dhjetor 2024.




**Grafiku 6:** Numri total i subjekteve të inspektuara online për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe 2024




**Grafiku 7:** Inspektimet online të kryera për vitin 2023 dhe 2024

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur 167 Inspektime jashtë programit.

Për rastet kur, nga kontrollet cilësore janë konstatuar subjekte që tregtojnë produkte me shmangie të treguesve cilësor janë vepruar me sanksione me gjobë, gjithashtu edhe për rastet e subjekteve që kanë patur shkelje të ligjshmërisë dhe mangësi me dokumentacionin tekniko - ligjor është vepruar me sanksione me gjobë.

| Subjektet e tregëtimit | VITI 2023 | | | VITI 2024 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shmangie Cilësie | Shkelje të ligjshmërisë | SHUMA | Shmangie cilësie | Shkelje të ligjshmërisë | SHUMA |
| Sh.a | - | 2 | 2 | 1 | 2 | 3 |
| Sh.p.k | 3 | 7 | 10 | 6 | 5 | 11 |
| Totali | 3 | 9 | 12 | 7 | 7 | 14 |

**Tabela 13.** Sanksione me gjobë të mbajtura për subjektet e tregtimit me shumicë dhe pakicë për vitin 2023 dhe 2024

## IV. Përmirësimi i normave dhe kushteve teknike të instalimeve teknologjike dhe rritja e sigurisë.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 janë kryer inspektime në stacionet e shitjes me pakicë të karburanteve me vendndodhje në qytetet urbane, bregdetare dhe akset rrugore që lidhin këto qytete, për kontrollin e zbatimit të normave e kushteve teknike, masat për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe rritjes së sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nënpresion.

Janë përmirësuar normat, kushtet teknike dhe siguria e punës së pajisjeve në 64 Autogaze, ku janë boshatisur, zmontuar dhe hequr Autogazet mbitoksorë të tregtimit të GLN-së dhe janë vendosur Autogaze nëntoksorë sipas normave e kushteve teknike.

## V. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Në zbatim *të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre"* i ndryshuar; *VKM nr.970, datë 2.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj* (Ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017) si dhe në vijim të kërkesave të Bashkive të vendit tonë për pajisjen e subjekteve me Licenca të tregtimit me pakicë të karburanteve në territoret nën juridiksionin e tyre, është bashkëpunuar dhe janë ngritur edhe grupe të përbashkëta të kontrollit të stacioneve të karburanteve dhe subjektet janë pajisur me Licenca të tregtimit.

Në zbatim të *Udhëzimit nr.3492, dt. 30.04.2015 për "Koordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë"; Urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse"*, i ndryshuar; Inspektorët e Drejtorisë Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, në bashkëpunim

me përfaqësues të Doganave kanë ushtruar kontroll në gjitha pikat doganore për kontroll cilësor parazhdoganimit për subjektet e tregtimit me shumicë të Naftës dhe nënprodukteve të tyre.

Të gjitha kërkesat dhe ankesat e bëra nga subjektet e tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të tyre, nga Institucionet shtetërore dhe ato private si dhe ankesat në platformën e bashkëqeverisjes janë trajtuar dhe përgjigjur brenda afateve ligjore.

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP), ka ushtruar kontroll në subjektet e tregtimit me shumicë dhe ato me pakicë të tregtimit të gazit të lëngët nga nafta.

## VI. Përmirësimi i kuadrit ligjor

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre ka bërë propozime për ndryshime ligjore.

1. Kërkesë për disa ndryshime në Vendimin Nr. 491, datë 19.7.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".
2. Kërkesë për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin Nr. 315, datë 24.08.2017, "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj".
3. Kërkesë për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", i ndryshuar;
4. DINGN në bashkëpunim me Drejtorinë e Laboratorit të Naftës dhe Gazit ka përgatitur dokumentacionin teknik për miratimin e standardeve për vajrat lubrifikante dhe nënproduktet e tjera.

## VII. Problematika

Shfuqizimi i Urdhrit nr. 76, datë 18.03.2015, "Për procedurat dhe tarifat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj" na ka vendosur në vështirësi të madhe si institucion, për mbledhjen e tarifave të kontrollit cilësor në subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve. Në këtë kuptim, ky institucion nuk ka të përcaktuar mekanizmat detyrues ligjorë për vjeljen e tarifave për kontrollin periodik cilësor të naftës dhe nënprodukteve te saj.

Në Drejtorinë e DINGN ka Inspektorë të rinj për të cilët kërkohet ngritje të nivelit profesional. Zbatimi i ligjit organik nr. 8450/1999 të ndryshuar; ligji për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore kërkojnë angazhim nga të gjithë Inspektorët. Për inspektimet online është punuar me Inspektoratin Qendror për trajnimin e Inspektorëve, proçes i cili duhet të vazhdojë gjatë vitit 2025 për ngritjen e nivelit profesional të Inspektorëve sipas kërkesave të ligjit.
Nuk kemi arritur të mundësojmë ambiente pune për të gjithë sektorët e DINGN.

## VIII. Objektivat për vitin 2025

a. Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm, nëpërmjet kontrolleve cilësore rutinë e të planifikuara në të gjithë subjektet e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
b. Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në subjektet Konsumatorë të mëdhenj dhe ato fundorë, nëpërmjet kontrolleve cilësore rutinë e të planifikuara në të gjithë subjektet që përdorin këto produkte.
c. Rritja e sigurisë së njerëzve duke përmirësuar normat dhe kushtet teknike në instalimet teknologjike të tregtimit naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
d. Realizimi i të ardhurave nga shërbimi i kontrollit cilësor në sha dhe të gjithë subjekteve të cilat i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 8450 datë. 24.02.1999, të ndryshuar.
e. Realizimi i kontrolleve për respektimin e kushteve sipas licencave të marra për të gjitha instalimet për depozitimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, me pakicë dhe shumicë në shoqëritë e pajisura me Licencë Tregtimi.
f. Përmirësimi i kuadrit ligjor. Vendimi Nr. 491, datë 19.7.2017 "Për përcaktimin e rregullave të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"; Urdhrit Nr. 315, datë 24.08.2017, "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj; Urdhrin Nr. 6, datë 09.01.2015, "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse".
g. Miratimin e standardeve për vajrat lubrifikante dhe nënproduktet e tjera
h. Realizimi i dixhitalizimit të depozitave të subjekteve të tregtimit me shumicë, stacioneve të shitjes karburanteve me pakicë dhe njesive të tregtimit të lëndëve djegëse.
i. Bashkëpunimi me Pushtetin Vendor sipas ndarjes së re territoriale.
j. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
k. Nëpërmjet trajnimeve e seminareve do të përmirësohet niveli profesional i inspektimeve.
l. Detyrimet financiare për të gjitha subjektet do të realizohen në masën 100 %

## VII. DREJTORIA E SISTEMEVE TË GAZIFIKIMIT DHE IMPIANTEVE KOMBËTARE (DSGIK)

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare është është pjesë përbërëse e strukturës organizative të ISHTI-t, krijuar në zbatim të VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".
**Misioni** i saj është shprehur në V.K.M. nr. 410 datë. 13/05/2015, Kreu II *"Misioni dhe funksionet e ISHTI-së"* në Pikën 1 gërma "ç" thuhet se: *"ISHTI–ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror".*
**Detyrat** e DSGIK -se janë përcaktuar në Nenin 100 *"Mbikëqyrja dhe inspektimi"* dhe Nenin 101 *"Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit"*, të Kreut VIII *"Inspektimi, Mbikëqyrja, Kundërvajtjet Administrative Dhe Sanksionet"*, të Ligjit Nr. 102/2015 *"Për Sektorin e Gazit Natyror"*
Neni 100, i Ligjit nr. 102/2015 përcakton se: *"në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, ministria ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse, nëpërmjet strukturave të saj dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin (DSGIK)".*
Neni 101 përcakton se: *"Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit (DSGIK), kryen inspektimin e objekteve për transportin, depozitimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, si dhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe rregulloren përkatëse, të miratuar nga ministri."*
**Objekti** i këtij inspektimi përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj, akteve nënligjore, rregulloreve, rregullat, standardet, specifikimet teknike dhe normat e cilësisë, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit".
Roli dhe përgjegjësit e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror si dhe të drejtat dhe detyrimet e inspektorit për inspektim janë të shprehura *në Kreun VI dhe VII të VKM Nr. 573 dt. 3.10.2018 "Për miratimin e rregullave dhe të proçedurave në ushtrimin e funksioneve mbikqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë"*

Marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin janë përcaktuar me *Urdhërin e Ministrit përgjegjës për energjinë Nr. 280 datë 1.10.2020.*

### FUSHAT E VEPRIMIT

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare kryen inspektimin e objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet *e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"*, si dhe të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Objekti i inspektimeve teknike është zbatimi i dispozitave të parashikuara *në ligjin nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar*, përsa ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin,

shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalet e gazit natyror të lëngëzuar, përsa ka të bëjë me rregullat teknike përkatëse, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

Mbikëqyrja inspektuese përfshin edhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit natyror që shpërndahet për konsumatorët në zbatim të kërkesave të standarteve të cilësisë.

Në zbatim të dispozitave të ligjit *32/2016 datë.24.3.2016 "Për sigurinë e punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion"* DSGIK inspekton të gjithë operatorët ekonomik që merren me transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin nëntokësor te gazit natyror, pajisjet/ instalimet nën presion të tyre, në lidhje me dokumentacionin teknik e ligjor të shfrytëzimit të këtyre pajisjeve/instalimeve.

**KUADRI LIGJOR MBI TË CILIN ZHVILLON AKTIVITETIN INSPEKTUES DSGIK**

Për realizimin e detyrave të saj DSGIK mbështetet në kuadrin ligjor si më poshtë:

1. **Ligji Nr. 102/2015** "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar,
2. **Ligji nr.10433, datë 16.06.2011** "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"
3. **Ligji 32/2016 datë 24.03.2016** "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe instalimeve Nën Presion"
4. **VKM Nr. 410 datë 13.05.2015** "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"
5. **VKM nr. 573, datë 3.10.2018,** "Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të Ministrisë përgjegjëse për energjinë".
6. **VKM nr. 551, datë 18.06.2015,** "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", të ndryshuar
7. **VKM Nr. 713 datë 25.08.2010** "Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe perdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të Gazit Natyror
8. **VKM nr. 87, datë 14.02.2018,** "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"
9. **VKM Nr.696, datë 16.08.2013** "Për përcaktimin e procedrave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi", për inspektimet online"
10. **Urdhri Ministrit Nr. 170 datë 8.6.2020** "Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror"
11. **Urdhri Ministrit Nr. 184 datë 17.06.2020** "Për përcaktimin e rregullave për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën e tyre për shkeljet në aktivitetet në sektorin e gazit natyror"

12. **Urdhri Ministrit Nr. 279 datë 01.10.2020** "Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e funksionit mbikqyrës të Ministrisë në aktivitetin e operatorëve të gazit natyror për koordinimin e operacioneve në terren"
13. **Urdhri Ministrit Nr. 280 datë 01.10.2020** "Për miratimin e formës dhe praktikave në marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri dhe Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sektorin e gazit natyror"
14. **Urdhri Ministrit Nr. 281 datë 01.10.2020** "Për përcaktimin e rregullave për përmbajtjen e urdhërit të inspektimit të leshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në rolin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sektorin e gazit natyror, për kryerjen e inspektimeve në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar si dhe të objekteve të tjera të gazit "
15. **Paketa e 9 (nëntë) Vendimeve të Këshillit të Ministrave:** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të Gazit Natyror, të instalimeve të gazit natyror të lëngshëm, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte"
16. **VKM nr. 104, datë 04.02.2015,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e dytë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte",
17. **VKM nr. 612, datë 27.10.2017,**"Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e tretë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte",
18. **VKM nr. 663, datë 10.10.2019,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e katërt,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte",
19. **VKM nr. 294, datë 14.04.2020,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e pestë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte",
20. **VKM nr. 857, datë 04.11.2020,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e gjashtë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, të ndërtimit dhe të operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte."
21. **VKM nr. 659, datë 27.08.2020,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e shtatë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte".
22. **VKM nr. 678, datë 02.09.2020,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e tetë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte",

23. **VKM nr. 679, datë 02.09.2020,** "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, *pjesa e nëntë,* për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte".

## ORGANIZIMI I DSGIK

Aktiviteti inspektues i operatorëve ekonomik në lidhje me performancën e veprimtarive të transportit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në sektorin publik dhe shfrytëzues, që përdorin pajisje/instalime nën presion kryhet sipas organizimit mbi bazën e strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 62 datë 19.04.2024.

DSGIK përbëhet nga një staf prej 10 punonjësish e organizuar në tre sektor :

1. *Sektori i Rajonit Qëndror Tiranë-Durrës-Elbasan-Korçë 1 Përg.Sektori - 2 inspektorë*
2. *Sektori i Rajonit Jugor Vlorë-Berat-Gjirokastër 1 Përg.Sektori - 2 inspektorë*
3. *Sektori i Rajonit Verior Shkodër-Lezhë-Kukës-Dibër 1 Përg.Sektori - 2 inspektorë*

## QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i inspektimit të operatorëve ekonomikë ka të bëjë me performancën e veprimtarive të transportit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në sektorin publik dhe shfrytëzues, njohja e gjendjes teknike ne lidhje me sigurinë e pajisjeve/instalimeve dhe garantimi i sigurisë së punës se tyre. Këta operatorë ekonomikë për nevoja të aktivitetit kanë instaluar duke vënë në shfrytëzim pajisje/instalime nën presion.

Duke marrë në konsideratë jo vetëm llojin e fluidit që mbajnë apo transportojnë por edhe qëllimin, ndërtimin, strukturën, aksesorët e sigurisë dhe sidomos regjimin e punës në presione vazhdimisht të larta, paisjet/instalimet nën presion janë të një risku të lartë ç'ka e bën të detyrushëm inspektimin teknik periodik nga Organet e Miratuara.

Të gjitha inspektimet e operatoreve ekonomik në fushën e gazit natyror do të kryhen on-line me tabletë sipas Listës së Verifikimit të miratuar nga Inspektorati Qendror.

## AKTIVITETI I KRYER

Me plotësimin e organikës sipas strukturës, fillimisht është kryer dhe vazhdon të kryhet njohja e stafit me aktet ligjore dhe nën ligjore: ligji, VKM, Urdhra Ministri dhe Rregullat Teknike, të miratuara në vazhdimësi gjatë vitit 2024.

a. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe trajnimet e inspektorëve të emëruar në këtë drejtori, sipas një Programi të veçantë trajnimi mbasi gjatë vitit 2024 në DSGIK ka patur emërime të reja, lëvizje të stafit brenda drejtorisë.
b. Me anë të shkresës nr. 501 prot., datë 03.09.2020 Inspektorati Qendror ka dërguar pranë ISHTI Modulet e Trajnimit fillestar për Inspektorët, bazuar në *Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*. Këto module së bashku me bazën ligjore të nevojshme i'u janë shpërndanë inspektorëve në periudhë prove të emëruar në DSGIK gjatë

vitit 2024. Ne vijim të përgatitjes së inspektorëve, vetë drejtoria ka kryer disa trajnime të stafit për t'u paraprirë inspektimeve gjatë vitit 2024. Në zbatim të kërkesës së Inspektoratit Qëndror dhe bazuar në Modulet e Trajnimit dhe bazën ligjore, drejtoria ka përgatitur 40 pyetje me 4 alternativa mbi të cilat është hartuar testi përfundimtar nga Inspektorati Qendror për këta inspektorë.

c. Në muajin Janar është kryer Vlerësimi i performancës së punës së çdo punonjësi për vitin 2023 bazuar në modelin e përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për vlerësimin e performancës së punonjësve, ndërsa në muajin korrik 2024 është kryer Vlerësimi i performancës së punës së çdo punonjësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.

d. Referuar ligjit *Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror"*, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) pajis me licencë operatorët ekonomikë, të cilët mund të kryejnë aktivitet në fushën e shpërndarjes, transmetimit, tregtimit me shumicë dhe furnizimit me gaz natyror.

   Bazuar në ligjin *Nr. 102/2015, Nenin 100 "Mbikqyrja dhe inspektimi" dhe Nenin 101 "Inspekorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit"*, si dhe të akteve nën ligjore të dala në zbatim të tij, ISHTI është struktura përgjegjëse për inspektimin e operatorëve në fushën e transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, depozitimit, furnizimit, si dhe për ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror.

e. Referuar Nenit 22 te ligjit Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" është krijuar databazë e operatorëve ekonomikë të licensuar nga ERE në fushën e operimit të gazit natyror si më poshtë:
   1. ALBGAZ sh.a.
   2. PHOENIX PETROLEUM GAS sh.a (Për momentin me statusin e pezulluar në QKB)
   3. BALKGAZ sh.p.k
   4. GSA sh.p.k
   5. ALBPETROL sh.a
   6. TAP AG Albania sh.p.k

Aktualisht bazuar në Rregjistrin e fundit të përditësuar të Licencave të gazit natyror të publikuar nga Enti Rregullator i Energjisë janë 6 subjekte të Licencuar në fushën e transmetimit, shpërndarjes, depozitimit, si dhe ndërtimit e operimit të infrastrukturës së gazit natyror.
Katër prej të cilëve janë inspektuar gjatë vitit 2024 dhe rezultojnë se, nuk kryejnë aktivitet në këto fusha.
Subjekti Phoenix International i licencuar nga ERE me licenca në fushën e "Furnizimit me gaz natyror" dhe të "Tregëtimit me shumicë të gazit natyror" rezulton me statusin e pezulluar në QKB dhe nuk kryen asnjë aktivitet në këto fusha.
DSGIK ka realizuar online me tabletë 100% të inspektimeve të parashikuar për vitin 2024. Janë inspektuar të gjithë operatorët ekonomikë të licencuar në sektorin e gazit natyror nga ERE dhe MIE sikurse parashikon dhe ligji 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror". Nuk ka pasur asnjë sasnksion me masa administrative për këto subjekte.

❖ **Inspektimet gjatë katërmujorit të parë Janar - Prill 2024**

1. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 3623 Prot. datë. 07.03.2024 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 3767 Prot. datë. 11.03.2024 u krye inspektimi në operatorin

"BALKGAZ" sh.p.k. i licensuar në fushën e "Tregtimit me shumicë të gazit natyror", sipas licencës TGN 18. Inspektimi u krye në datën 12.03.2024, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 001523.
Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të emailit zyrtar ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

2. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 5463 Prot. datë. 11.04.2024 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 5671 Prot. datë. 15.04.2024 u krye inspektimi në operatorin "GSA" sh.p.k. i licencuar në fushën e "Tregtimit me shumicë të gazit natyror" sipas licencës TGN 20 dhe të "Furnizimit me gaz natyror (shitje me pakicë)", sipas licencës FGN 20. Inspektimi u krye në datën 18.04.2024, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 002395.

   Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të shkresës ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

- **Inspektimet gjatë katërmujorit të dytë Maj – Gusht 2024**

1. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 7142 Prot. datë. 08.05.2024 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 7681 Prot. datë. 20.05.2024 u krye inspektimi në operatorin "Albgaz" sh.a. i licencuar në fushën e "Transmetimi të gazit natyror", sipas licencës TGN 17 dhe të "Shpërndarjes së gazit natyror" sipas licencës SHGN 17.
   Inspektimi u krye në datën 23.05.2024, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 002932.

   Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të shkresës ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

2. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 8683 Prot. datë. 03.06.2024 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 9181 Prot. datë. 15.06.2024 u krye inspektimi në operatorin "Albpetrol" sh.a. i licencuar në fushën e "Furnizimit me gaz natyror", sipas licencës FGN 21. Inspektimi u krye në datën 20.06.2024, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 003668.

   Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të shkresës ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

- **Inspektimet gjatë katërmujorit të tretë Shtator – Dhjetor 2024**

1. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 13295 Prot. datë. 03.10.2024 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit datë. 08.11.2024 u krye inspektimi në "Stacionin e Matjes ACS02, Bilisht, Korçë" në operatorin "TAP AG Albania" sh.a. i licencuar në fushën e "Transmetimi të gazit natyror", sipas licencës TGN 19.
   Inspektimi u krye në datën 14.11.2024 sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 007393.

   Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të shkresës ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

2. Në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit datë. 18.11.2024 u krye inspektimi në "Stacionin e Kompresorëve, ACS03, Seman, Fier" në operatorin "TAP AG Albania" sh.a. i licencuar në fushën e "Transmetim gazi natyror", sipas licencës TGN 19.
Inspektimi u krye në datën 20.11.2024 sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2024 – 007308.

   Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të shkresës ardhur në ISHTI opertatori ekonomik vë në dijeni që nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

Momentalisht operatori kryesor dhe i vetëm që kryen aktivitet në fushën e gazit natyror është "Trans Adriatic Pipeline AG-Albania", i cili e kryen aktivitetin sipas licencës TGN 19, në stacionin e matjes në Bilisht dhe në stacionin e kompresorëve në Seman, Fier. Për këtë operator është bërë rregjistrimi i 77 pajisjeve nën presion, si dhe hapja e librave për pajisjet si me poshtë:

i. Stacioni i matjes në Bilisht, 16 pajisje nën presion dhe 9 aksesorë të ndryshëm sigurie;
ii. Stacioni i kompresorëve në Seman 43 pajisje nën presion dhe 14 aksesorë të ndryshëm sigurie
iii. Tubacionet e gazsjellësit 18 pajisje nën presion

**❖ Krahasimi i inspektimeve vjetore 2023 / 2024**

| INSPEKTIME Janar - Dhjetor 2023 | INSPEKTIME Janar - Dhjetor 2024 |
|---|---|
| 6 inspektime | 6 Inspektime |




## TRAJNIME DHE OBJEKTIVA PËR VITIN 2025

Referuar Urdhrit Nr. 280, datë 01.10.2020 "Për Miratimin e Formës dhe Praktikave në marrëdhëniet ndërmjet Strukturës Përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e Sektorit të Gazit Natyror në Ministri, dhe Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për Sektorin e Gazit Natyror", penit 8 "Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin natyror, të angazhojë në njësinë/drejtorinë përgjegjëse për sektorin e gazit natyror punonjës të kualifikuar, të cilët kanë:

- ekspertizën e duhur teknike në fushën e gazit natyror, si dhe brenda një periudhe 3 (tre) vjeçare të jenë të pajisur me certifikatën profesionale për kategorinë përkatëse në zbatim të kërkesave të VKM nr. 551, datë 18.6.2015 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dh etregtimin e lëndëve hidrokarbure", të ndryshuar.
- ekspertizën e duhur juridike në fushën e sektorit hidrokarbur, si dhe brenda një periudhe 3 (tre) vjeçare janë pajisur me dokumentin/çertifikimin përkatës të ekspertit jurist, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Nenit 9 "Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), bashkëpunon me strukturën/njësinë përgjegjëse për sektorin e gazit në Ministri për ngritjen e kapaciteteve në njësinë/drejtorinë përgjegjëse të ISHTI që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror", si dhe VKM Nr. 573, datë 3.10.2018 "Për Miratimin e Rregullave dhe të Procedurave në Ushtrimin e Funksioneve Mbikëqyrëse në Sektorin e Gazit Natyror të Ministrisë Përgjegjëse për Energjinë", pika 5 "Aktivitetet e mbikëqyrjes dhe të inspektimit në sektorin e gazit natyror mund të kryhen vetëm nga persona që kanë arsimin përkatës, janë të pajisur me certifikatën e lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", dhe disponojnë kartën e identifikimit si punonjës të ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë apo të inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror" dhe pika 6 "Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë përcakton formën dhe përmbajtjen e certifikatës së lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", si dhe miraton kartën e identifikimit për inspektorin që kryen inspektim në sektorin e gazit" duke parë perspektivën e madhe për t'u zhvilluar, rëndësinë strategjike dhe sigurinë në punë të paisjeve/instalimeve nën presion që ka sektori i gazit natyror, si dhe detyrimin ligjor për përmbushjen me pergjegjësi të të gjithë detyrave funksionale, për vitin 2025 është e nevojshme të kryhen trajnime dhe specializime edhe në terren të stafit të kësaj drejtorie.

Me licensimin e operatorëve ekonomikë si persona juridikë, sipas Nenit 22, të ligjit Nr. 102/105 "Për sektorin e gazit Natyror", të cilët kryejnë një veprimtari në sektorin e gazit natyror për: transmetim të gazit natyror, shpërndarje të gazit natyror, furnizim të gazit natyror, tregtim të gazit natyror, operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror, nga DSGIK:

1. Do të rritet bashkëpunimi me strukturën përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri;
2. Do të hartohen programe të veçanta inspektimi për çdo operator ekonomik;
3. Do të punohet me plan inspektimi mujor për çdo inspektor dhe sektor;

4. Do të raportohet çdo muaj nga çdo sektor për situatën dhe realizimin e detyrave;
5. Do të bëhet analizë periodike për realizimin e detyrave të ngarkuara;
6. Do të bëhet vlerësimi i punës të çdo inspektori dhe përgjegjësi sektori çdo tre muaj dhe në fund të vitit;
7. Do të propozohen tek titullari masa administrative për çdo inspektor dhe përgjegjës sektori që ka mangësi dhe prapambetje të pajustifikuar, konform proçedurave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të ISHTI;
8. Do të ndiqen me prioritet ekzekutimi i të gjitha sanksioneve të mundshme të vendosura në çdo operator ekonomik.

## VIII. DREJTORIA E INFORMIMIT PUBLIK DHE KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL (DIPKN)

Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional si pjesë përbërëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, ka si qëllim mbështetjen dhe menaxhimin e procesit të punës që lidhet me koordinimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të mbarëvajtjes së bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me institucionet e tjera dhe palët e treta, informimin e publikut në kohë reale dhe me transparencë të plotë duke zbatuar strategji që synojnë të krijojnë dhe të ruajnë imazhin e institucionit, krijimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me organizata ndërkombëtare dhe institucionet homologe të huaja, kërkimin dhe ndjekjen e projekteve të financuara nga grantet e donatorëve të huaj.

**Objektivat** kryesorë të punës së Drejtorisë së Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional (DIPKN) për vitin 2024, konsistuan në:

1. Informimi i publikut në mënyrë të qartë dhe transparente në lidhje me aktivitetet e ISHTI të cilat synojnë një ndërgjegjësim të subjekteve dhe qytetarëve mbi sigurinë e tyre nga pajisjet nën presion dhe pajisjet elektrike.
2. Trajnime online të punonjësve të drejtorisë në ASPA me qëllim marrjen e njohurive të reja për realizimin e detyrave të tyre përkatëse.
3. Përditësimi periodik i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare të ISHTI.
4. Realizimi brenda afatit kthim-përgjigje nga sistemi me nënshkrim elektronik (SQDNE).
5. Bashkëpunimi me drejtoritë inspektuese të ISHTI dhe mbledhja e informacioneve me qëllim raportimin e tyre në institucionet përkatëse.
6. Realizimi i videove informuese të procesit të punës së drejtorive inspektuese të ISHTI, me qëllimin ndërgjegjësimin dhe infomimin e subjekteve në lidhje me 'pasaportën e sigurisë'.
7. Ndjekja me interes progresi në zbatim të masave administrative për miratimin e strategjisë së sigurisë rrugore për vitin 2030 nga Grupi Ndërinstitucional i Punës.

**Detyrat kryesore të DIPKN**

Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional për vitin 2024 është fokusuar në këto detyra kryesore:

1. Administrimin dhe mirëmbajtjen e-mailit zyrtar (info@ishti.gov.al)
2. Raportimin e masave administrative të institucionit në Kryeministri.
3. Shkëmbimin e dokumenteve nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim elektronik brenda afatit ligjor si dhe raportimi lidhur me mbarvajtjen e dy platformave AMS/SQDNE.
4. Informimi nëpërmjet platformës së Bashkëqeverisjes dhe portalit Pyet shtetin.al.
5. Përditësimin periodik të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.
6. Pasqyrimi Aktiviteteve në rrjetet sociale.
7. Asistencën Teknike dhe Shkëmbim Informacioni (TAIEX ).
8. Lëvizjen e Lirë e Mallrave.
9. Komiteti Teknik i Transportit të Mallrave të Rrezikshme

Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional përbëhet nga dy sektor:

1. *Sektori Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional*
2. *Sektori i Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar*

Secili prej tyre ka të ndara detyrat dhe përgjegjësitë duke bashkëpunuar në varësi të kërkesave të caktuara në funksion të Drejtorisë. Në analizën e realizuar për periudhën 1-vjeçare është specifikuar puna e secilit sektor.

## 1. Sektori i Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional

Sektori i Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional ka si qëllim informimin e publikut, ndërlidhjen e medias me drejtoritë perkatëse, menaxhimin e rrjeteve sociale si edhe realizimin e video promovuese. Gjithashtu ka në fokus koordinimin e marrëdhënieve për median e shkruar dhe atë audio-vizive me drejtoritë përkatëse për dhënien e informacionit në kohë si edhe përditësimin e faqes së internetit dhe reagimeve në rrjetet sociale në lidhje me aktivitetin e ISHTI.

a) Administrimi dhe mirëmbajtja Email-I zyrtar info@ishti.gov.al. Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional administron e-mailin zyrtar info@ishti.gov.al. si pikë kontakti për çdo e-mail që vjen nga qytetarët, Institucione të tjera etj. DIPKN kryen shpërndarjen e tyre në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në ISHTI. Të gjitha dokumentet zyrtare, kërkesat për bashkëpunime, njoftime, kthim përgjigje dhe vërtetime, jane trajtuar duke respektuar afatet ligjore administrative.

**b)** Raportimi i masave administrative të institucionit. Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional raporton në mënyrë periodike në Kryeministri në lidhje me masat administrative të vendosura nga institucioni, si dhe raportim mbi kontrollet që do të ushtrohen në të gjithë vendin dhe numrin e inspektimeve që realizohen sipas qarqeve apo rajoneve dhe tipologjitë e subjekteve që kontrollohen krahas raportimeve periodike mujore dhe gjobave të vendosura.

Për periudhën (janar- dhjetor 2024) janë raportuar 59 masa administrative të vendosura nga ISHTI.

| MASA ADMINISTRATIVE 2024 | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Janar** | **Shkurt** | **Mars** | **Prill** | **Maj** | **Qeshor** | **Korrik** | **Gusht** | **Shtator** | **Tetor** | **Nentor** | **Dhjetor** | **Totali** |
| **DINGN** | 3 | 0 | 5 | 3 | 2 | 2 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 18 |
| **DIPNP** | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| **DIPIEMN** | 4 | 3 | 3 | 4 | 3 | 2 | 2 | 5 | 2 | 3 | 4 | 4 | 39 |
| | | | | | | | | | | | | | 59 |

*Tabela nr.1 Masat administrative ISHTI janar-dhjetor 2024*

c) Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve (AMS) dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nëpërmjet sektorit të Koordinimit në Drejtorinë e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional realizon nënshkrimin e shkresave të ndryshme që dalin nga Institucioni brenda afatit ligjor, dhe vazhdon

angazhimin për mbarëvajtjen e dy platformave në bashkëpunim me AKSH-in për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që mund të hasen gjatë procesit të punës. Ky sektor raporton një herë në javë rastet e aplikimeve me/pa vonesë në MIE. Në sistemin elektronik AMS dhe SQDNE qarkullojnë dhe ruhen dokumente elektronike të tipologjisë "Kthim Përgjigje", me nënshkrim elektronik nga Titullari i Institucionit, konkretisht për shërbimet e mëposhtme online:

- Akt ekspertize për rastet e avarive dhe aksidenteve;
- Akt vlerësim konformiteti për instalimet dhe pajisjet elektrike;
- Miratimi i projektit elektrik;
- Regjistrim i pajisjeve dhe instalimeve elektrike;
- Regjistrimi i pajisjeve/instalimeve nën presion;
- Vërtetim mbi pajisjet nën presion të operatorëve ekonomikë;
- Vërtetim për respektimin e kërkesave të standardit teknik të naftës dhe nënprodukteve të saj.

DIPKN në bashkëpunim me drejtoritë inspektuese të ISHTI kryen procedurën e nënshkrimit elektronik çdo ditë duke respektuar afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve nga Institucioni të cilat variojnë nga 5 deri 15 ditë pune.

d) Portali "Pyet shtetin" është një platform online, e cila ka për qëllim të ndihmojë qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesuar për të patur një akses më të madh dhe për të gjetur më me lehtësi informacionin me karakter publik. Portali synon gjithashtu të lehtësojë procedurat e dërgimit të kërkesave për informim ndaj çdo autoriteti publik përgjegjës si dhe të ankesave në rast refuzimit të informacionit të kërkuar pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përmes shfrytëzimit të këtij portali, çdo qytetar apo dhe çdo grup interesi mund të dërgojë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat apo ankesat në rast refuzimi. Në portalin Pyetshtetin.al për periudhën janar-dhjetor nuk ka patur asnjë kërkesë.

e) Bashkëqeverisja. Platforma e Bashkëqeverisjes është një iniciativë e qeverisë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, e cila shërben për të dëgjuar dhe ndërvepruar në kohë reale për çështje të ndryshme të aktualitetit, pyetje, ankesa etj. Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional është pikë kontakti kyçe për çdo qytetar që kërkon informacion në këtë platformë. Pas vendosjes së kontaktit me Drejtorinë nga Platforma, bashkëpunohet me Drejtoritë Inspektuese dhe vendoset një grup pune i cili merr masat e duhura dhe ndjek nga afër çështjen e caktuar. Në platformën e Bashkëqeverisjes për periudhën janar-dhjetor i jemi përgjigjur 5 (pesë) kërkesë/ankesave të cilat kanë marrë zgjidhje të menjëhershme.

f) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit në praktikë të ligjit "Për të drejtën e informimit" nga ana e autoriteteve publike. Komisioneri nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Ndër të tjera, Komisioneri gjithashtu ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vendosë në lidhje me ankimet kundra autoriteteve publike në rast të refuzimit të kërkesave për informacion. Zyra e Komisonerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron çdo tre muaj, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim LDI), zbatimin e detyrimit për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe

Përgjigjeve nga koordinatorët e të drejtës për informim pranë autoritetit publik.Regjistri përditësohet çdo muaj dhe postohet në faqen zyrtare të ISHTI si dhe në mjediset e pritjes së qytetarëve në mjediset e Institucionit. Për periudhën janar-dhjetor 2024 janë raportuar 161 kërkesa, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ISHTI-it. përmbledhja e kërkesave për informacion, punësim, ankesa/ankime në regjistër vijon si më poshtë:

| Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve janar - dhjetor 2024 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
| 68 | 25 | 15 | 11 | 10 | 5 | 5 | 5 | 9 | 4 | 2 | 2 |

*Tabela nr. 2 Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve janar-dhjetor 2024*

g) Aktiviteti në rrjetet sociale. Është përgatitur informacioni në lidhje me aktivitetet e institucionit të cilat janë me interes për punonjësit dhe publikun, i cili është publikuar rregullisht në rrjetet sociale për periudhën janar – dhjetor 2024 si më poshtë vijon:

| Rrjete Sociale/ Specifikime | Evente publike të Institucionit: ISHTI | Evente publike të Ministres: |
|---|---|---|
| Facebook | 44 | 274 |
| Instagram, X etj | 69 | 205 |

*Tabela nr.3 Publikimi i aktiviteteve të ISHTIT janar-dhjetor 2024*

Është përditësuar informacioni në faqen zyrtare të internetit ISHTI-t www.ishti.gov.al dhe gjithashtu janë mbajtur kontakte me median në lidhje me informacionin zyrtar për aktivitetet e ISHTI-t në kuadër të krijimit të task-forcës së ISHTI mbi ndërgjegjësimin e subjekteve për krijimin e pasaportës së sigurisë, ku përfshihen dokumentet tekniko-ligjore që çdo subjekt duhet të ketë për një mbarëvajtje sa më optimale të punës. Njëherazi janë kryer takime me Drejtoritë Teknike dhe Institucionet Eprore për hartimin e ideve të bashkëpunimit në fushën e Informimit Publik. Përgjatë periudhës janar –dhjetor 2024, janë realizuar video të ndryshme për proceset e punës gjatë inspektimeve specifike të pajisjeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, në qarqet Velipojë, Vlorë, Lushnje. Korçë. Tiranë dhe Durrës me qëllim transparencën dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe bizneseve. Janë realizuar gjithashtu video informuese në Laboratorin Qendror të Naftës dhe Gazit gjatë procesit të kryerjes së analizave laboratorike për kontrollin e cilësisë së produkteve.

## 2. Sektori i Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Ky sektor është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të ISHTI-t me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, institucionet e huaja homologe dhe grupet e interesit. koordinimin e punës me donatorët për projektet/programet dhe ndihmës së huaj për të cilat ISHTI është përfitues, koordinimin e punës me drejtoritë teknike për realizimin në kohë të këtyre detyrave;
ISHTI është duke punuar me komitetin teknik të transportit të mallrave të rrezikshme (TDG TC) duke zhvilluar dy takime në Beograd dhe në vazhdim, për të gjetur ekspert nga vende të ndryshme të rajonit të cilët sigurojnë bashkëpunim me institucionin tonë.
Synojmë të zgjerojmë serinë e takimeve të grupeve të reklamave të transportit të TDG, në baza mujore. Këto veprime zbatohen për shkak të politikës së transportit të mallrave të rrezikshme. Ne përfitojmë nga mundësia për të promovuar institucionin tonë.

- Në bazë të bashkëpunimit tonë në TDG, jemi duke përgatitur draft-in fillestar mbi fushatën e sigurisë, që prek e-inspektimet dhe gjetjet e organeve përforcuese të ligjit, në terren.
- ISHTI ka qënë pjesëmarrës edhe në takimin teknik, për rajonin e Ballkanit perëndimor me BE.
- I çmojmë së tepërmi, përpjekjet efektive për të kryer diskutime në tryezë, të cilat priten nga pjesëmarrësit rajonal, duke përfshirë palën Shqiptare për të përditësuar.
- Kërkim për evidentimin e organizatave ndërkombëtare të rëndësishme më të cilat duhet të krijohet bashkëpunim.
- Kërkim për evidentimin e zyrave homologe të vendeve të rajonit dhe vendet fqinje për bashkëpunim.
- Hartim i drafteve të MoU dhe evidentimin e pikave të bashkëpunimit me zyrat homologe.
- Kërkim dhe hartim i listës së donatorëve për sigurimin e granteve për financimin e projekteve.
- Regjistrim si aplikant në portalin e TAIEX Organ i Komisionit Evropian për suport në lidhje me organizimin e seminareve, përfitimit të asistencës teknike dhe vizitave të punës në inspektoriatet homologe të vendeve të BE.
- Përgatitjen e Roadmap-it për lëvizjen e lirë të mallrave nga anëtarët e GNPIE- së kapitullit 1. "Lëvizja e lire e mallrave". Roadmap-i i lëvizjes së lirë të mallrave është dokumenti më i rëndësishëm për kapitullin 1. Ky dokument pasi të finalizohet, do të ndahet me shërbimet e Komisionit Europian, çka e shton edhe më shumë detyrimin për hartimin e tij në cilësinë e duhur. Veçanërisht në këtë periudhë është përcaktimi i afateve kohore konkrete për harmonizimin dhe masat zbatuese në dokument dhe në planin e veprimit. Kërkesat e akteve europiane mbi Pajisjet nën presion dhe Enët e thjeshta nën presion (respektivisht Directive 2014/68/EU on pressure) equipment(PED) dhe Directive 2014/29 on simple pressure vessels (SPVD).
- Trajnimet mbështetëse nga projekti SANECA/GIZ në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare te Administrates Publike (ASPA) dhe zbatohet nga College of Europe.
- Pjesëmarrja ne Ëebinarin të ASPA "Fundamental of the EU legal & institutional System & overvieë of the legal enlargement process (Part 1).
- Pjesëmarrja në Ëebinarin te ASPA Sistemi i menaxhimit te aplikimeve (AMS) dhe Sistemi i Qarkullimit te Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), në të cilën u diskutua rreth shfaqjes se të dhënave të aplikimeve, delegimi i aplikimeve si dhe trajtimi i tyre etj,

- Trajnimet për ecurinë e shërbimeve on-line, si dhe ndjeka e gjithë procesit duke asistuar nga identifikimi i 7 – shërbimeve online deri në akseset per Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrimin Elektronik dhe AMS.
- Takime me drejtoritë teknike të ISHTI-t për të diskutuar në lidhje me funksionet e secilit sektor dhe evidentimin e nevojave për zhvillimin e tyre dhe vijimësinë e punës së mëparshme.

Në lidhje me projektet lindin këto nevoja:

- Sigurimin e automjeteve për kryerjen e inspektimeve.
- Sigurimin e mjeteve (kiteve) të inspektoreve gjatë kryerjes së inspektimit.
- Përmirësimin e kushteve dhe mjeteve laboratorike në Laboratorin qëndror të ISHTI-t.
- Instalimi i një monitori qëndror në institucion i lidhur në mënyrë dixhitale me proçesin e inspektimit online.
- Trajnimin e stafit të laboratorëve, inspektorëve dhe sektorëve të tjerë të ISHTI-t.
- Dixhitalizimi i arkivës së ISHTI-t.
- Sigurimi i automjeteve që përmbajnë laborator të inkorporuar në mënyrë që të kryhet analiza e produktit në vend gjë që siguron transparencë dhe shpejtësi të rezultateve të inspektimit.

## IX. DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE (DÇJPP)

Në kuadër të detyrave funksionale të përcaktuara në VKM-në nr. 410, datë 13.05.2015, *"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"*, Urdhrin e Kryeministrit nr. 62 , datë 19.04.2024, *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"*, dhe Urdhrin nr. 297, datë 25.11.2024, *"Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"*, po ju paraqesim informacionin e detajuar mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike për periudhën **Janar-Dhjetor 2024**.

Në analizën vjetore për vitin 2024, pasqyrohet puna dhe aktiviteti i kryer nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike (këtu e në vazhdim D.Ç.J.P.P), në lidhje me administrimin dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me garantimin e pajtueshmërisë së politikave të ndjekura nga Institucioni, në fushën ku ushtron veprimtarinë e tij, me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.
D.Ç.J.P.P, në zbatim të detyrave funksionale, ndjek proceset gjyqësore, për të cilat Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (këtu e në vazhdim ISHTI) është në cilësinë e të paditurit ose të palës së tretë, ndjek ekzekutimin e akteve administrative të nxjerra nga ISHTI, ndjek procedurat e prokurimit publik të ISHTI-t, si dhe jep asistencë ligjore dhe juridike në trajtim të rasteve institucionale dhe ndërinstitucionale. Në vijim po analizojmë disa nga treguesit më kryesorë të aktivitetit të D.Ç.J.P.P.
Një ndër prioritetet kryesore ka qenë ndjekja e proceseve gjyqësore, të regjistruara pranë gjykatave Administrative por edhe të rretheve, në muajt Janar- Dhjetor 2024, për të cilat ISHTI, ka qenë në cilësinë e të paditurit, ose të personit të tretë.
Gjendja gjyqësore e çështjeve të ndjekura pranë Gjykatës nga Sektori i Ankimimeve, në D.Ç.J.P:P, pranë ISHTI për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është sa më poshtë vijon:
Gjatë vitit 2024 janë ndjekur gjithsej 63 çështje në total nga të cilat 42 dosje i përkasin periudhës 2015 - 2023, ndërsa 21 çështje kanë filluar gjatë vitit 2024.

- Janë rrëzuar **14 (katërmbëdhjetë) kërkesë padi** të paraqitura pranë Gjykatave të Shkallës Parë dhe Gjykatës së Apelit.
- Janë pushuar **4 (katër) kërkesë padi** paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Parë.
- Janë pranuar **13 (trembëdhjetë) kërkesë padi**, nga të cilat 9 (nëntë) prej tyre janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, 4 (katër) prej të cilave janë të pa ankimueshme, pasi ligji ka parashikuar mosankimim e tyre për shkak të vlerës.

Theksojmë se, kemi konstatuar se në shumicën e rasteve të vendimmarrjeve të gjykatave të Shkallës Parë, ku ISHTI ka humbur proceset gjyqësore, ka ndodhur për shkak të vendimmarrjeve arbitrare dhe shpesh herë haptazi të njëanshme. Shumë prej vendimeve që marrin formë të prerë nga Gjykata e Apelit janë kthyer në favorin tonë.

- Janë aktualisht në proces ndjekje 32 (tridhjetëedy) çështje me objekt: *"Pavlefshmëri Titulli dhe kundërshtim veprimesh përmbarimore"*, *"Konstatimin e pavlefshmerisë së titullit për efekt parashkrimi"*, *"Shfuqizim akti administrativ"*, *"Marrëdhënie pune"* etj.

Ashtu siç cituam edhe më sipër, pjesë e pretendimeve të shqyrtuara dhe qëndrimeve të mbajtura nga palët paditëse dhe pranuar nga gjykata, sikurse edhe një vit më parë edhe gjatë vitit 2024, disa nga shkaqet e vendimeve të dhëna kundër ISHTI –t, ka ardhur si rezultat i parashkrimit të masave administrative të dhëna në vitet e mëparshme, te cilat kanë qenë në pamundësi ekzekutimi nga ana jonë, për shkak se kanë qenë në procese gjyqësore, çka e bën të pamundur ekzekutimin, pavarësisht ndjekjës me prioritet nga ana jonë për vjeljen e tyre.

Edhe pse nga ana e ISHTI-t janë ezauruar të gjitha rrugët administrative dhe janë vënë në ekzekutim pranë zyrave përmbarimore sipas vendimeve të gjykatës për çeljen e urdhrit ekzekutiv, gjykata në lidhje me procesin e themelit përsa i përkret parashkrimit, i referohet dispozitës ligjore që parashikon afatin dy vjeçar të vjeljes së detyrimit të kundravajtjes administrative dhe jo momentit kur ajo kthehet në titull ekzekutiv. Pavarësisht kësaj, në të gjitha rastet e vendimmarrjeve të gjykatës së Shkallës Parë, për masat administrative që kanë qenë në procese gjyqësore, ne si palë kreditore kemi pritur mbylljen e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, ku vendimi të marrë formë të prerë.

Po e njëjta gjykatë, pavarësisht se kanë kaluar dy vite nga vendosja e masës administrative, ka marrë vendim për çeljen e urdhrit ekzekutiv.

Del qartazi se, për të njëjtën dispozitë ligjore që parashikon parashkrimin e vendimit administartiv, gjykata mban dy qëndrime të ndryshme, në kundërshtim me njëra-tjetrën. Pra, po e njëjta gjykatë na dikton që jemi në kundërshtim me ligjin në rastet kur kemi ekzekutuar vendimin përpara procesit gjyqësor, duke argumentuar se në këtë mënyrë i mohojmë vënien në vend të së drejtës së shkelur subjektit të ndëshkuar, duke sjellë kështu edhe pasoja të tjera financiare. Nga ana tjetër, gjykata del me vendim parashkrimi për mosekzekutim brenda afatit dy vjeçar, duke mos marrë parasysh parashikimet ligjore për arkëtimin e shumave dhe detyrimeve, pasi vendimi i gjykatës të ketë marrë formë të prerë. Një ndër kushtet e gjykatës për çeljen e urdhrit ekzekutiv që duhet të paraqitet si provë nga ana jonë si palë kërkuese është konfirmimi se subjekti debitor nuk është në proces gjyqësor, dhe në përmbajtje të të gjitha vendimeve për lëshim urdhri ekzekutiv i referohet këtij fakti.

Gjithsesi nga ana jonë në të gjitha rastet është mbajtur qëndrimi se parashkrimi fillon në rastet kur institucioni nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë administrative për ekzekutimin e tyre. Në të gjitha rastet e tjera, afatet e parashkrimit duhet të ndërpriten deri në përfundim të procesit gjyqësor, në të kundërt do të ishim para faktit që, nuk do të respektonim të drejtën që i njeh ligji subjektit për ngritjen e padisë në gjykatë.

Gjithashtu, është konstatuar edhe gjatë këtij viti sikurse një vit më parë se nga ana e trupës gjykuese janë marrë shpesh herë vendime arbitrare, sidomos në ato raste ku vendimet kanë qenë të pa ankimueshme për shkak të vlerës së objektit të padisë.

Më poshtë, paraqitet grafikisht një krahasim i situatës së proceseve gjyqësore me periudhën Janar-Dhjetor 2024 me vitin paraardhës.




Nga grafiku krahasues me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vihet re një rritje e ndjeshme e proceseve gjyqësore në të gjithë zërat.

Për periudhën në analizë, nga ana jonë është bërë e mundur administrimi i çdo çështjeje që lidhet me mbështetjen dhe sigurimin e asistencës ligjore dhe juridike në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të të gjitha strukturave të ISHTI-t, zbatimit dhe respektimit të ligjit në çdo procedurë administrative që ndjek institucioni.

Një ndër prioritetet kryesore ka qenë ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, të cilat janë regjistruar pranë gjykatave Administrative dhe ato të Juridiksionit të Përgjithshem Tiranë, por edhe ato të rretheve, për të cilat ISHTI, ka qenë në cilësinë e të paditurit, ose të personit të tretë. Po kështu, është siguruar zbatimi i ligjshmërisë në veprimtarinë dhe procedurat e ushtrimit të sanksioneve, masave administrative (gjobat) dhe ndjekjeve penale ndaj subjekteve të inspektuar nga strukturat e ISHTI -t. eshtë ofruar këshillimi ligjor kurdoherë që është kërkuar për çdo punonjës, sektor apo drejtori të institucionit, duke rritur kështu ndjeshmërinë mbi zbatimin dhe njohjen e ligjit si nga ana e subjekteve, po ashtu edhe nga ana e inspektorëve, të cilët në vazhdimësi kanë ndërmarrë fushata informuese në terren.

Theksojmë se, po bëhet një punë e vazhdueshme për identifikimin dhe organizimin e dosjeve me të gjitha të dhënat e nevojshme, të cilat në shumicën dërrmuese mungojnë. Puna vijon me zyrat përmbarimore në arkëtimin e gjobave të dhëna ndër vite, të cilat kanë pasur nje proces shumë të ngadaltë ekzekutimi.

Performanca e Sektorit të Ankimimeve, ka qenë në nivele shumë të mira, reflektuar kjo në një përfaqësim dinjitoz dhe korrekt duke mbrojtur veprimtarinë e Institucionit në çdo rast kur ajo është kundërshtuar juridikisht. Njëkohësisht, duke analizuar peshën e vendimmarrjeve përfundimtare ose jo në favor të ISHTI-t, në raport me paditë e pranuara të formës së prerë, konstatojmë se shumica e vendimmarrjes së ISHTI-t, është konfirmuar nga trupa gjykuese. Kjo gjë mbështetet duke pasur parasysh edhe numrin e Vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, të formës së prerë, të cilat në shumicën e rasteve të vendimeve të ankimuara nga ana jonë, të gjykuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë ndryshuar në favor të ISHTI – t.

Ndër të tjera, janë ndjekur dhe kryer detyra të tjera si më poshtë:

- ✓ Ndjekja në vazhdimësi problematikave dhe asistimi me Drejtoritë dhe sektorët përkatës;
- ✓ Hartimi i planit të punës në lidhje me ndjekjen e proceseve gjyqësore për çdo javë, gjatë gjithë vitit 2024;
- ✓ Hartimi i analizës paraqitur anëtareve të komisionit dhe trajtimi juridik i ankimeve të ardhura në institucion në lidhje me masat administrative të marra nga inspektoret, për drejtoritë DINGN, DIPIEMN, DIPNP;
- ✓ Korrespodenca e mbajtur me drejtoritë teknike dhe jo vetem, për dhënien e informacionit në lidhje me masat administrative të nxjerra për këtë periudhe, të cilat shqyrtohen në komisionin e kundërvajtjeve administrative;
- ✓ Pjesëmarrja në komisionin e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, trajtimi dhe shqyrtimi juridik në lidhje me rastet e sanksionuara me masë administrative;
- ✓ Përpilimi dhe zbardhja e masave administrative të vendim gjobave të mbajtura përgjatë këtij periudhe;
- ✓ Verifikimi dhe ndjekja e vendimeve të gjykatave lidhur me proceset gjyqësore.

Nga Sektori i Asistencës Ligjore, gjatë vitit 2024 është punuar në mënyrë të veçantë me shoqëritë përmbarimore në lidhje me arkëtimin e gjobave nga debitorët. Në mënyrë të përmbledhur gjendja paraqitet si më poshtë vijon:

Gjatë **<u>Janar – Dhjetor 2024,</u>** janë vendosur në total **<u>57 masa administrative</u>**:

- DINGN janë dhënë **17** masa administrative;
- DIPNP janë dhënë **2** masa administrative;
- DIPIEMN janë dhënë **38** masa administrative.

- ➢ **14** masa administrative janë shfuqizuar me vendim të Komisionit të Ankimeve.

  - ❖ Vendim Gjoba në fuqi, **43** masa administrative.

- ➢ **6** masa administrative, Vendim Gjobe janë likujduar vullnetarisht nga vetë subjektet kundërvajtës.
- ➢ **2** masa administrative, Vendim Gjobe janë ekzekutuar përmes zyrave përmbarimore.
- ➢ **8** masa adminisnistrative, Vendim gjobe janë në proces ekzekutimi.
- ➢ **22** masa administrative, sipas plotësimit të afateve ligjore janë dërguar në gjykatë për çeljen e Urdhrit të Ekzekutimit.
- ➢ **3** masa administrative, gjykata ka refuzuar çeljen e Urdhrit Ekzekutiv, janë ankimuar dhe jemi në pritje të vendimit të Gjykatës së Apelit.
- ➢ **2** masa administrative, Vendim Gjobe, jemi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me informacionin për sa i përket aktit në fuqi dhe sigurimit të padisë.

Gjatë periudhës **<u>Janar – Dhjetor 2023,</u>** janë vendosur në total **<u>69 masa administrative</u>**:

- DINGN janë dhënë **17** masa administrative;
- DIPNP janë dhënë **7** masë administrative;
- DIPIEMN janë dhënë **45** masa administrative

- ➢ **15** masa administrative janë shfuqizuar me vendim të Komisionit të Ankimeve.

  - ❖ Vendim Gjoba në fuqi, **54** masa administrative.

- ➢ **13** masa administrative, Vendim Gjobe janë likujduar vullnetarisht nga vetë subjektet kundërvajtës.

Referuar të dhënave të mësipërme vëmë re një ulje të masave administrative të vendosura krahasuar me po të njëjtën periudhe të vitit të mëparshëm, kjo ka ardhur si pasojë e ndërgjegjësimit dhe zbatimit të ligjit nga ana e operatorëve ekonomik pas reformave dhe politikave të ndërmarra nga institucioni ynë, në kuadër të zbatimit te ligjit për të ofruar sigurinë në institucionet publike dhe private.
Gjatë këtij viti pune, nga ana e Sektorit të Asistencës Ligjore janë hasur problematika për sa i përket procedurave për vënien ne ekzekutim të masave administrative, për shkak të rrugëve administrative jashtë institucionit tonë si:

- mos marrja mbrapsht e njoftimeve nga autoritet vendore për shpalljet publike,
- apo posta shqiptare në lidhje me njoftimet e masave administrative.

Pavarësisht kësaj, nga ana jonë janë ezauruar të gjitha hapësirat ligjore edhe në rastet me një problematikë të lartë për të plotësuar të gjithë procedurën në mënyrë që, të gjitha masat administrative të vilen sipas detyrimeve ndaj ISHTI-t. Sipas vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vihet re një ulje e numrit të vendimeve me objekt: "Refuzimin për lëshimin e Urdhrit Ekzekutiv" për vendim gjobat e vendosura gjatë vitit 2024, kjo si shkak i përmirësimit të praktikave administrative dhe ezaurimit më përpikmëri të të gjitha kërkesave ligjore në fuqi, si kusht thelbësor për pranimin e kerkesave të isntitucionit tonë si palë kreditore. Gjithashtu nga ana jonë janë ndryshuar edhe formatet e kërkimeve pranë gjykatës si palë kërkuese në cilësinë e kreditorit duke respektuar në mënyrë eksplicite të gjitha dispozitat ligjore me qëllim uljen e ndjeshme të mos pranimit për çeljen e urdhrit të ekzekutimit.
Gjatë periudhës **<u>Janar - Dhjetor 2024,</u>** janë përgatitur **<u>64 kërkesa drejtuar gjykatës</u>** për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për vendim gjobat e vendosura gjatë vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe janë çelur **31** urdhra ekzekutimi nga ana e gjykatës për vendim gjobat e marra nga ISHTI dhe janë lidhur **31** kontrata shërbimi. Deri tani janë ekzekutuar **11** tituj ekzekutivë nga masat adminitsrative të viteve të kaluara.

Gjatë periudhës **<u>Janar-Dhjetor 2023,</u>** janë përgatitur **<u>46 kërkesa drejtuar gjykatës</u>** për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit gjithashtu janë dhënë **30 urdhra** ekzekutimi nga ana e Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
Në lidhje me Urdhrat e Ekzekutimit për vendim gjobat e periudhës Janar-Dhjetor 2024 jemi në pritje të vendimeve të gjykatës e cila çel Urdhrat e Ekzekutimit për t'u vënë në ekzekutim nga zyrat përmbarimore. Theksojmë se po bëhet një punë e vazhdueshme me zyrat përmbarimore në arkëtimin e gjobave të dhëna ndër vite, duke ndjekur me një prioritet të lartë të gjithë procedurën e ekzekutimit për të arkëtuar detyrimet që rrjedhin nga kundërvjatjet administrative të vendosura nga drejtoritë teknike.

* * *

Nga Sektori Prokurimeve Publike Publike, pjesë e Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, për vitin 2024, janë realizuar detyrat si më poshtë:
Në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, në të cilin thuhet: *"Autoritetiti/enti kontraktor në varësi të nevojave gjatë periudhës Shtator-Dhjetor të çdo viti përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast afati maksimal i hartimit të regjistrit jo më vonë se 10 ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës."* në

bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, u bë hartimi i Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024.

Në zbatim të pikës 4 të po këtij neni, në të cilin thuhet:
*"Autoriteti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem."*, u bë hedhja në sistem e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024, si më poshtë:

| Nr. | Objekti i Prokurimit | Kodi CVP | Lloji i prokurimit | Tipi | Tipi i kontratës | Lloji i regjistrit të prokurimit | Fondi i përllogaritur | Burimi i Financimit | Vlera | Lloji i procedurës së prokurimit | Koha e planifikuar për zhvillimin e procedurës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kalibrimi i aparaturave të Laboratorit Qendror | Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e | Prokurim | Kontrate | Sherbime | Procedure Prokurimi | 13333333.33 | Buxheti i shtetit | 13333333.33 | Open Local | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vete Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde te tjera | 0.00 | | |
| 2 | Blerje materiale pastrimi | Pecela, Pastrues duarsh, Leter higjienike, shami, | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 716666.67 | Buxheti i shtetit | 716666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vete Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde te tjera | 0.00 | | |
| 3 | Blerje CRM per laboratorin e ISHTI-t | Reagente kimike, Reagjente per laborator | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 500000.00 | Buxheti i shtetit | 500000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vete Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde te tjera | 0.00 | | |
| 4 | Riparim, sherbim dhe mirëmbajtje për automjetet e | Sherbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash, | Prokurim | Kontrate | Sherbime | Procedure Prokurimi | 750000.00 | Buxheti i shtetit | 750000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vete Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde te tjera | 0.00 | | |
| 5 | Auditimi i dokumentacionit per akreditim te Laboratorit Qendror | Shërbime të auditimit | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 6 | Mirëmbajtje e objektit ndertimor të ISHTI-t | Lyerje, Lyerje ndertesash, Riparim dhe | Prokurim | Kontrate | Punë | Procedure Prokurimi | 833333.33 | Buxheti i shtetit | 833333.33 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 7 | Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për pajisjet | Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjisë | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Procedure Prokurimi | 416666.67 | Buxheti i shtetit | 416666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 8 | Blerje materiale kancelarie | Bllok shënimesh, Bllok me letra shënimesh me | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 816666.67 | Buxheti i shtetit | 816666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 9 | Blerje materiale shtypshkrimi | Materiale të shtypura me porosi, Materiale të ndryshme të shtypura | Prokurim | Kontrate | Mallra | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 10 | Blerje bojera printeri, fotokopje, tonera | Toner per printer lazer /makina fax , Toner për | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 825000.00 | Buxheti i shtetit | 825000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vete Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |

Gjatë vitit 2024, si rezultat i nevojave të institucionit, për të cilat ka qenë i pamundur planifikimi i tyre më herët, ka lindur nevoja e ndryshimit të Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik për vitin 2024. Ndryshimet e kryera në këtë regjistër plotësonin kriteret e parashikuara në pikën 7, neni 3, VKM-ja Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet: *"Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit." Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem" App-ja nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen dhe*

*këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa.".* si dhe në pikën 7 të Udhëzimit Nr.4, datë 18.06.2021, ku gjithashtu citohet: *"Autoriteti ose enti kontraktor, ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në rast kur ndryshimet vijnë për arsye që nuk kanë qënë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit. Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP do të bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës, e dërgimit të tij për publikim në sistem. Në çdo rast, APP nuk do të bëjë publikimin e këtyre ndryshimeve nëse konstatohet se këto ndryshime nuk janë bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik. Në këtë rast, ajo kthen dhe këshillon autoritetin ose entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa...".*

Në të gjitha rastet regjistrat kanë qenë në përputhje me këto përcaktime dhe janë publikuar nga APP në sistem, duke marrë formën si më poshtë:

| Nr. | Objekti i Prokurimit | Kodet CVP | Lloji i prokurimit | Tipi | Tipi i kontratës | Lloji i regjistrit të prokurimit | Fondi i përllogaritur | Burimi i Financimit | Vlera | Lloji i procedurës së | Koha e planifikuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kalibrimi i aparaturave te Laboratorit | Shërbime për riparimin dhe | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Procedure Prokurimi | 13333333.33 | Buxheti i shtetit | 13333333.33 | Open Local | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 2 | Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për | Shërbime mirëmbajtje dhe | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera. | 0.00 | | |
| 3 | Mirëmbajtje e objektit ndërtimor të ISHTI-t | Lyerje, Lyerje ndërtesash, | Prokurim | Kontrate | Punë | Procedure Prokurimi | 833333.33 | Buxheti i shtetit | 833333.33 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 4 | Blerje materiale kancelarie | Bllok shënimesh, Bllok me letra | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 816666.67 | Buxheti i shtetit | 816666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 5 | Blerje bojera printeri, fotokopje, tonera | Toner per printer lazer /makina | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 825000.00 | Buxheti i shtetit | 825000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 6 | Blerje CRM për laboratorin e ISHTI-t | Reagentë kimikë, Reagentë për | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 500000.00 | Buxheti i shtetit | 500000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 7 | Auditimi i dokumentacionit per akreditim te | Shërbime të auditimit | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 8 | Blerje materiale pastrimi | Peceta, Pastrues duarsh, Letër | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 716666.67 | Buxheti i shtetit | 716666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 9 | Blerje shirita të personalizuar për sekretim | Shirit ngjitës | Prokurim | Kontrate | Mallra | Procedure Prokurimi | 500000.00 | Buxheti i shtetit | 500000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 10 | Blerje materiale shtypshkrimi | Materiale të shtypura me porosi, | Prokurim | Kontrate | Mallra | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 11 | Blerje F.V tabele identifikuese e | Produkte informacioni dhe | Prokurim | Kontrate | Mallra | Blerje nen vleren 100 000 Leke | 100000.00 | Buxheti i shtetit | 100000.00 | | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 12 | Riparim, shërbim dhe mirëmbajtje për | Shërbime riparimi dhe | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Procedure Prokurimi | 750000.00 | Buxheti i shtetit | 750000.00 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |
| 13 | Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për | Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve | Prokurim | Kontrate | Shërbime | Procedure Prokurimi | 416666.67 | Buxheti i shtetit | 416666.67 | Small Value | Dhjetor |
| | | | | | | | | Vetë Financim | 0.00 | | |
| | | | | | | | | Fonde të tjera | 0.00 | | |

Për vitin 2024 janë realizuar procedurat si më poshtë:

| Nr. | Objekti i Prokurimit | Kodet CPV | Fondi Limit | Lloji i Procedures | Vlera e kontratës |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Auditimi i dokumentacionit per akreditim te Laboratorit Qendror | Shërbime të auditimit | 100000.00 | | 79000.00 |
| 2 | Blerje bojera printeri, fotokopje, tonera | Toner per printer lazer /makina fax , Toner për makinat fotokopjuese | 825000.00 | Small Value | 412500.00 |
| 3 | Blerje F.V tabele identifikuese e institucionit | Produkte informacioni dhe promocioni | 100000.00 | | 90000.00 |
| 4 | Blerje materiale kancelarie | Bllok shënimesh, Bllok me letra shënimesh me ngjitëse, Makineri [illegible] | 816666.67 | Small Value | 487000.00 |
| 5 | Blerje materiale pastrimi | Peceta, Pastrues duarsh, Letër higjienike, shami, peshqir dore dhe piceta, | 716666.67 | Small Value | 457700.00 |
| 6 | Blerje materiale shtypshkrimi | Materiale të shtypura me porosi, Materiale të ndryshme të shtypura | 100000.00 | | 94200.00 |
| 7 | Blerje shirita të personalizuar për sekretim mostrash | Shirit ngjitës | 500000.00 | Small Value | 380800.00 |
| 8 | Kalibrimi i aparaturave të Laboratorit Qendror | Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e aparateve të | 13333333.33 | Open Local | 6691900.00<br>6300000.00 |
| 9 | Mirëmbajtje e objektit ndërtimor të ISHTI-t | Lyerje, Lyerje ndërtesash, Riparim dhe renovim, Renovime | 833333.33 | Small Value | 802000.00 |
| 10 | Riparim, shërbim dhe mirëmbajtje për automjetet e ISHTI-t | Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash, Shërbime riparimi makinash | 750000.00 | Small Value | 739820.00 |
| 11 | Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për kondicionerët | Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi, Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje | 100000.00 | | 91800.00 |
| 12 | Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për pajisjet elektronike | Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit, Riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit | 416666.67 | Small Value | 141000.00 |

Referuar Regjistrit të Realizimeve për vitin 2024 janë realizuar procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:
Blerje të vogla nën vlerën 100 000 lekë, për vitin 2024 janë realizuar 4 (katër) procedura, përkatësisht me objekt:

- *"Auditimi i dokumentacionit për akreditim të Laboratorit Qendror";*
- *"Blerje F.V tabelë identifikuese e institucionit";*
- *"Blerje materiale shtypshkrimi";*
- *"Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për kondicionerët".*

Prokurime me vlerë të vogël janë realizuar 7 (shtatë) me objekte si më poshtë:

- *"Blerje bojera printeri, fotokopje, tonera";*
- *"Blerje materiale kancelarie";*
- *"Blerje materiale pastrimi";*
- *"Blerje shirita të personalizuar për sekretim mostrash karburanti.";*
- *"Mirëmbajtje e objektit ndërtimor të ISHTI";*
- *"Riparim, shërbim dhe mirëmbajtje për automjetet e ISHTI-t";*
- *"Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për pajisjet elektronike.";*

Po ashtu, është realizuar 1 (një) procedurë e llojit tender, si më poshtë:

- Procedurë e hapur me objekt: *"Kalibrimi i aparaturave të Laboratorit Qendror"* e zhvilluar në dy lote;

Të gjitha procedurat kryhen bazuar në nevojat dhe kërkesat e Drejtorive të ndryshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Për vitin 2024 janë realizuar 2 (dy) lidhje minikontratash për prokurimet e përqëndruara të zhvilluara nga ish- Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, sot Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me objekt:

- *"Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"*
- *"Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Benzinë pa plumb"*

Arritja e realizimit të minikontratave të dyta të marrëveshjes kuadër 2-vjeçare për vitet 2023-2024 bëri të mundur plotësimin e nevojave të institicionit për karburant, pas disa muajve në mungesë të tij.

Për prokurimet e përqëndruara të vitit 2024, janë ndjekur hapat përkatës përsa i përket përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për tu dërguar pranë Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara sh.a. me qëllim zhvillimin e prokurimeve të përqëndruara me objekt:

*"Blerje aparatura laboratorike për Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve"*, për Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial. Të dhënat e nevojshme janë dërguar pranë OBP sh.a

me anë të shkresës nr.9747/4 prot. 15.08.2024. Kjo procedurë u anullua dhe nuk u përmbush nevoja për rritjen e kapaciteteve teknike të Drejtorisë së Laboratorit Qendror, për vitin 2024.

Në lidhje me procedurën e investimit me objekt: "***Sistem për menaxhimin e proceseve të punës të ISHTI***", me shkresën nr.10604 prot., datë 15.07.2024, nga ana e ISHTI është dërguar pranë AKSHI-t kërkesa zyrtare për fillimin e procedurës së prokurimit për implementimin e sistemit për menaxhimin e proceseve të punës për ISHTI-n. Më datë 08.08.2024, nga ana e sektorit të prokurimeve prane AKSHI-t, i cili është organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit për këtë investim, është ngritur Grupi i Punës për hartimin e termave të referencës, në lidhje me këtë procedurë. Deri në fund të vitit 2024 nuk pati asnjë zhvillim të mëtejshëm për këtë procedurë.

Të gjitha procedurat, të realizuara, të anulluara apo në proces, janë dokumentuar me dokumentat përkatëse (relacion, urdhër prokurimi, ftesa për ofertë, njoftim fituesi, njoftim anullimi, formularët e deklarimit, proces verbale, etj.) duke regjistruar në këtë mënyrë çdo blerje materiali/malli shoqëruar kjo me faturat perkatëse, proces verbalet si dhe fletë-hyrje (në rastin e procedurës së realizuar mallra), konform Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "*Për rregullat e prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të ndryshme të APP-së.

Ndërkohë që nga ana e punonjësve të Sektorit të Prokurimeve Publike janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnimet e zhvilluara nga APP apo dhe OBP sh.a në lidhje me ndryshimet ligjore të vitit 2024 si dhe ndryshimet në strukturimin dhe funksionimin e OBP.sh.a, procese këto të lidhura ngushtësisht me ecurinë e punës në këtë sektor.

Nëse bëjmë një krahasim me periudhën Janar-Dhjetor 2023, nga situata e procedurave të prokurimit paraqitur në grafikët si më poshtë,




vëmë re se, kemi një rënie të procedurave të prokurimit të parashikuara për vitin 2024 si pasojë e pamjaftueshmërisë së fondeve në dispozicion për mbulimin e nevojave që mbulohen nëpërmjet këtyre procedurave. Ndërkohë që nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë, situata e procedurave të prokurimit të realizuara, paraqitur në grafikët si më poshtë:




Sa i përket procedurave të realizuara, për sa mund të shohim nga grafikët, për të njëjtën periudhë për vitin 2023, vërejmë një ulje në numrin e procedurave të prokurimit të zhvilluara dhe të realizuara të llojit blerje e vogël, të prokurime nën 1,000,000 lek, të prokurimeve mbi 1,000,000 lek, e cila vjen si rezultat i procedurave të prokurimit të parashikuara më pak për vitin 2024.









Ndërkohë, nëse bëjmë një krahasim midis periudhave Janar-Prill, Maj-Gusht dhe Shtator – Dhjetor për vitet 2023 dhe 2024 vëmë re se:

Në dy tremujorët e parë të vitit ka një tendencë të dallueshme për kryerjen e më shumë procedurave të prokurimit si rezultat i angazhimit maksimal të Sektorit të Prokurimeve Publike, për përmbushjen e objektivave, për sigurimin e mallrave/shërbimeve të parashikuara dhe mëse të nevojshme për institucionin, nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit në përputhje me ligjin sektorial në fuqi, brenda afateve të parashikuara. Këtu duhet të theksojmë se, buxheti në dispozicion për këto procedura luan një rol shumë të rëndësishëm në ecurinë e punës së sektorit. Këtë e shohim të reflektuar në numrin e ulët të procedurave të prokurimit të realizuara në muajt e fundit të vitit 2024. Sjellim në vëmendje se në 3-mujorin e fundit të vitit 2023 u vendosën në dispozicion të ISHTI fonde për përmbushjen e nevojave emergjente të institucionit, periudhë gjatë së cilës kemi realizim procedurash të parashikuara në fund të vitit, si rezultat i ndryshimit të

Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik të ISHTI, brenda afateve të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, të cilat u përmbushën në masën 100%. Një tregues ky i kënaqshëm për ecurinë dhe efiksitetin e punës në këtë sektor.




Në grafikun e mësipërm paraqitet raporti ndërmjet fondit limit të përcaktuar për kryerjen e prokurimeve publike për vitin 2024 dhe vlerës së kontratës së realizuar për këto prokurime. Vlera e parashikuar është në total 19,091,666.67 (nëntëmbëdhjetëmilion e nëntëdhjetëenjëmijë e gjashtëqindegjashtëdhjetëegjashtë pikë gjashtëdhjetëeshtatë) lek pa TVSH, ndërsa vlera e realizuar është 16,767,720 (gjashtëmbëdhjetëmilion e shtatëndegjashtëdhjetëeshtatëmijë e shtatëqindenjëzetë) lek pa TVSH.

Vlera e diferencës prej 2,323,946.67 (dymilion e treqindenjëzetëetremijë e nëntëqind e dyzetëegjashtë pikë gjashtëdhjetëeshtatë) lek pa TVSH, përbëhet nga zëri i parashikuar për blerje CRM për laboratorin e ISHTI dhe nga diferencat midis fondit të parashikuar dhe vlerës së realizuar për procedurat e tjera, të kryera nga ana e ISHTI-t.

## OBJEKTIVAT E D.Ç.J.P.P PËR VITIN 2025:

Me qëllim kryerjen e detyrave funksionale brenda afateve dhe me cilësi, objektivat që synohen të arrihen për vitin 2025, nga D.Ç.J.P.P, janë si më poshtë:

- Përfaqësim dinjitoz dhe korrekt duke mbrojtur veprimtarinë e Institucionit në çdo rast kur ajo kundërshtohet juridikisht;
- Verifikimi dhe ndjekja e vendimeve të gjykatave lidhur me proceset gjyqësore në kohë dhe me përgjegjshmëri të lartë;
- Ndjekja me prioritet mbi zbatimin e ligjit në procedurat e inspektimit të zhvilluara nga drejtoritë inspekruese:
- Vazhdimi i korrespodencave me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për çeljen e të gjithë urdhrave të ekzekutimit nga ana e saj, për të cilat nuk ka një përgjigje;
- Vazhdimi i korrespodencave me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për çeljen e të gjithë urdhrave të ekzekutimit nga ana e saj, për të cilat nuk ka një përgjigje;
- Lidhja e sa më shumë kontratave të shërbimit me zyrat përmbarimore;
- Ekzekutimi i sa më shumë gjobave nga ana e zyrave përmbarimore;

- Përmirësimin e shumë elementëve të punës që bëhet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e të gjithë punonjësve të Sektorit të Asistencës Ligjore;
- Vazhdimi i asistencës ligjore për drejtoritë e institucionit dhe bashkëpunimi për zgjedhjen e problemanikave të ndryshme;
- Administrimi i çështjeve të mbartura ndër vite;
- Plotësimi i nevojave për materiale/ mallra/ shërbime/ punë të nevojshme për vitin 2025, nëpërmjet kryerjes në kohë dhe me përgjegjshmëri të lartë, të procedurave të prokurimit për blerjen e tyre, dhe jo vetëm;
- Përditësimi me udhëzimet dhe njoftimet e Agjencisë së Prokurimeve Publike përgjatë vitit;
- Kryerja e procedurave të prokurimit të parashikuara për vitin 2025 në zbatim dhe në përputhje me Ligjin nr.162, datë 23.12.2020, "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe udhëzimeve të ndryshme të lidhura me to;

## X. DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS (DBF)

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në vijim (DBF) si pjesë përbërëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial ka përgjegjësi dhe detyra funksionale, të cilat i kryen sipas strukturës së mëposhtme:
*I. Sektori i Buxhetit;*
*II. Sektori i Financës.*

**Misioni**
Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka si mision kryesor të punës së saj, administrimin e vlerave financiare, evidentimin korrekt dhe në kohë reale të të ardhurave, si dhe planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për vazhdimësinë normale të punës së institucionit, duke siguruar zbatimin e kuadrit ligjor sektorial.

**Qëllimi**
Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka si qëllim kryesor të punës së saj, zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, me efektivitet dhe në kohë sipas legjislacionit në fuqi, procedurave të caktuara, planeve dhe afateve të miratuara, për të siguruar përdorimin sa më efiçent, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike dhe ato materiale, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së shtetit.
Në analizën vjetore për vitin 2024, pasqyrohet puna dhe aktiviteti i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës lidhur me veprimtarinë financiare dhe të kontabilitetit të ISHTI-t.
Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, pranë institucionit tonë janë arkëtuar ***195,214,258.60 lekë*** nga të cilat:

- Të ardhura nga analizat dhe shërbimet *184,826,492 lekë*
- Të ardhura nga debitorët deri më 31.12.2023 *6,397,666 lekë*
- Të ardhura nga gjoba të arkëtuara *3,300,000 lekë*
- Të ardhura nga kamatë vonesa *316,100 lekë*
- Të ardhura të tjera *374,000 lekë*

Gjatë periudhës 01.01.2024 – 31.12.2024 nga drejtoritë teknike të ISHTI-it janë evidentuar inspektime dhe faturime si vijon:

Fatura të prera nga DING *189,469,000* lekë nga të cilat arkëtuar *181,842,000* lekë dhe debitorë *7,627,000* lekë të paarkëtuar si më poshtë shënuar ose 4% e faturimit.

Informacioni në analitikë për çdo strukturë përgjegjëse i'u është përcjellë drejtorëve të drejtorive periodikisht (çdo muaj) për të nxjerrë përgjegjësitë dhe për të minimizuar vlerat e paarkëtuara.

## *Te Ardhurat 2024 nga tarifat e sherbimit*

| *ISHTI* | *Detyrim* | *Likujdim* | *Debi* |
|---|---|---|---|
| | 191,616,000 | 184,826,492 | 7,627,531 |
| | | | |
| *Drejtoria e Inspektimit te Naftes dhe Gazit (DING)* | 189,469,000 | 181,842,000 | 7,627,000 |
| *Sektori 1 (Rajoni Qendror, Tirane , Durres,Elbasan,Korce)* | 123,498,000 | 118,797,000 | 4,701,000 |
| Subjekte Shpk | 44,180,000 | 42,790,000 | 1,390,000 |
| Subjekte SHA | 24,743,000 | 24,215,000 | 528,000 |
| Subjekte te Doganes | 54,575,000 | 51,792,000 | 2,783,000 |
| *Sektori 2 (Rajoni Jugor Fier, Vlore,Berat,Gjirokaster)* | 46,282,000 | 43,786,000 | 2,496,000 |
| Subjekte Shpk | 24,765,000 | 23,550,000 | 1,215,000 |
| Subjekte SHA | 6,625,000 | 6,065,000 | 560,000 |
| Subjekte te Doganes | 14,892,000 | 14,171,000 | 721,000 |
| *Sektori 3 (Rajoni Verior Shkoder, Lezhe ,Kukes, Diber)* | 19,689,000 | 19,259,000 | 430,000 |
| Subjekte Shpk | 16,759,000 | 16,379,000 | 380,000 |
| Subjekte SHA | 2,930,000 | 2,880,000 | 50,000 |
| *Drejtoria e Inspektimit te Paisjeve Elektrike (DIPIE)* | 20,000 | 20,000 | - |
| | | | |
| *Sektori 1 (Rajoni Qendror, Tirane , Durres,Elbasan,Korce)* | 20,000 | 20,000 | - |
| *Drejtoria e Laboratorit Qendror* | 1,997,000 | 1,996,469 | 531 |
| | | | |
| *Sektori 1 Laboratori Naftes, Gazit dhe nenprodukteve Qender* | 1,310,000 | 1,310,000 | - |
| *Sektori 2 Laboratori Tekstileve* | 687,000 | 686,469 | 531 |
| *Karte teknologjike* | 50,000 | 50,000 | - |
| *Me shmangie nga standarti* | 80,000 | 80,000 | - |

| ISHTI - 1006157 | | | Te ardhura nga Analizat | Te ardhura nga sherbimet | Te ardhura nga gjobat | Te ardhura nga kamatvonesat | Te ardhura nga debitore sherbime | Te ardhura nga debitore gjoba | Tarife Sherbimi | Progresive Janar - Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Muaji | Viti | 7111005 | 7110199 | 7115499 | 7115500 | 7115600 | 7115600 | 7110101 | |
| 1 | Janar | 2023 | 3,631,000 | 10,000 | 50,000 | 3,700 | 4,820,000 | 1,564,000 | - | 10,078,700 |
| | | 2024 | 6,282,003 | 20,000 | - | - | 813,000 | - | - | 7,115,003 |
| 2 | Shkurt | 2023 | 11,256,000 | - | - | - | 2,019,000 | 14,000 | - | 13,289,000 |
| | | 2024 | 13,423,469 | - | 150,000 | 5,000 | 4,000 | 158,000 | - | 13,740,469 |
| 3 | Mars | 2023 | 15,446,000 | 50,000 | 150,000 | - | - | 64,000 | - | 15,710,000 |
| | | 2024 | 14,292,000 | - | 100,000 | 900 | - | 54,000 | - | 14,446,900 |
| 4 | Prill | 2023 | 12,963,010 | - | 300,000 | - | 200,000 | 14,000 | - | 13,477,010 |
| | | 2024 | 15,571,000 | - | 100,000 | - | - | 4,000 | - | 15,675,000 |
| 5 | Maj | 2023 | 19,078,304 | 20,000 | - | 121,400 | - | 2,311,678 | - | 21,531,382 |
| | | 2024 | 27,676,005 | - | 700,000 | 7,200 | - | 184,000 | - | 28,567,205 |
| 6 | Qershor | 2023 | 19,551,000 | - | 30,000 | 2,240 | - | 24,000 | - | 19,607,240 |
| | | 2024 | 13,655,000 | - | - | - | - | - | - | 13,655,000 |
| 7 | Korrik | 2023 | 21,492,600 | 10,000 | - | 34,600 | - | 204,000 | - | 21,741,200 |
| | | 2024 | 17,196,000 | 50,000 | - | 5,000 | - | 254,000 | - | 17,505,000 |
| 8 | Gusht | 2023 | 15,653,000 | - | 100,000 | 3,000 | - | 4,000 | - | 15,760,000 |
| | | 2024 | 12,163,000 | 30,000 | - | - | - | - | - | 12,193,000 |
| 9 | Shtator | 2023 | 15,496,905 | - | 50,000 | - | - | 150,000 | - | 15,696,905 |
| | | 2024 | 20,095,000 | - | - | - | - | 4,000 | - | 20,099,000 |
| 10 | Tetor | 2023 | 22,650,100 | 10,000 | 100,000 | 18,000 | - | 554,000 | - | 23,332,100 |
| | | 2024 | 15,227,005 | - | 550,000 | 34,000 | - | 304,000 | - | 16,115,005 |
| 11 | Nentor | 2023 | 13,098,000 | 50,000 | 250,000 | - | - | 8,000 | - | 13,406,000 |
| | | 2024 | 9,770,005 | 50,000 | 1,060,000 | 186,000 | - | 3,787,333 | - | 14,853,338.3 |
| 12 | Dhjetor | 2023 | 10,095,005 | - | 250,000 | 4,000 | - | 30,000 | - | 10,379,005 |
| | | 2024 | 19,425,005 | - | 700,000 | 18,000 | - | 787,333 | 374,000.0 | 21,304,338.3 |
| Totale | | 2023 | 182,119,202.9 | 150,000 | 1,280,000 | 186,940 | 7,039,000 | 4,941,678 | - | 195,716,820.9 |
| | | 2024 | 184,676,492 | 150,000 | 3,300,000 | 316,100 | 861,000 | 5,536,667 | 374,000 | 195,214,258.6 |
| | | | | | | | | | | |
| Diferenca ne Vlere | | 2024-2023 | 2,557,289 | - | 2,020,000 | 129,160 | (6,178,000) | 594,989 | 374,000 | (502,562) |
| Diferenca ne % | | 2024-2023 | 1.40% | 0.00% | 157.81% | 69.09% | -87.77% | 12.04% | #DIV/0! | -0.26% |

Njëkohësisht nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në mënyrë periodike janë evidentuar arkëtimet nga debitorët e mbartur në çelje të vitit 2024 për çdo strukturë duke ndjekur dhe referuar situatën edhe me DCJPP apo atë të DING për të vijuar me ndjekjen e mëtejshme të procedurave për mbledhjen dhe arkëtimin e këtyre detyrimeve të pa shlyera. Në vijim do të gjeni informacion të detajuar me vlerën debitore për çdo vit mbartur më datë 01.01.2024 dhe likujdimin e tyre deri më datë 31.12.2024 gjithnjë për çdo strukturë përgjegjëse të ISHTI-it. Ky informacion vjen i detajuar si për debitorët nga Tarifat e Shërbimit po ashtu dhe nga Kundravajtjet Administrative.

## *Informacion permbledhes I debitoreve sipas struktures pergjegjese*

| *Struktura pergjegjese e te Ardhurave Debitore* | *Periudha* | *Detyrim deri me 31.12.2023* | *Lik.Tarifa Sherbimi 2024* | *Debi deri me31.12. 2024* |
|---|---|---|---|---|
| | 2006 | 2,377,535 | - | 2,377,535 |
| | 2007 | 5,232,441 | - | 5,232,441 |
| | 2008 | 6,923,671 | - | 6,923,671 |
| | 2009 | 7,660,780 | - | 7,660,780 |
| | 2010 | 9,055,582 | - | 9,055,582 |
| | 2011 | 7,115,642 | - | 7,115,642 |
| | 2012 | 10,967,087 | - | 10,967,087 |
| | 2013 | 2,927,649 | - | 2,927,649 |
| | 2014 | 1,734,613 | - | 1,734,613 |
| *Drejtoria e Inspektimit te Naftes dhe Gazit (DING)* | 2015 | 18,867,150 | - | 18,867,150 |
| | 2016 | 5,079,200 | - | 5,079,200 |
| | 2017 | 1,180,070 | - | 1,180,070 |
| | 2018 | 7,755,000 | - | 7,755,000 |
| | 2019 | 2,045,000 | - | 2,045,000 |
| | 2020 | 2,539,000 | - | 2,539,000 |
| | 2021 | 2,040,000 | - | 2,040,000 |
| | 2022 | 1,308,150 | 44,000 | 1,264,150 |
| | 2023 | 2,676,000 | 787,000 | 1,889,000 |
| | | **97,484,570** | **831,000** | **96,653,570** |
| | 2007 | 36,750 | - | 36,750 |
| | 2008 | 5,040 | - | 5,040 |
| | 2009 | 45,600 | - | 45,600 |
| | 2010 | 15,000 | - | 15,000 |
| | 2011 | 30,000 | - | 30,000 |
| | 2012 | 38,018 | - | 38,018 |
| | 2014 | 110,000 | - | 110,000 |
| | 2015 | 30,044 | - | 30,044 |
| *Drejtoria e Inspektimit te Paisjeve Elektrike (DIPIE)* | 2016 | 20,000 | - | 20,000 |
| | 2017 | 10,000 | - | 10,000 |
| | 2018 | 160,000 | - | 160,000 |
| | 2019 | 40,000 | - | 40,000 |
| | 2020 | 20,000 | - | 20,000 |
| | 2021 | 10,000 | - | 10,000 |
| | 2023 | 10,000 | - | 10,000 |
| | | **580,452** | - | **580,452** |
| | 2007 | 2,926,470 | - | 2,926,470 |
| | 2008 | 871,937 | - | 871,937 |
| | 2009 | 2,510,239 | - | 2,510,239 |
| *Drejtoria e Instalimeve te Paisjeve nen Presion (DIPNP)* | 2010 | 2,858,270 | - | 2,858,270 |
| | 2011 | 14,000 | - | 14,000 |
| | 2012 | 363,950 | - | 363,950 |
| | 2013 | 270,040 | - | 270,040 |
| | | **9,814,906** | - | **9,814,906** |
| | 2012-2019 | 124,000 | - | 124,000 |
| *Drejtoria e Laboratorit Qendror Kombetar (DLQK)* | 2022 | 25,233 | - | 25,233 |
| | 2023 | 30,817 | 30,000 | 817 |
| | | **180,050** | **30,000** | **150,050** |
| | | 108,059,979 | 861,000 | 107,198,979 |

Situata e detyrimeve të prapambetura gjenerohet nga viti 2006 e në vijim, për të cilat është informuar Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike pranë ISHTI-it. Gjithashtu, kemi kërkuar në vazhdimësi të fillojnë procedurat e parashkrimit të këtyre detyrimeve sikurse referon dhe Ligji për Kundravajtjet Administrative.

*Informacion permbledhes I debitoreve sipas struktures pergjegjese 2024*

| Struktura pergjegjese e te Ardhurave Debitore | Periudha | Informacion Financiar | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Detyrim deri me 31.12. 2024 | Likujduar Kundravajtje Administrative | Likujduar Kamatvonesa | Vendim Komisioni Ankimimit te Gjobave, Shfuqizime | Debi 2024 |
| Drejtoria e Inspektimit te Naftes dhe Gazit (DING) | 1999-2006 | 58,156,250 | - | - | | 58,156,250 |
| | 2008 | 14,600,000 | - | - | | 14,600,000 |
| | 2009 | 25,370,000 | - | - | | 25,370,000 |
| | 2010 | 103,308,502 | - | - | | 103,308,502 |
| | 2011 | 43,409,873 | - | - | | 43,409,873 |
| | 2012 | 54,864,124 | - | - | | 54,864,124 |
| | 2013 | 46,820,000 | - | - | | 46,820,000 |
| | 2014 | 265,113,130 | - | - | | 265,113,130 |
| | 2015 | 258,043,420 | 40,000 | - | | 258,003,420 |
| | 2016 | 136,734,085 | - | - | | 136,734,085 |
| | 2017 | 29,583,500 | - | - | | 29,583,500 |
| | 2018 | 41,100,000 | - | - | | 41,100,000 |
| | 2019 | 13,054,488 | - | - | | 13,054,488 |
| | 2020 | 9,650,000 | - | - | | 9,650,000 |
| | 2021 | 9,200,000 | 1,500,000 | 71,000 | | 7,700,000 |
| | 2022 | 5,200,000 | 1,500,000 | 59,000 | | 3,700,000 |
| | 2023 | 21,200,000 | 1,166,667 | - | - | 20,033,333 |
| | 2024 | 31,850,000 | 2,450,000 | 60,000 | 9,000,000 | 20,400,000 |
| | | **1,167,257,372** | **6,656,667** | **190,000** | **9,000,000** | **1,151,600,705** |
| Drejtoria e Inspektimit te Paisjeve Elektrike (DIPIE) | 1999-2006 | 10,007,650 | - | - | | 10,007,650 |
| | 2008 | 1,392,000 | - | - | | 1,392,000 |
| | 2009 | 940,000 | - | - | | 940,000 |
| | 2010 | 347,000 | - | - | | 347,000 |
| | 2011 | 900,000 | - | - | | 900,000 |
| | 2014 | 2,460,000 | - | - | | 2,460,000 |
| | 2015 | 300,000 | - | - | | 300,000 |
| | 2016 | 1,410,000 | - | - | | 1,410,000 |
| | 2017 | 1,230,000 | - | - | | 1,230,000 |
| | 2018 | 900,000 | - | - | | 900,000 |
| | 2019 | 886,400 | - | - | | 886,400 |
| | 2020 | 170,000 | - | - | | 170,000 |
| | 2021 | 1,160,000 | - | - | - | 1,160,000 |
| | 2022 | 1,320,000 | 180,000 | 14,200 | | 1,140,000 |
| | 2023 | 2,900,000 | 1,000,000 | 102,000 | - | 1,900,000 |
| | 2024 | 3,150,000 | 450,000 | 9,000 | 500,000 | 2,200,000 |
| | | **29,473,050** | **1,630,000** | **125,200** | **500,000** | **27,343,050** |
| Drejtoria e Instalimeve te Paisjeve nen Presion (DIPNP) | 2008 | 200,000 | - | - | | 200,000 |
| | 2009 | 535,000 | - | - | | 535,000 |
| | 2010 | 766,372 | - | - | | 766,372 |
| | 2011 | 260,000 | - | - | | 260,000 |
| | 2012 | 585,000 | - | - | | 585,000 |
| | 2014 | 800,000 | - | - | | 800,000 |
| | 2015 | 600,000 | - | - | | 600,000 |
| | 2016 | 5,799,000 | - | - | | 5,799,000 |
| | 2017 | 14,450,000 | - | - | | 14,450,000 |
| | 2018 | 3,700,000 | - | - | | 3,700,000 |
| | 2019 | 50,000 | - | - | | 50,000 |
| | 2021 | 1,850,000 | - | - | | 1,850,000 |
| | 2022 | 2,550,000 | - | - | | 2,550,000 |
| | 2023 | 900,000 | 150,000 | 900 | - | 750,000 |
| | 2024 | 1,050,000 | - | - | - | 1,050,000 |
| | | 34,095,372 | 150,000 | 900 | - | 33,945,372 |
| | | 1,231,225,794 | 8,836,667 | 316,100 | 9,500,000 | 1,212,889,127 |
| Drejtoria e Çeshtjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike | 2024 | 400,000 | 400,000 | - | - | - |
| **TOTAL** | | **1,231,625,794** | **9,236,667** | **316,100** | **9,500,000** | **1,212,889,127** |

Gjatë vitit 2024, sikurse jemi në dijeni, institucioni është përballur me mungesë financimi të fondeve për Shpenzime Operative. Në këto kushte për periudhën raportuese jemi të vëmendshëm dhe shumë të kujdesshëm në përdorimin e tyre duke i dhënë prioritet shpenzimeve që sigurojnë ecurinë normale të punës në institucion. Në vijim, po ju referojmë informacionin analitik me buxhetet e alokuara, si dhe përdorimin e buxheteve vjetore sipas klasave të miratuara.

Situacioni shpenzimeve JANAR - DHJETOR 2024 ISHTI

| ART | Plani Vjetor | Plani Thesarit | Shp. Thesari | Xhirime Brendsh | Xhirime Brendsh | Garanci | Pa paguar | Banka | Viti 2023 | Total Banka | Nr. Punonjesve | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (1) | sig+tap (2) | (3) | | | (4=1-2-3) | 6 | (7=1-3) | PLAN | FAKT |
| 600 | 260,566,000 | 260,278,481 | 259,728,259 | 52,963,262 | | | | 206,764,997 | | 206,764,997 | 200 | 199 |
| 601 | 43,425,000 | 43,079,920 | 43,158,079 | 43,158,079 | | | | - | | - | | |
| 600-601 | 303,991,000 | 303,358,401 | 302,886,338 | 96,121,341 | - | - | - | 206,764,997 | - | 206,764,997 | 200 | 199 |
| 602 | 63,715,000 | 63,715,000 | 61,138,065 | 202,473 | 323,880 | | | 60,611,712 | 7,396,835 | 60,611,712 | - | - |
| 606 | 456,500 | 741,432 | 741,432 | 115,327 | | | | 626,105 | | 626,105 | | |
